

Sustainable Development & Environmental Issues

4

HABITAT

IKZH_POLIS, Sustainability_LAB & Co-PLAN
Botimet POLIS_Press
ISSN: 2306-8779

MAGAZINE

**PËRMBLEDJA E PUNIMEVE
SEMINAR KOMBËTAR,
DHJETOR 2014**

**“MBROJTJA E TOKËS
NJË PROBLEM EKONOMIK,
SOCIAL DHE MJEDISOR”**



Sustainable Development & Environmental Issues

HABITAT

Revista shkencore, kulturore dhe politike
publikuar rregullisht nga Universiteti Politeknik i Tiranës **MAGAZINE**

Revistë Periodike Shkencore

Këshilli Redaksional

Prof. Dr. Vezir Muharremaj
Prof. Dr. Sherif Lushaj
Prof. Dr. Nesip Meçaj
Prof. Dr. Luljeta Bozo
Prof. Dr. Besnik Aliaj
Doc. Sotir Dhamo
MND. Ing. Dritan Shutina
MND. Ark. Rudina Toto

Konsulentë

Prof. Dr. Nasip Meçaj
Prof. Dr. Vezir Muharremaj
MND. Rudina Toto

Botues

Prof. Dr. Besnik Aliaj
Doc. Sotir Dhamo
MND. Ing. Dritan Shutina

Drejtor

Prof. Dr. Besnik Aliaj

Kryeredaktor

Doc. Sotir Dhamo

Redaktor Letrare

Esmeralda Strori

Layout

Joana Dhiamandi

Shtypur nga

Shtypeshkronja "PEGI"

Kontakt

Rr. "Bylis" Nr. 12, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.5, Kashar.

Kodi Postar 1051, KP 2995, Tirana Albania

Tel: +355.(0)4.24074 - 20/21,

Fax: +355.(0)4.2407422,

Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881,

E-mail: forum_ap@universitetipolis.edu.al

Web: www.universitetipolis.edu.al



MetroPolis
Universiteti Politeknik i Tiranës



PËRMBLEDHJE E PUNIMEVE

SEMINAR KOMBËTAR, DHJETOR 2014

**“MBROJTJA E TOKËS NJË
PROBLEM EKONOMIK, SOCIAL
DHE MJEDISOR”**

Redaktor i Volumit
Redaktor letrar

Prof. Dr. Sherif Lushaj
Esmeralda Strori

POLIS_Press

Fjala e përshëndetjes

Prof. Dr. Besnik Aliaj

Ky numër i aneksit të specializuar shkencor “Habitat Magazine” fokusohet në disa nga idetë e hedhura në Seminarin Kombëtar mbi “mbrojtjen e tokës si një problem ekonomik, social dhe mjedisor” që është organizuar nga Universiteti POLIS dhe partneret e tij në kuadër të “Ditës së Tokës” një traditë tashmë e konsoliduar në institucionin tonë . Konferenca dhe ky botim janë produkt i punës së stafit akademik dhe kërkimor si dhe i studenteve të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMU), përfshi këtu qendrën e inovacionit SustLab - Laboratori i Qëndrueshmërisë, prane IF - Innovation Factory në universitetin tonë .

Ndërkohë që kemi jetuar 2 dekada tepër intensive ndryshimesh në vend dhe një proces thuajse dramatik urbanizimi pas rënies së “Murit të Berlinit”, aktualisht dhe që pas recensionit ekonomik global shkaktuar nga kriza e “Lehman Brothers” dhe tullumbaces së pasurive të patundshme, gjithmonë e më shumë është kuptuar së modeli i zhvillimit i fokusuar vetëm të zonat urbane nuk është më eficient dhe së sot më shumë së kurrë kërkohet një rikonceptim i ri dhe një balancë e re territoriale

rural-urbane, që konsideron një zhvillim më të qëndrueshëm të modelit social ekonomik dhe të burimeve në territor. Me këtë pikënisje dhe më dëshirë për të hapur një debat lokal që impakton politikebërjen në vend, Universiteti POLIS vjen në këtëseminar kombëtar më disa ide të cilat janë parashtruar në disa pune shkencorë të IF dhe FPMU, të cilat tentojnë të analizojnë në mënyrë shkencorë dhe më fakte statusin e tokës dhe territorit në tërësi në Shqipëri, problemet e shfaqura apo të akumuluar, si dhe ide mbi zgjidhjen e tyre, përmes propozimeve konkrete dhe inovative, përfshi planin hapësinor kombëtar, konsolidimin e tokës në zonat urbane dhe në zonat bujqësore, parandalimi fenomeneve abrazive, tektonike dhe ndodhjet mjedisore, etj.

Gjetjet e këtij seminari si dhe konkluzionet nga projektet apo kërkimet konkrete po publikohen dhe dërgohen autoriteteve dhe institucioneve më rekomandime konkrete për veprim. në shpresojmë së në këtëmënyrë POLIS do të bëhet gjithmonë e më i dobishëm si në aspektin social edhe në këndvështrimin profesional dhe shkencor. Ky botim nder të tjera ka edhe vlerë dokumentare dhe referencë për studentet, stafin dhe kërkuesit shkencore.

Ju urojme lexim të mbarë

PËRMBAJTJA

FJALA E HAPJES TË AKTIVITETIT

PUNIMI I

Duke eksploruar metoda alternative për planifikimin hapësinore në Ballkanin Perëndimorë [Rasti Studimorë “Albania 2030 National Strategic Visioning”]..... 12
Besnik Aliaj, Sotir Dharmo, Eranda Janku

PUNIMI II

Problemet e humbjes së tokës në Shqipëri, në këndvështrimin e ditës dhe vitit nderkombëtar të tokës 40
Sherif Lushaj

PUNIMI III

Zhvillimi urban në Shqipëri dhe efektet mbi tokën bujqësore..... 64
Dritan Shutina, Kejt Dhrami

PUNIMI IV

Zhvillimi qëndrueshëm i pemëtarisë në fokusin e mbrojtjes së tokës dhe pejsazhit..... 88
Bardhosh Ferraj

PUNIMI V

Rritja e mbulesës pyjore, faktor për mbrojtjen e tokës dhe produktivitetin e pyjeve.....98
Janaq Male

PUNIMI VI

Erozioni dhe tokat më pjellori të kufizuar120
Petrit Harasani, Bardhyl Qilimi, Eda Bezhani

REKOMANDIME NGA KONFERENCA

Problematika dhe masa për mbrojtjen e Tokës138

Hapja e aktivitetit

Prof. Dr. Sherif Lushaj

Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në seminarin Kombëtar **“Mbrotjtja e tokës një problem ekonomik, social dhe mjedisor”**, që zhvillohet në kuadrin e **“Ditës Ndërkombëtar të Tokës”** (dheut), organizuar nga Universiteti POLIS në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, së Zhvillimit Rural e Administrimit të Ujërave dhe Qendrën e Studimeve të Burimeve Natyrore. Universiteti POLIS nis sot një dialog profesional modest, që kërkon të kontribuojë në harmonizimin e veprimtarive të mbrojtjes dhe administrimit të resurseve natyrore, zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit, duke vijuar më pas me aktivitete të tjera në vitin 2015, që është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara **“Viti Ndërkombëtar i Tokës”**

Me propozim të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencës së Tokës, që bashkon mbi 60,000, shkencëtarë të tokës dhe të organizatës të bujqësisë dhe ushqimit (FAO), të nisur nga problemet e humbjes dhe degradimit të tokës në nivel global, nga kontradita midis zhvillimit urban dhe zënies së tokave produktive, nevojat e popullsisë në rritje në kushtet e parashikimit të një popullsie prej 9 miliardë në vitin 2050, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e ka shpallur 5

Dhjetorin “Ditën Ndërkombëtare të Tokës” dhe vitin 2015 “Vitin Ndërkombëtar të Tokës” (dheut).

Kjo Ditë, ka për qëllim, të evidentojë rolin e tokës si një faktor përcaktues i ekosistemit natyral dhe si një kontributor vital për të gjithë njerëzimin në sigurimin e burimeve dhe produkteve jetësore, ruajtjen e biodiversitetit dhe përballjes më ndryshimet klimatike, për një toke të shëndetshme dhe të dherave në të gjitha kategoritë e përdorimit të saj: bujqësore, pyjore, urbane. të dhënat e fundit të KB tregojnë se në 50 vitet e fundit më shumë se 2 miliardë ha toke janë degraduar, në një kohë që në vendet anëtare të BE-se çdo dite 275 ha toke bujqësore zihen më ndërtime apo ndryshojnë përdorimin nga bujqësia në përdorime të tjera. Prandaj në këtë ditë nxiten nivelet politike, vendimmarrëse, shoqëria civile, komuniteti shkencor, pronaret dhe përdoruesit e tokës, të punojnë së bashku për një toke të shëndetshme për sigurinë ushqimore, uljen e varferisë, menaxhimin e qëndrueshëm, nëpërmjet zbatimit të instrumenteve të planifikimit të territorit, planifikimit rajonal, planifikimit të përdorimit të tokës, mbrojtjes dhe menaxhimit të saj. Shtetet nxiten të planifikojnë për vitin 2015 aktivitete sensibilizuese, plane kombëtare, rajonale e lokale të mbrojtjes së tokës, të shtojnë investimet, të rivlerësojnë

burimet tokësore dhe kapacitetet menaxhuese. në vendin tonë , edhe pse toka është pasuria më e madhe kombëtare, për sot dhe gjeneratat e ardhshme dhe një kusht themelor për zhvillimin e shoqërisë, edhe pse është baza e sigurimit të produkteve ushqimore dhe plotësimit të nevojave të tjera, edhe pse jemi nga vendet më sipërfaqë të kufizuara të tokës produktive për banor, edhe pse tregu është drejt ngopjes më ndërtime, përsëri presioni për zënien e tokave bujqësore produktive vazhdon të jetë i lartë. ***Në këto kushte, kërkohet një vizion tjetër i planifikimit hapësinor. Duhet të vendosen balanca të reja të qëndrueshme të përdorimit të tokës dhe të mbrohen tokat produktive bujqësore.*** Erozioni, humbja e mbulesës tokësore, veçanërisht në sipërfaqet pyjore, ndërhyrjet në lumenj, zgjerimi i kripëzimit në zonat bregdetare, fenomenet e shkretëtirimit, fragmentimi i lartë tokës, rrënja e kapaciteteve prodhuese janë disa nga shqetësimet më serioze.

Në këtë aktivitet, ku marrin pjesë studentë e pedagogë të Universitetit Polis, përfaqësues të dikastereve e të pushtetit vendor, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Prefekturat, Organizatat mjedisore, Fedarata kombëtare e pyjeve, eksperte të fushës, shoqata e vlerësuesve të tokës, Zv/Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të ujerave, Zv/Ministri i Mjedisit, ***përfaqësueses të Fondacionit Hennis Sidel shttunj, këto çështje do të jenë objekt i diskutimit, gjë që shkon në harmoni edhe më prirjen dhe përpjekjet e Institucioneve të vendit dhe Programit të Qeverisë Shqiptare.***

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin

Sherif Lushaj

① DUKE EKSPLORUAR METODA ALTERNATIVE
PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË BALLKANIN
PERËNDIMOR

[MANIFESTI “SHQIPËRIA 2030”

Një Vizion për Zhvillimin Kombëtar Hapësinor]

Prof.Dr. Besnik Aliaj , Doc. Sotir Dhamo , MSc. Eranda Janku

[Universiteti Polis, Tiranë]

1. HYRJA:

1.1 SHQIPËRIA: MODELET E ZHVILLIMIT URBAN 1945-1990

Nga fillimi i viteve '90-të Shqipëria ishte ende një nga ekonomitë më ekstreme të planifikimit të centralizuar, ku autoritetet ishin praktikisht përgjegjese për çdo gjë dhe kontrollonin të gjitha format e zhvillimeve territoriale. Dy kritere kryesore karakterizonin zhvillimin urban dhe të gjithë procesin dhe strukturën e urbanizimit në vend deri në këtë periudhë: një kombinim mes përqendrimit të zhvillimeve të vendbanimeve dhe qëndërsisë së zhvillimit hapësinor (Aliaj 2003). Instrumenti kryesor i planifikimit gjatë kësaj periudhe ishte i ashtuquajtur “Plan Rregullator” për zonat urbane të



.....
 Figura 1: Modelet e Zhvillimit Urban në Periudhën 1945-1990

banimit, i cili në vetvete ishte shumë i ngurtë dhe nuk bëntë asgjë më shumë, së sa thjesht të tregonte së ku dhe çfarë përdorimi kishte çdo strukturë, më një aplikim shumë të dobët të standardeve arkitektonike. Ndërsa në zonat rurale territori qeverisjesh kryesisht nga politikat dhe instrumentat e sektorit të bujqësisë dhe mbrojtjes, kombinuar më transportin publik interurban.

1.2 TRANZICIONI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT GJATË VITEVE 1991-2014

Në fillimin e viteve '90-të Shqipëria u bë një vend më i hapur dhe më demokratik. Në vrazhdën e ndryshimeve drastike Parlamenti Shqiptar miratoi dy ligje për planifikimin e territorit, të ashtuquajtura “Ligji për Urbanistikën”, përkatësisht Ligji Nr.7693 i vitit 1993, dhe Ligji Nr.8405 i vitit 1998, të cilët qenë objekt ndryshimesh e amendimesh të vazhdueshme në vitet e mëvonshme. Të dy këto ligje parashtronin rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban, të vendndodhjes dhe arkitekturës së objekteve në të gjithë territorin e Shqipërisë, më përjashtim të tokave bujqësore. Por edhe pse ligji i dytë solli disa ndryshime të reja në praktika dhe bëri disa përmirësime në krahasim me atë të mëparshmin, ai sërish nuk arriti të ishte i suksesshëm në lidhje me njohjen e ndryshimeve të ndodhura në territor gjatë dekadës së parë të tranzicionit post-komunist. Për më tepër ky ligj injoronte fenomenin në rritje të ndërtimeve informale dhe problemet që ekzistonin më ndryshimin e sistemit të pronësisë, nga pronë shtetërore në private (Toto, 2010). Ndër të tjera, ligji dështoi edhe në lidhje me vendosjen e objektivave për të adresuar çështjet e zhvillimit dhe planifikimit kombëtar hapsinor.

Megjithatë duhet të theksohet së deri në vitin 2006 planifikimi i territorit në Shqipëri ishte përgjithësisht i bazuar në traditën mesdhetare të ashtuquajtur të “Urbanizmit”, më karakter autoritar dhe më kulturën “blueprint” të planifikimit që përfaqësohej nga objektiva më karakter fizik. Në vitin 2006 influencuar nga dy forca kryesore: (i) së pari presioni nga poshtë-lart, i cili vinte nga iniciativat komunitare dhe

profesionale lokale, ku mund të veçohet Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, një OJF e inspiruar nga shkolla hollandeze e planifikimit; (ii) dhe së dyti influencat politike të partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri, përgjithësisht të përfaqësuar nga programet e asistencës për zhvillim si Banka Botërore, UNDP, USAID dhe asistenca teknike Austriake e Hollandeze në Shqipëri (Aliaj 2008); autoritetet vendosën të reformojnë thellësisht legjislacionin e planifikimit urban, për të lëvizur drejt rregullave e principeve më abstrakte të vendimmarrjes në lidhje me territorin, përfshi planifikimin hapësinor e rajonal, dhe politikatat kombëtare të planifikimit të territorit në tërësi.

Si përfundim, mund të thuhet së pas ndryshimeve të viteve '90-të e deri në ditët e sotme Shqipëria është zhvendosur nga një ekstrem në tjetrin. Kaluam një periudhë, kur vendi ishte një nga ekonomitë më liberale të Europës Lindore, ku praktikisht nuk bëhej fjalë për politika të zhvillimit hapësinor dhe ku autoritetet qeverisëse nuk gëzonin pothuajse fare autoritet dhe kontroll mbi zhvillimin e territorit. më gjithë përpjekjet për reformimin e legjislacionit të planifikimit, më përjashtime të vogla pothuajse asgjë nuk pati sukses në zbatim, veçanërisht në nivel rajonal e kombëtar, dhe më gjithë përpjekjet e vazhdueshme gjatë viteve të fundit, qeverisja dhe zhvillimi territorial ende mbeten të keqkuptuara nga profesionistët dhe të keqpërdorura nga politikanët (Aliaj, Dhamo, Shutina, 2010).

1.3 PROBLEMET E PLANIFIKIMIT DHE PASOJAT

Gjatë 20 viteve të fundit i ashtuquajtur "urbanizim" tradicional, në kuptimin e zbatimit strikt të parimeve të "kodeve dhe

distancave”, është shndërruar më shumë në një lloj alibije administrative për densifikimin dhe mbi-shfrytëzimin korruptiv të tokës, së sa një mjet për manaxhimin urban. Njëerëzit morën situatën në duart e tyre duke ndërmarrë zgjidhje individualiste dhe të paorganizuara, më qëllimin e vetëm për të shmangur çmimet e larta, si dhe procedurat shpesh herë të korruptuara të administratës publike (Aliaj, Dhama, Shutina, 2010).

1.4 REALITETET E REJA TERRITORIALE DHE SFIDAT

Në këto kushte, në prag të anëtarësimit të saj në BE Shqipëria u përball më një realitet të ri territorial. Sipas të dhënave të fundit të Censurit të Popullsisë dhe Banesave (INSTAT 2011), rajonet më periferike në veri dhe në jug të Shqipërisë janë zonat më përqindjen më të lartë të popullsisë së braktisur, ndërsa ultësira perëndimore që përkon në pjesën më të madhe më zonën metropolitane dhe më të zhvilluar të vendit, edhe pse ka qenë zona më dinamike në lidhje më rritjen ekonomike-urbane, sërish nuk ka arritur të ruajë një intensitet të qëndrueshëm të rritjes së kësaj popullsie. Ndërkohë që popullsia në këto zona ka pësuar një trefishim gjatë 10 vjeçarit të parë, gjatë dekadës së fundit, zhvillimi i tokës është dyfishuar pa iu siguruar infrastruktura e duhur fizike dhe sociale, duke krijuar kështu një model urban problematik (Aliaj, Dhama, Shutina, 2010). Kjo në anën tjetër ka dëmtuar zhvillimin e ardhshëm të vendit, duke vënë në rrezik potencialet e pazëvendësueshme bujqësore, turistike dhe energjitike. (Aliaj, 2008).

Për më tepër, më shumë së 2 dekada pas ndryshimeve sociale dhe politike të pas viteve '90-të, administrata

shqiptare akoma nuk ka arritur të krijojë dhe aprovojë një vizion kombëtar hapësinor për vendin, pa përmendur këtu edhe mungesën e kapaciteteve profesionale për hartimin e metodologjisë së hartimit të këtij vizioni strategjik si dhe materializimit të tij grafik për një komunikim transparent publik. Kjo si pasojë ka dëmton rritjen ekonomike dhe prosperitetin në vend. Gjendja është rënduar akoma më shumë edhe nga dështimi i autoriteteve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm kombëtar të regjistrimit të pronësisë dhe të kthimit të pronave historike, probleme këto të trashëguara nga e kaluara. Autoritetet duhet të inkurajojnë kapacitetet autoktonë shqiptare të hartojnë politika të kuptueshme politikisht, dhe të përkthyer në materiale të qarta vizualizuese teknike publike, në mënyrë që ato të kuptohen më lehtë nga institucionet dhe audienca e synuar, për të lehtësuar sidomos procesin e zbatimit të tyre.

2. METODOLOGJIA

Deri më tani nuk është kryer asnjë punë kërkimore për të adresuar apo mbështetur krijimin e një vizioni kombëtar hapësinor për zhvillimin territorial të Shqipërisë. Ndaj edhe ka qenë shumë e rëndësishme që puna për krijimin e këtij dokumenti të nisëj më studimin e disa rasteve, ku zbatimi i politikave të zhvillimit hapësinor është kryer relativisht suksesshëm. Për këtë arsye jemi bazuar në dy metoda kërkimore:

Faza e Parë e Kërkimit ('Desk Study'):

- Studimi për mbledhjen e të dhënave parësore (kryerja e intervistave, diskutimeve në grup,

- pjesëmarrja në konferenca etj.);
- Studimi i teorive ndërkombëtare dhe raporteve e materialeve vendore për këtë fushë (të dhënat sekondare);
 - Studimi i rasteve krahasimore të së njëjtës natyrë më atë që ky dokument kërkon të krijojë (të dhënat terciare). Rishikimi i literaturës së specializuar në lidhje më aplikimin e politikave hapësinore në disa nga vendet e Bashkimit European që janë pionere në këtë fushë, dha inpute për të kuptuar së si funksionon planifikimi hapësinor, dhe së si mund të aplikohet ai në kontekstin tonë. Në këtë pikë, të kuptuarit e debatit të ngritur për atë që ndodh në shkallën kombëtare, duke kryer intervista më persona kyç, profesionistë dhe vendimmarrës ka qenë tejet i rëndësishëm. Pjesë e rëndësishme e kësaj faze ka qenë edhe pjesëmarrja në konferenca, workshope e takime që lidhen më këtë temë, apo çështje të tjera të ndërlidhura në kuadrin e integritit tonë European.

2.1 NJË VIZION PËR ZHVILLIMIN KOMBËTAR HAPËSINOR

Zhvillimi i një vizioni kombëtar hapësinor dhe formulimi i koncepteve hapësinore në një kontekst si Shqipëria, ku nuk ka pasur punë kërkimore të mëparshme që adreson këto çështje, është tejet sfiduese. Sidoqoftë është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar politikat territoriale të aplikuara në vend ishin përgjithësisht të orientuara drejt

zhvillimit të bujqësisë, duke thelluar gjithnjë e më shumë politikat antiurbane. Përpos këtij fakti, më rënien e “Murit të Berlinit” dhe gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria e inkurajuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë përmes asistencës teknike-financiare është fokusuar sidomos në përdorimin e potencialeve turistike, bujqësore dhe të burimeve natyrore, si energjia dhe industria minerare. Praktikisht deri në këtë moment janë marrë në konsideratë vetëm çështje të cilat lidhen më zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe turizmit, por edhe këto nuk janë adresuar dhe konsideruar plotësisht si një set potencialesh dhe as nuk janë parë si të ndërlidhura më procesin e urbanizimit.

Në këtë pikë, duhet të theksojmë së vizioni kombëtar hapësinor duhet të adresojë të tilla çështje, duke hartuar politika dhe koncepte përkatëse hapësinore për të mbrojtur dhe përdorur siç duhet potencialet, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm territorial, ekonomik dhe social. Ndaj edhe koncepte si “planifikimi ekologjik” që ofrojnë praktikën e “shabllonit” për një marrëdhënie të re e të shëndetshme mes mjedisit të ndërtuar dhe natyrës, bëhen mjaft të rëndësishme (Ian McHarg, 1969).

Në anën tjetër, është shumë e rëndësishme të vemë në praktikë teorinë krahasuese të planifikimit (Faludi, 1973). Dy rastet studimore që ky kërkim shkencor merr në konsideratë ndihmojnë në bërjen e një vlerësimi mbi atë së si çdo metodë planifikimi ka funksionuar në secilin nga kontekstet, çfarë prioritetesh janë marrë në konsideratë, dhe së si këto prioritete janë përkthyer në veprime konkrete. Në këtë mënyrë e kemi të qartë së si duhet të kryejmë ekzaminimin e situatës aktuale në Shqipëri dhe së si më tej

të ngrejme një set prioritetesh për zhvillimin e vendit. Për të arritur këtë kemi nevojë të: Gjatë formulimit të një vizioni kombëtar hapësinor duhet të adresohen disa çështje kritike:

- Nevoja për të ngritur një sistem të dhënash statistikore, bazuar në ato indikatorë që mund të lejojnë profesionistët dhe vendimmarrësit të kryejnë kërkime, mbi bazën e të cilave më pas të mund të adresojnë problematikat ekzistuese;
- Për të krijuar një sistem hapësinor afatgjatë është e nevojshme të ngrihet gjithashtu një sistem i mirëfilltë dhe i saktë të dhënash gjeografike, i cili të lejon të përpunosh materiale të ndryshme grafike në bazë të të dhënave ekzistuese;
- Legjislacioni kombëtar i planifikimit dhe procedurat e ndërlidhura duhet të inkurajojnë dhe forcojnë krijimin dhe implementimin e vizioneve kombëtare, të cilat shërbejnë si instrumente bazë mbështetës për një qeverisje të mirë hapësinore vendore, rajonale dhe qëndrore;
- Praktikrat e planifikimit duhet të mbështeten gjithashtu në shkollat ose traditat të caktuara në lidhje me draftimin dhe dizajnimin e politikave kombëtare hapësinore mbi bazën e teknikave dhe mjeteve vizualizuese.
- Kjo është e rëndësishme sepse profesionistët të cilët punojnë në shkollën kombëtare të planifikimit, dhe praktikuesit që arrijnë deri në shkollë më të vogla, duhet të kenë një gjuhë të përbashkët në mënyrë që të mund të kuptojnë instrumentat dhe politikrat që duhet të ndjekin;
- Së fundmi, një plan hapësinor kombëtar duhet të

ndërlidhet më plane të tjera në shkallë më të vogla më rëndësi hapësinore për vendin, të cilat trajtojnë më në detaje çështje sektoriale si: planet e infrastrukturës kombëtare, planet e përdorimit të tokave, planet e zhvillimit të qëndrueshëm, planet mjedisore, planet e zhvillimit social-ekonomik, etj. Duhet theksuar së rëndësia e planifikimit hapësinor në shkallë kombëtare nuk duhet të ulë rëndësinë e planifikimit hapësinor në shkallë më të vogla (rajonale ose vendore), sepse vetëm kombinimi dhe plotësimi i planifikimit në të tre këto shkallë siguron një zhvillim të qëndrueshëm në terma afatgjatë dhe sjell rritjen pozitive social-ekonomike.

2.2 ANALIZA E KONTEKSTIT

Përcaktimi i parimeve mbi të cilat do të bazohet vizioni hapësinor kombëtar dhe më pas hartimi i këtij vizioni kanë nevojë për një mbështetje analitike që lidhet me faktorët territorialë, socialë dhe ekonomikë në vend. Analizat e mëposhtme do të shoqërohen edhe me sintheza dhe konkluzione, sipas kategorive përkatëse.

2.21 Çështjet e Zhvillimit Social

Dendësia e Popullsisë. Bazuar në llogaritjet e Censurit të vitit 2011 për Popullsinë dhe Banesat, popullsia banuese në Shqipëri është 2,821,977 dhe krahasuar kjo më përlllogaritjet e Censurit të vitit 2001, ku popullsia ishte 3,069,275 kemi një rënie prej rreth 8%. Duke iu referuar një dendësie mesatare të popullsisë prej 97.4 banorë / km², popullsia e Shqipërisë është e përqendruar kryesisht rreth zonës metropolitane, ku

qarku i Tiranës vlerësohet të ketë një dendësi prej 453.61 banorë / km². Më pas vijon qarku i Fierit më 164.20 banorë / km², i cili gjithashtu duket të jetë tejet i përqëndruar kryesisht për shkak të aktivitetit të pasur bujqësor që ofron kjo zonë. Dendësia bie në 82.73 banorë / km² në qarqet e Elbasanit, Beratit dhe Lezhës; dhe në 53.0 banorë / km² në qarqet e Shkodrës, Dibrës, Korçës dhe Vlorës. Dy zonat më pak të populluara janë Kukësi dhe Gjirokastra, më një vlerësim të dendësisë së popullsisë më 25.03 banorë / km².

Popullsia Urbane. 54% e popullsisë shqiptare jeton në zonat urbane. Duke krahasuar të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe llogaritjet e mëvonshme, Shqipëria duket të ketë një rritje të popullsisë urbane më 5% nga viti 2008. Ka një dallim të madh në mes qarqeve, që ndryshojnë nga 73% popullsi urbane në 18%, dhe më një raport max / min më 4. Qarqet si Tirana (73%), Vloca (69%) dhe Durrësi (57%) kanë normat më të larta të urbanizimit, si qendrat kryesore pritëse, dhe si rezultat i migrimit të lartë të popullsisë rurale. Ndërkohë zonat më përqindjen më të ulët të urbanizimit janë ato të Dibrës (18%), Kukësit (23%), Lezhës (32%), Fier (32%) dhe Elbasanit (36%).

Indeksi punësimit sipas sektorëve. Tre sektorët kryesorë të punësimit në Shqipëri janë sektori publik më një për llogaritje prej 18.1% të popullsisë së përgjithshme; sektori jo-bujqësor privat më 37.7%; dhe sektori bujqësor privat më 44.2% të punësimit total. Qarqet e Durrësit dhe Tiranës në rajonin metropolitan, ato të Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës në jug dhe jug-lindje të vendit, kanë normat më të larta të sektorit jo-bujqësor privat, dhe kjo për shkak të këto rajone përfaqësojnë ato pjesë të vendit, ku është vendosur dhe zhvillohet industria


kryesore e lehtë dhe e ofrimit të shërbimeve në vend, duke pasur parasysh këtu industrinë e agro-biznesit dhe gjithashtu sektorin e turizmit (si atij malor dhe atij detar). Ndërkohë shkalla më e lartë e sektorit të bujqësisë private të gjendet në rajonet veriore të Shqipërisë (qarqet e Shkodrës, Kukësit, Lezhës dhe Dibrës) dhe në pjesën qendrore (në qarqet e Elbasanit, Fierit dhe Beratit), ku ndodhen edhe tokat më pjellore të vendit.

Vlerësimi i papunësisë. Shkalla e përgjithshme mesatare e papunësisë në vend është 13.1%. Bazuar në ndarjet e qarqeve, normat më të larta të papunësisë janë në Shkodër më 20.48% dhe në Durrës më 18.18%, ndërsa norma më e ulët e papunësisë është në Dibër dhe Kukës më 6.11% dhe 7.02%. Niveli mesatar i normës së papunësisë gjendet në Vlorë më 12.1%, në Korçë më 10.21% dhe në Tiranë më 13.83%.

Të ardhurat për frymë. Normat më të larta të të ardhurave për frymë janë llogaritur të jenë në qarqet e Tiranës dhe Durrësit të rajonit metropolitan më 8,992.65 lekë, ndjekur nga qarku i Vlorës më 7,647.71 lekë. Normat më të ulëta janë në qarqet e Beratit dhe Lezhës, më 3,091.2 lekë dhe 2,991.16 lekë.


Investimet për frymë, në nivel qarku. Mesatarja e investimeve për frymë në nivel qarku është 2,849 lekë. Ndërkohë shkalla më e lartë e investimeve për frymë është në qarkun e Gjirokastrës më 4,787.69 lekë, duke u pasuar nga qarku i Dibër më 4,083.51 lekë. Kjo shpjegohet më faktin së Gjirokastra është një nga zonat nën mbrojtjen e UNESCO-s, ku ndër vite është investuar dhe vazhdon të promovohet më tej zhvillimi i turizmit; dhe Dibra, si një nga zonat më pak të integruara e më zhvillimin më të ngadaltë. Në anën tjetër niveli më i ulët i investimeve për frymë është në qarqet Elbasan dhe Fier, përkatësisht më 2,125.35 lekë dhe 2,373 lekë

PËRBËRJA DHE ZHVILLIMI SOCIAL




Harta 1: Analiza Sociale, Ekonomike dhe Zhvillimore në territorin e Shqipërisë

ZHVILLIMI EKONOMIK



ZHVILLIMI TERRITORIAL



2.3 PARIMET PËR VIZIONIMIN

Analizimi i dy rasteve studimore që morëm në konsideratë, Holandë dhe Itali na ndihmojnë të kuptojmë së ngritja e një vizioni kombëtar hapësinor për vendin tonë ka nevojë për t'u mbështetur mbi disa principe/parime bazë, të cilat do të ndërtojnë mbi potencialet ekzistuese të vendit dhe do të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Pas përcaktimit të këtyre parimeve, do të jetë e nevojshme që secili prej tyre të shpjegohet konkretisht përmes një serie konceptesh hapësinore. Duke mësuar nga këto dy raste studimore ilustruese, si dhe duke u nisur nga përfundimet e nxjerra gjatë analizës së kontekstit për vendin tonë arrijmë të formulojmë 4 principe bazë mbi të cilat mund të mbështetet vizioni jonë hapësinor kombëtar:

1. Rajonet dhe Zhvillimi Rajonal. Këto dy koncepte bazohen në krijimin e njësisve më të vogla territoriale, të cilat konsistojnë në implementimin dhe krijimin e institucioneve përkatëse që kanë identitete të caktuara dhe karakterizohen nga aktivitete kolektive brenda një njësie/rajoni të caktuar gjeografik. Por gjithashtu këto koncepte mund të shihen edhe si ideologji politike, të cilat fokusohen në interesin e një ose disa njësisve/rajoneve në të njëjtën kohë, qoftë kjo në mënyrën tradicionale ose formale.

Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar “Platformës së Co-PLAN për Parlamentin Shqiptar në lidhje me Qeverisjen e Territorit” në vitet 2003-2005 (dokumentuar nga Aliaj në “Misteri i Gjashtë” 2008); si dhe “Platformës së Co-PLAN në vitin 2014” (Shutina, Toto, Gjika, 2014) më dy propozime për riorganizimin e qeverisjes

rajonale dhe ndarjen administrative të Shqipërisë (Kuvendi i Shqipërisë, 2014), ku prezantohen dy alternativa për organizimin kombëtar hapësinor të territorit Shqipëtar në 4 deri në 6 rajone.

2. Policentrizmi dhe Polet e Zhvillimit. Policentrizmi, bazuar në teorinë e Palmiro Togliatti-t (Itali), i referohet organizimit të një rajoni rreth disa qendrave politike, sociale e financiare. Një shtet quhet policentrik nëse popullsia e tij është e shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në disa qendra të pjesëve të ndryshme të territorit të tij. Ideja kryesore që shpjegon “polet e zhvillimit” është së zhvillimi ekonomik, ose rritja, nuk është uniforme mbi të gjithë rajonin, por zhvillohet rreth një poli të caktuar, ose mer formën e një aglomerimi (Rodrigue, Comtois, Xhoko, 2013). Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar modelit të Aliaj (Misteri i Gjashtë, 2008), i cili konsideron disa pole zhvillimi në vend, duke iu referuar rëndësisë së tyre historike, prezencës së traditës së administratës dhe shërbimeve rajonale, afërsisë më vendet fqinje, ose polet e tjera të rritjes, etj.

Në këtë kontekst krahas rajonit metropolitan Tiranë, Durrës, Elbasan, janë identifikuar edhe 6 pole të tjera zhvillimi, të cilat ndërlidhen edhe më potencialet e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkufitare:

- Poli i Shkodrës (Shkodër-Lezhë + Ulqin-Podgoricë)
- Poli i Kukësit (Peshkopi-Kukës-Has-Tropojë + Gjakovë-Prizren- Dibër).
- Poli i Korçës (Korçë-Pogradec + Strugë-Ohër-Bitola-Konicë)
- Poli i Gjirokastrës (Gjirokastrë-Sarandë + Korfuz-

Igumenicë-Janinë).

- Poli i Vlorës (Lushnjë-Berat-Fier-Vlorë + Bari).
- Poli i Tiranës (Tiranë-Durrës-Elbasan-Krujë + Bari).

3. Koridoret e Zhvillimit dhe Zonat e Lira Ekonomike.

Korridoret e Zhvillimit sigurojnë lidhje midis nyjeve dhe qendrave të ndryshme ekonomike ose të urbanizuara, përgjatë një zone të caktuar gjeografike. Ato funksionojë si një sistem i vetëm, ose sipas kushteve të caktuara të rrjetit në të cilit bazohen. Zonat e Lira Ekonomike i referohen caktimit të zonave të pajisura mirë me infrastrukturë dhe shërbime, në të cilat kompanitë e ndryshme që operojnë taten shumë pak, ose aspak për të nxitur aktivitetin ekonomik.

Për rastin e Shqipërisë, kjo mund të përkthehet duke iu referuar modeleve të Aliqj dhe Toto (Universiteti Polis: Laboratori i “Planifikimit Rajonal” dhe Studio e “Planifikimit të Qëndrueshëm” 2010-2014). Kjo qasje konsideron potencialet më të rëndësishme historike, natyrore dhe trungun kryesor të infrastrukturës, si instrumente të rritjes së orientuar në formën e një koridori. Kontribut shtesë për këtë parim kanë dhënë edhe “Ministria e Transportit” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës”, të cilat kanë identifikuar në vitin 2007 shtatë zona ekonomike, ose të ashtuquajtura “parqë industriale”, ku përfshihen: Shkodra, Kopluku, Shëngjini, Lezha, Spitalë-Durrës, Elbasani dhe Vlora.


4. Potencialet Natyrore dhe Koridoret e Gjelbërta. Në anën tjetër termi i “Koridoreve të Gjelbra” përfaqëson zona-habitat, të cilat lidhin popullsitë e kafshëve të egra, të ndara si rezultat i zhvillimit urban dhe aktiviteteve njerëzore. Në rastin e fundit është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë

komponenti “ekologjik” që i referohet atyre koncepteve të planifikimit që sigurojnë një marrëdhënie të shëndetshme midis mjedisit të ndërtuar dhe të natyrës (McHarg, Design with Green, 1969).


Për rastin e Shqipërisë kjo mund të përkthehet në një koncept, i cili është ndërsektorial më të gjitha nivelet e qeverisjes së mirë, veçanërisht të atyre që lidhen fort me shqetësimet mjedisore. Në këtë pikë të pasurit parasysh të potencialeve topografike të Shqipërisë; pikave të nxehta kryesore shqetësuese mbi mjedisin; të tokave bujqësore dhe zonave të mbrojtura, etj; do të na çojë drejt krijimit të një rrjeti zonash të reja prioritare për zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe krijimin e koridoreve të gjelbra, për të formuar më tej një strategji kombëtare që adreson këto çështje.

2.4 KONCEPTET HAPËSINORE

Përmes analizës dhe detajimit të çdo parimi mbi territorin shqiptar, konceptet hapësinore do të shpjegojnë në detaje secilin parim, për të orientuar politikën e lidhura me territorin dhe udhëzimet përkatëse, si për institucionet kombëtare, ato rajonale dhe lokale. Kombinuar me teknikat e vizualizimit, dhe duke krijuar materiale hartografike, këto koncepte hapësinore do të përfaqësojnë imazhe të qarta të zhvillimit të dëshiruar hapësinor (KUNZMANN, 1996). Është shumë e rëndësishme të përmendet së përfshirja e teknikave të vizualizimit dhe prodhimi i materialeve hartografike, mund të ndihmojë për të ngritur vëmendje për çështje të rëndësishme hapësinore, për të komunikuar mesazhe dhe për të nxitur veprime deri në nivelet më të ulëta të qeverisë (DUHR, 2007).



Vizioni i Zhvillimit Kombëtar Hapësinor



.....
 Harta 2: Rrjeti i Lidhjeve para viteve '90-të;
 Rrjeti i Lidhjeve sipas Vizionit të Shqipëria 2030.

Në rastin e Shqipërisë, kjo do të thotë së në mënyrë që të ndërtohet një sistem modern i planifikimit kombëtar hapësinor është e rekomandueshme të lidhet baza e përditësuar rregullisht e të dhënave statistikore të INSTAT-it, më të dhënat fizike të GIS-it të AKPT / MZHUT, në mënyrë që të prodhohen në çdo kohë materiale hartografike dhe imazhet vizuale, të cilat do të ndihmojnë politikën moderne dhe vendimarrjen.


3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për më shumë së 2 dekada Shqipëria ka ndryshuar nga një shoqëri ekstremisht e planifikuar, në një prej ekonomive më liberale të Europës. Kjo ka gjeneruar energji pozitive, por ka krijuar edhe mjaft probleme dhe efekte negative, përfshi urbanizimin agresiv, informalitetin masiv, ndotjen e mjedisit, ineficencën e investimeve, etj.

Deri më tani reformat e planifikimit kanë qenë të fokusuar në nivelin urban, dhe nuk patur veprime konkrete për sa i takon politikave territoriale kombëtare të planifikimit dhe zhvillimit hapësinor. Por ndërsa Shqipëria i ka hyrë procesit të integritit të plotë në BE, kjo situatë shkon ndesh më orientimet e ESDP (European Spatial Development Program) dhe ESPON (European Spatial Planning Observation Network).


Në këtë mënyrë shumica e problemeve të krijuara gjatë kësaj kësaj periudhe, mund të adresohen nën autoritetin e politikave kombëtare dhe planifikimit hapësinor kombëtar.

Me qëllim që të ndryshojë situata, autoritetet duhet urgjentisht të fillojnë një proces për të ushtruar kompetencën e dizenjimit dhe miratimit të një “Plani Hapësinor Kombëtar Zhvillimi” dhe një “Dokumenti Politikash”, por për të ndërmarrë këtë hap atyre u duhet një metodologji, mjete e teknika, si dhe ekspertizë. Ky dokument kërkimor përpiqet të japë një kontribut paraprak që mund të ndihmojë në këtë drejtim. Gjetjet dhe rezultatet e këtij kërkimi mund t’u shërbejnë institucioneve publike e private të interesuara rreth kësaj teme për të hapur një debat e për të demistifikuar mungesën e eksperiencës dhe njohurive. Përmes kësaj pune autoritetet mund të kuptojnë më mirë:



.....

*Bujësia, Masivi
Qëndror Malor dhe
Polet e Zhvillimit.*



.....
*Vizioni i Zhvillimit
Kombëtar Hapësitor*

- Çfarë është planifikimi hapësinor?
- Cilat janë mjetet teknike dhe grafike për të përgatitur një plan hapësinor?
- Cilat janë disa nga idetë dhe inspirimet e para fillestare për të zhvilluar një plan të tillë për Shqipërinë?

Natyrisht një plan kombëtar hapësinor dhe një dokument politikash do të kishin nevojë për një konsensus të gjerë dhe një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të sa më shumë aktorëve. Për këtë qëllim qeverisë i duhet patjetër të ndërtojë një sistem kombëtar gjeografik informacioni (GIS), duke kombinuar të dhëna topografike nga fotografitë ajrore, më të dhënat statistikore të INSTAT. Përmes kësaj, mund të hartohen Map 2: Connectivity before '90s; Connectivity according to Albania 2030 Vision. mjaft harta tematike, të cilat ndihmojnë për të kuptuar problemet reale dhe rekomandojnë zgjidhjet e nevojshme. Mbi këtë bazë institucionet e specializuara të planifikimit mund të zhvillojnë një plan kombëtar hapësinor për vendin. Ndaj nga një koncept i mbyllur (në formë 8 tete) i infrastrukturës kryesore të aksesit kombëtar, i cili karakterizonte vendin para viteve '90-të; vizioni hapësinor i zhvillimit në këtë studim promovon zhvendosjen drejt një sistemi radial-unazor, duke filluar nga rajoni i kryeqytetit drejt poleve të rritjes periferike dhe zonat ndërkufitare të interesave përkatëse.

Një rekomandim tjetër, është zbatimi i konceptit të 6 rajoneve administrative sipas modeleve të qarta social-ekonomike dhe më identitete të specializuara. Bazuar mbi këtë koncept:

- Rajonet e Voskopojës dhe ai Metropolitan do të jenë të fokusuar në infrastrukturën dhe shërbimet strategjike rajonale dhe ndërkombëtare;
- Rajonet e pjesës veriore dhe jugore të vendit do të fokusohen në zhvillimin e turizmit detar dhe malor;
- Ndërsa dy rajonet e tjera të mbetura do të përqendrohen në aktivitetet kryesore ekonomike, si bujqësia, industria minerare dhe energjitika.
- Kjo perspektivë duhet të promovojë një ekonomi të qëndrueshme, duke u bazuar në katër shtylla ekonomike: Bujqësi, Energji, Turizëm, Miniera, përmes aplikimit të instrumenteve të policentrizmit dhe poleve të zhvillimit;
- Ajo duhet të stimulojë përcaktimin e qartë dhe fuqizimin e korridoreve të specializuara ekonomike, natyrore dhe kulturore, si dhe të zonave të zhvillimit të lirë ekonomik, në funksion të rajonalizimit dhe zhvillimit rajonal;
- Zhvillimi infrastrukturor (rrugë, porte, aeroporte) duhet të balancohet me zhvillimin ekologjik, dhe të kompensohet me shtimin dhe konsolidimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura dhe ekologjike emerald, si dhe me krijimin e një rrjeti kombëtar të gjelbër, përmes një fushate kombëtare veprimi, për krijimin e një identiteti të ri kombëtar.

Një rekomandim final më rëndësi i Manifestit “Shqipëria 2030” për kërkim të mëtejshëm, është së shumica e praktikave të planifikimit hapësinor kombëtar bazohen zakonisht në skenare entuziaste (pozitive) zhvillimi, të cilat nuk janë domosdoshmërisht më realitet. Për më tepër vizione të tilla mund të jenë vërtetë inspiruese për të inkurajuar shoqërinë,

por mund të janë edhe jorealiste e të parealizueshme. Kjo mund të dëmtojë vetë reputacionin e instrumentit të planifikimit hapësinor kombëtar midis aktorëve të interesuar.

Për këtë arsye, po pranohet gjithnjë e më shumë nga të gjithë së paralel më skenaret “pozitivë”, duhet zhvilluar edhe i ashtuquajtur “Skenari i Planit B”, ose një metodologji e planifikimit hapësinor kombëtarqë bazohet tek “vlerësimi i rrisqeve” dhe “skenaret e shkatërrimit ose fatkeqësive në nivel global-rajonat”, si për shembull: ngrohja globale, rritja e nivelit të detit, përmytjet, katastrofat sizmike, luftrat dhe destabilizimi social, epidemitë pandemike, etj.

Literatura:

1. Aliaj, B.; Shutina, D.; Dharmo, S. (2010): “Between Energy and the Vacuum: Co-PLAN and Urban Planning in Albania”, Tirana, Albania.
2. Aliaj, B. (2008): “Misteri i Gjashtë: Cili është kurthi që mban peng zhvillimin dhe integrimin e ekonomisë shqiptare më botën moderne?”, Tirana, Albania.

3. Aliaj, B. (2004): "Albania, a short history of housing and urban development models during 1945-1990", "Making Cities Work", Tirana, Albania.
4. Alterman, R. (2001): "National-Level Planning in Democratic Countries: An International Comparison of City and Regional Policy-making", Liverpool University Press, Liverpool.
5. Belhedi, A. (2005): "Epistemologie de la geographie: La chorematisation", Tunis. (<http://epigeo.voila.net/chorematisation.htm>)
6. Communities and Local Government (2006): "The Role and Scope of Spatial Planning: Literature Review".
7. Commission of the European Communities- CEC (1999): "Report on Community Policies and Spatial Planning. Working Document of the Commission Services", Brussels: European Commission.
8. Corner, J. (1999) "Recovering Landscape, Essays in Contemporary Landscape Architecture", Princeton University Press, New York, USA.
9. CPG / Editorial Group (2006): "The Territorial State and Perspective of the European Union Document: Towards a Stronger European Territorial Cohesion in the Light of the Lisbon and Gothenburg Ambitions", Brussels, Belgium.
10. Department of Arts, Heritage and the Gaeltacht (2011): "A National Landscape Strategy for Ireland".
11. Çobo, E.; Toto, R. (2010): "Planifikimi i territorit- Nga ligji në reformë", "Politikndjekës apo Politikbërës 1: Alternativa mbi zhvillimin urban, manaxhimin e territorit dhe të mjedisit", Polis Press, Co-plan, Tirana.
12. Toto, R. (2012): "Raport i Situatës së Planifikimit të Territorit në Shqipëri", "Politikndjekës apo Politikbërës 2: Analiza dhe Rekomandime për qeverisjen territoriale në Shqipëri", Polis Press, Co-plan, Tirana, Albania.

13. Dühr, S. (2007) "The Visual Language of Spatial Planning: exploring cartographic representations for Spatial Planning in Europe".
14. European Commission (1997): "Compendium of European planning systems. Regional Development Studies", Report 28, Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg.
15. European Commission (1997): "Compendium of European Spatial Planning".
16. ESPON (2011): "Nordic- Baltic ESPON Conference for Planners and Policy-makers: Transnational perspectives on spatial planning- Experiences from the Nordic- Baltic countries", Stockholm, Sweden.
17. Faludi, A. (2010): "Cohesion, Coherence, Cooperation: European Spatial Planning Coming of Age?".
18. Faludi, A. (2010): "The Performance of Spatial Planning, Planning Practice & Research".
19. Forman, R.T (2008): "Urban Regions. Ecology and Planning Beyond the City", Cambridge University Press, Cambridge.c
20. GCSP- Geneva Center for Security Policy (2006): "Program on the Geopolitical Implications of Globalization and Transnational Security: Definitions of Globalization, a Comprehensive Overview and a Proposed Definition".
21. Kuzmann, K.R (1996): "Euro-megalopolis or themepark Europe? Scenarios for European Spatial Development", International Planning Studies.
22. McHarg, Ian L. (1969): "Design with nature", (Wiley Series in Sustainable Design).
23. Ministeries van VROM, LNV, VenW, EZ en OCW (2006): "Nota Ruimte en de Uitvoeringsagenda Ruimte", The Netherlands.
24. Ministry of Infrastructure and the Environment (2012): "35

Icons of the Dutch Spatial Planning”, The Hague.

25. Ministry of Infrastructure and the Environment (2011): “Summary National Policy Strategy for Infrastructure and Spatial Planning: Making the Netherlands competitive, accessible, livable and safe”, The Hague, The Netherlands.

26. Özkan, Ö. (2008): “Strategic Way of Design in Rem Koolhaas’ Parc de la Villette Project”, Middle East Technological University.

27. PLUREL (2010): “National Spatial Planning Policies and Governance Typology”, Report.

28. Rodrigue, J.P.; Comtois, C.; Slack, B. (2013) “The Geography of Transport System”, Third Edition, New York, USA.

29. UNECE (2008): “Spatial Planning- Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition”, Report ECE/HBP/146, Geneva, Switzerland.

30. UNDP; ILD Peru; Government of Albania (2007): “Albania: transition to the rule of law and inclusive market economy”, Lima, Peru.

31. Vincent Nadin, Dominic Stead (2008): “European Spatial Planning Systems, Social Models and Learning”, Delft University of Technology, The Netherlands.

32. Waldheim, C. (2006): “The Landscape Urbanism Reader”, Princeton University Press, New York, USA.

33. Waterhout, B. (2008): “The Institutionalization of European Spatial Planning”, PHD Thesis, TU Delft, The Netherlands.

34. Wilbanks, T. (2007): “The Research Component of the Community and Regional Resilience Initiative (CARRI)”, Presentation at the Natural Hazards Center, University of Colorado-Boulder.

35. Zepf M.; Andres L. (2011): “New articulations and new challenges in spatial planning”.

②

PROBLEMET E HUMBJES SË TOKËS NË SHQIPËRI NË KËNDVESHTRIMIN E DITËS DHE VITIT NDËRKOMBËTARTË TOKËS

Prof.Dr. Sherif Lushaj

“Në e shpërdorojmë tokën, pasi e konsiderojmë si një komoditet që na përket neve. Vetëm, kur tokën ta konsiderojmë si një komoditet, të cilës në i përkasim, do të fillojmë ta trajtojmë më dashuri dhe respekt”

Aldo Leopold

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ka shpallur datën 5 Dhjetor si “Dita Ndërkombëtare e Tokës” dhe vitin 2015 “Viti Ndërkombëtare i Tokës”. Kjo nisëm ka nisur më propozim të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencës së Tokës, që bashkon mbi 60,000 shkencëtarë të tokës, si dhe të Organizatës të Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO), të shqetësuar nga problemet e humbjes dhe degradimit të tokës në nivel global, nga kontraditat midis zhvillimit urban dhe zënies së tokave produktive bujqësore, nevojat e popullsisë në rritje për ushqime, veshje, dhe në kushtet kur popullsia globale parashikohet të arrijë në 9 miliardë banorë në vitin 2050.

Shqipëria ka burime tokësore të kufizuara. Në sipërfaqen e përgjithshme të territorit të vendit prej 2,874,800 ha, përfshihen 699,500 ha tokë bujqësore (24.4 %), 1,062,770 ha pyjet (36.9 %), 414517 ha livadhe e kullota(14.4 %) dhe 699.013 ha (24 %) sipërfaqet e tjera (ujore, urbane, të zëna nga infrastruktura e ndërtuar, toka pa frutë etj). Fenomenet e degradimit fizik, kimik dhe biologjik të burimeve tokësore janë të larta. Në këtë këndvështrim, trajtohen disa aspekte të disponibilitetit të burimeve tokësore në vendin tonë, problemet e humbjeve dhe të degradimit si dhe konceptet dhe përgjegjësitë e mbrojtjes afatgjatë në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga bujqësia e vendit sigurohet rreth 20 % e prodhimit të përgjithshëm bruto. Por nevojat e popullsisë për produkte ushqimore bujqësore, plotësohen kryesisht nga importi edhe për shkak të përdorimit të tokës në masën 60-65 %. Raporti midis eksportit dhe importit është 1:8-9, gjë që tregon për një raport të ç'balancuar të prodhimit vendas. Përdorimi kaotik i tokës në periudhën e tranzicionit pas vitit 1991 më privatizimin e tokës, nisi në zonat sub-urbane, ku gjenden edhe tokat më produktive. Edhe në nivel global, në vitin 1990, vetëm 10 % e popullsisë jetonte në zonën urbane, u rrit në 50 % në vitin 2007, ndërsa në vitin 2050 parashikohet të jetë 75 %. Një lëvizje e tillë shoqërohet më ushtrimin e një presioni urban mbi burimet tokësore dhe ndikimet në degradimin e tokës dhe mjedis. Në Shqipëri popullsia urbane nga 35 % në vitin 1990, arriti në 53 % brenda 20 vjetëve, duke ushtruar presion mbi burimet natyrore, veçanërisht në zonën bregdetare. Në shumë zona dallohen qarte efektet e ndotjes mjedisit dhe mungesën e burimeve tokësore.

1.1.1 TOKA PASURIA MË E MADHE KOMBËTARE PËR SOT DHE GJENERATAT E ARDHSHME


Toka është pasuria më e madhe kombëtare, për sot dhe gjeneratat e ardhshme dhe një kusht themelor për zhvillimin e shoqërisë, sigurimin e produkteve ushqimore dhe nevojave të tjera të popullsisë. Por në kushtet e vendit tonë , kur disponohet mesatarisht 0.18 ha/toke bujqesore/banor dhe në mungese të planifikimit hapësinor më standarde, të urbanizimi kaotik, ndryshimit të përdorimit të tokës në dem të zhvillimit të qëndrueshme të bujqësisë, kërkohen ndryshime rrënjësore ligjore dhe administrative për mbrojtjen e burimeve tokësore produktive. Planifikimi i përdorimit të tokës duhet të vendosë balancë të reja të qëndrueshme për mbrojtjen e tokave produktive bujqesore, të shprehen qarte lidhjet e dobishme urban-rurale më synim mbrojtjen e tokës, përmirësimin e shërbimeve, rritjen e prodhimit e të mirëqenies, planifikimi të jetë i dëshiruar për përdoruesit e tokës dhe interesat kombëtare e rajonale, të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe interesat e brezave të ardhshëm.

Pakësimi i tokës prek direkt interesat e gjeneratave të ardhshme

Të mos harrojmë së Shqipëria është një vend malor, ku vetëm 16 % e territorit shtrihet në lartësinë më pak së 100 m mbi nivelin e detit, gjë që dikton nevojën e mbrojtjes së çdo m² toke produktive si nga pakësimi i sipërfaqes fizike dhe ulja e kapaciteteve prodhuese. Toka bujqësore në 43.3 % të sipërfaqes shtrihet në zonën fushore dhe 56.7 % në zonën

malore dhe kodrinore. Rreth 60 % e territorit të vendit është nën “stresin” human të degradimit: erozioni në vlera 2-3 herë më i lartë në krahasim me vendet e Mesdheut, rrëshqitjet, mbi kullotja, përmytjet, kripëzimi, rrënja e pjellorisë tokës dhe lëndës organike, reduktimit të mbulesës bimore, erozioni detar dhe lumor. Erozioni, humbja e mbulesës tokësore, ndërthurjet në lumenj, zgjerimi i kripëzimit në zonat bregdetare, fenomenet e shkretimit, fragmentimi i tokës, rrënja e kapaciteteve prodhuese janë disa nga shqetësimet më serioze. Në rreth 25 % të territorit, risku i erozionit varion në limitet 60-180 ton/ha/vit

Në nivel global toka siguron mbi 90% të nevojave për popullsinë. Është mjedisi që plotëson nevojat në rritje të popullsisë për ndërtimet familjare, social-kulturore, sportive, veprimtaritë ekonomike, infrastrukturën dhe materialeve të ndërtimit etj. Është fakt se komunitetet e hershme bujqësore kanë përparuar drejt qytetërimit në sajë të tokave të shëndetshme, rritjes ekonomike dhe përmirësimeve të përdorimit të tokës. Rritjen e kapacitetit prodhues dhe teknologjive të avancuara kanë mundur transformimin e bujqësisë tradicionale në bujqësi moderne dhe në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshme rural. Por cilat janë kapacitetet tokësore në Shqipëri, cilat janë problemet dhe rreziqet, si adresohen përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse në interesat e brezave që vijnë ? Në këtë këndvështrim, do të trajtojmë disa aspekte të disponibilitetit të burimeve tokësore në vendin tonë, problemet e humbjes dhe të degradimit si dhe konceptet dhe përgjegjësitë e mbrojtjes në kontekstin e planifikimit hapësinor, planifikimit të përdorimit të tokës dhe mbrojtjes nga degradimi.



Grafiku 1. Struktura e Përdorimit të Tokës

Ndërsa në vendet e Evropës sipërfaqja e tokës, e cila përdoret për bujqësi dhe pyje, ndaj sipërfaqes së përgjithshme është 8-10 % më e lartë, në krahasim më % e tokës të përdorur për këtë qëllim në vendin tonë. Megjithatë, fenomenet e degradimit të burimeve tokësore janë të larta. Në 25 vitet e fundit, në vendin tonë shoqëria vazhdon t'i përdorë resurset, tokat, pyjet, ujërat, për të plotësuar nevojat e vazhdueshme jetësore, sikur të mos kishte më një të nesërme dhe pa marrë parasysh së ka një limit, tej të cilit ato humbasin kapacitetet prodhuese, pësojnë degradimin dhe nuk mund të përdoren pa kryer më parë riaftësimin e tyre. Edhe në Shqipëri, koncepti i mbrojtjes të burimeve në funksion të përgjegjësive për gjeneratat mbetet i zbetë dhe i pa publikuar. Në vitin 1992 në Samitin e Rios, termi i "zhvillimit të qëndrueshëm" është përcaktuar së "është ai lloj zhvillimi, i cili përmbush nevojat e gjeneratës së tashmë pa

kompromentuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme për të plotësuar nevojat e tyre” (Brundtland 1987). Akoma nuk është kuptuar së zhvillimi i qëndrueshëm bashkon zhvillimin e ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit dhe nëse çënohet mjedisi nuk do të këtëzhvillim të qëndrueshme.

Në fakt në realitetin e shoqërisë së sotme shqiptare, parimi së nëse ka ‘zhvillim’, domethënë rritje ekonomike edhe dy komponentët e tjera do të rregullohen vetvetiu ka nxitur përdorimin e resurseve në funksion të ekonomisë fitimprurëse dhe jashtë kritereve dhe raporteve normale në përdorimin e tokës më ndërtime, prerjen e pyjeve, shfrytëzimin e lumenjve, duke shkaktuar përmbytje të tokave dhe qendrave të banuara. Por për një zhvillim të qëndrueshëm ka nevojë të zbatohen parimet kryesore të barazisë të ndërgjeneratave, barazia brenda gjeneratës, barazia gjeografike dhe barazia midis specieve për mbrojtjen e biodiversitetit.

Shqipëria ka burime tokësore të kufizuara dhe sipërfaqja e tokës bujqësorezë vetëm 24 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të vendit (grafiku 1). Ndërsa në vendet e Europës sipërfaqja e tokës, e cila përdoret për bujqësi dhe pyje, ndaj sipërfaqjes së përgjithshme është 8-10 % më e lartë, në krahasim më % e tokës të përdorur për këtë qëllim në vendin tonë. Megjithatë, fenomenet e degradimit të burimeve tokësore janë të larta. Në 25 vitet e fundit, në vendin tonë shoqëria vazhdon ti përdorë resurset, tokat, pyjet, ujërat, për të plotësuar nevojat e vazhdueshme jetësore, sikur të mos kishte më një të nesërme dhe pa marrë parasysh së ka një limit, tej të cilit ato humbasin kapacitetet prodhuese, pësojnë degradimin dhe nuk mund të përdoren pa kryer më parë riaftësimin e

tyre. Edhe në Shqipëri, koncepti i mbrojtjes të burimeve në funksion të përgjegjësive për gjeneratat mbetet i zbehtë dhe i papublikuar. Në vitin 1992 në Samitin e Rios, termi i “zhvillimit të qëndrueshëm” është përcaktuar së “është ai lloj zhvillimi, i cili permbush nevojat e gjeneratës së tashme pa kompromentuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme për të plotësuar nevojat e tyre” (Brundtland 1987). Akoma nuk është kuptuar së zhvillimi i qëndrueshëm bashkon zhvillimin e ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisi dhe nëse cenohet mjedisi nuk do të këtëzhvillim të qëndrueshem.

Në fakt në realitetin e shoqërisë së sotme shqiptare, parimi së nëse ka ‘zhvillim’, domethë rritje ekonomike edhe dy komponentët e tjera do të rregullohen vetvetiu“ ka nxitur përdorimin e resurseve në funksion të ekonomisë fitimpruese dhe jashtë kriterëve dhe raporteve normale në përdorimin e tokës më ndertime, prerjen e pyjeve, shfrytëzimin e lumenjve, duke shkaktuar përmbytje të tokave dhe qendrave të banuara. Por për një zhvillim të qëndrueshëm ka nevojë të zbatohen parimet kryesore të barazisë të ndër-gjeneratave, barazia brenda gjeneratës, barazia gjeografike dhe barazia midis specieve për mbrojtjen e biodiversitetit.

1.2.1 PROBLEMET E DEGRADIMIT DHE MBROJTJES TË BURIMEVE TOKËSORE

Mbrojtja e burimeve tokësore, përbën një kusht themelor për zhvillimin e shoqërisë dhe një përparësi kombëtare në drejtim të shfrytëzimit racional të tyre. Tokat e ndotura në sipërfaqë të gjëra në vend , nëpërmjet zinxhirit ushqimor

përcjellin elementët toksikë nga toka në bimë, nga bima në kafshë dhe nëpërmjet produkteve ushqimore dhe ujit përfundojnë në organizmin e njeriut, duke shkaktuar sëmundje akute dhe kronike. Rreziqet më të mëdha aktuale për tokat e Shqipërisë janë konsumi i tokës bujqësore në truall për ndërtime, degradimi, fizik, kimik dhe biologjik (duke veçuar erozionin si më problematik) dhe ndotja si faktor në degradimin e tokës dhe rreziqet shëndetësore për popullsinë.

1.2.2.KONSUMI I TOKËS BUJQËSORE NË TRUALL PËR NDËRTIME

Shqipëria disponon sipërfaqë të kufizuar të tokës bujqësore, në krahasim më vendet e Evropës për dy tregues kryesore, (i) sipërfaqja e tokës bujqësore për banor dhe (ii) % e tokës bujqësorendaj sipërfaqes së përgjithshme të territorit. Sipërfaqja e tokës bujqësore për çdo banor është mesatarisht më pak së 0.18 ha (nga 0.38 ha në vitet 1970 dhe prirja është drejt uljes), nga 2.15 ha Australia, 0.46 ha Hungaria, 0.53 ha SHBA, 0.42 ha Finlanda etj. Toka bujqësorenë vendin tonë përbën 24 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit, nga 33-57 % që zotërojnë vende si Danimarka, Hungaria, Republika Ceke, Franca, Gjermania, Polonia, Rumania, Serbia etj.

Por megjithëse radhitet ndër vendet më sipërfaqë më të ulët të tokës bujqësore, që vjen gradualisht në ulje, në 20 vjetët e fundit konsumi i tokës bujqësore më ndërtime (tërësore dhe pjesore) zë rreth 70 mijë ha ose 10 % të sipërfaqes të përgjithshme të tokës bujqësore. Më shumë

së 70% e kësaj sipërfaqë shtrihet në zonën surburbane e bregdetare, toka më kapacitet të lartë prodhues, duke krijuar edhe një situatë kaotike të urbanizimit.

Nëse normat aktuale të urbanizimit dhe të degradimit të tokës do të mbeten të pandryshuara më ato të 20 viteve të fundit, atëherë në vitin 2050, toka bujqësore parashikohet të ulet edhe 20-25 % nga gjendja e sotme, norma për frymë do të reduktohet dhe siguria e brezave të ardhshëm vihet në vështirësi serioze, për shkak të humbjes të një pasurie që prodhon, akumulon, përsëritet çdo vit dhe plotëson kërkesat e vazhdueshme.

Zhvillimi qëndrueshëm dhe siguria e brezave të ardhshëm do të cenohet, kapaciteti prodhues i tokës bujqësore do të zbrësë në 60-65 % të kapacitetit të mundshëm, raporti midis eksportit dhe importit të produkteve mund të mbetet në nivelet aktuale që është 1:7-8. Prandaj toka (dheu) nevojitet të vlerësohet në të gjitha kategoritë e përdorimit: toke bujqësore, pyjore, urbane. Vendet e Evropës Perëndimore, SHBA dhe Kanada, të cilat vuajtën mungesën e ushqimit gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërtuan strategji afatgjata për mbrojtjen e tokës nga urbanizimi dhe degradimi. Ligj Shqiptar Nr.9243, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", parashikon edhe mbrojtjen nga urbanizimi pa kriter dhe detyrat për Institucionet përgjegjëse, por ligji vazhdon të mos gjejë zbatimin e duhur. Përveç humbjes së tokës nga urbanizimi pa kriter, nga erozioni në brigjet e lumenjve humbasin 25-50 ha toke në vit, rreth 20 % e tokës bujqësore mbetet e pakultivuar (djerr), duke u predispozuar ndaj degradimit dhe humbjes së kapaciteteve prodhuese.

Në kushtet, kur tregu po ngopet më ndërtime kërkohet një vizion tjetër i planifikimit hapësinor nga Institucionet qendrore e lokale për të vendosur balanca të reja të qëndrueshme të përdorimit të tokës, mbrojtja e tokave produktive bujqesore. Zonat peri-urbane më gjithë transformimin e shpejtë urban, përsëri ka sipërfaqe, të cilat mund të perdoren për bujqësi. Tokat urbane më bujqësinë kopshte bëjnë një rezervë të rëndësishme për sigurimin e produkteve ushqimore në të gjithë vendin, por veçanërisht në zonën urbane dhe surburbane të Elbasanit, Fierit, Vlorës, Korçës, Tiranës etj.

Problemet e humbjes dhe degradimit të tokës në Shqipëri, nga zhvillimet e pa kontrolluara ekonomike dhe sociale, diktojnë nevojën e një planifikimi të integruar për vendosjen e një drejtimi të dëshiruar për të ardhmen e strukturave hapësinore, përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve tokësore, identifikimin dhe rehabilitimin e dëmtimeve, një planifikim të qëndrueshëm, forcimin e ligjit, të Institucioneve dhe kapaciteteve menaxhuese. Ky fenomen, më pasoja ekonomike, sociale dhe mjedisore, mund të ndalet, duke vene në krye të masave planifikimin hapësinor të qëndrueshëm të territorit në nivel rajonal dhe kombëtar. Bazuar në ndryshimet e përdorimit të tokës, nevojitet gjithashtu të kryhet inventarizimi i burimeve tokësore., të cilat në tokat bujqësore e pyjore, ruajnë pothuajse shifrat e vitit 1990 edhe pse ato kanë pësuar ndryshime.

1.2.3 MIGRIMI I POPULLSISË, IMPAKTET NË MBROJTJEN DHE PËRDORIMIN E TOKËS

Pas vitit 1990, në vendin tonë, dallimet midis zonës urbane dhe asaj rurale janë thelluar në mënyrë mbrojtjes dhe përdorimit të tokës. Zona urbane dallohet për përqëndrimin e shpejtë të popullsisë (rreth 53 % e popullsisë të përgjithshme nga 35 % në vitin 1990), por më burime tokësore të pamjaftueshme. Ndërsa në zonën rurale, ku gjenden burimet tokësore të tokës, pyjeve dhe resurseve të tjera, vazhdon migrimi i popullsisë dhe braktisja e tokave. Për më tepër zbrazja e zonës rurale, vazhdon të shkaktojë braktisjen e tokës, abandonimin, mospërdorimin dhe degradimin e vlerave, ku çdo vit në keto zona dhe në zonat tipike të emigrimit mbetet e pakultivuar 20-50 % sipërfaqes të tokave bujqesore.

Në këto kushte është e nevojshme që mbrojtja dhe administrimi i tokave bujqësoretë shqyrtohet në kompleks dhe në përputhje me shkallën e emigrimit të popullsisë dhe më përmirësimin e kushteve të jetesës të popullsisë. Në këtë kontekst nevojitet:

- Së pari të zbatohen politika të përmirësimit të kushteve sociale dhe ekonomike si dhe niveli i shërbimeve, infrastruktures, nivelit ekonomik, më synim zhvillimin rural të qëndrueshëm për të kufizuar lëvizjen e popullsisë,
- Së dyti të nxitet tregu i tokës nëpërmjet politikave favorizuese dhe lehtësimit të procedurave të shitblerjes dhe qiradhenien, më qëllim që nëpërmjet këtij instrumenti të rritet madhësia e fermave bujqesore, eficienta e tyre dhe konsolidimi i tokës,
- Së treti, përmirësime ligjore në drejtim të detyrimeve të pronarëve për përdorimin e tokës dhe
- Së katërti planifikimi i zhvillimit qëndrueshëm hapësinor dhe përdorimit të tokës në zonën rurale.

1.2.4. FRAGMENTIMI DHE KONSOLIDIMI I TOKËS

Fragmentimi i tokës mbetet një faktor tepër kufizues në zhvillimin ekonomik, social e mjedisor të zonës rurale. Nga fragmentimi i tokës bujqësore në 1.8 milion parcela pas privatizimit, nga 200 mijë në vitin 1990, humbje fizike shënon 1-3 % të tokës dhe efektet në uljen e vlerave ekonomike 15-30 %. Edhe pse madhësia mesatare e fermës bujqësore në shkallë vendi është 1.2 ha, ose disa herë më e vogël së sa fermat Evropiane. Në zonën fushore 2-2.5 ha, në zonën malore dhe kodrinore është më e ulët së mesatarja e vendit. në rreth 58 % të fermave bujqësoremadhësia mesatare rezulton tëjetënen 1 ha. Gjithashtu prona është e ndarë mesatarisht në 4 vende, një problem që vazhdon të shkaktoje humbjen e tokës bujqësorenga përdorimi, braktisjen e sipërfaqeve të vogla, uljen e efices, uljen e kapacitetit prodhues në nivelet 60-65 % , uljen e prodhimit 30-35 %, rritjen e kostos së prodhimit deri 40 %, konsumi karburatit 10-15 %, pengesa serioze në zbatimin e teknologjive dhe efektivitetit të imputeve bujqësoredhe lënia e tokës të pa kultivuar deri në 10 mijë ha.

Konsolidimi i tokës mbetet një alternative urgjente për mbrojtjen e tokës, rritjen e prodhimit dhe të ardhurave. në rrugët e konsolidimit të tokës ose bashkimit të pronës, tregu i tokës është një nga mekanizmat e rëndësishëm. Por megjithëse tregu ka filluar qysh në vitin 1991, në vend që të përmirësonte konsolidimin ka çuar në copëtimin e mëtejshme të tokës, pasi nuk është caktuar njësia minimale e kultivimit si dhe tokat bujqësoretë blera janë përdorur kryesisht për ndërtime. Prandaj duhet të miratohet një akt ligjor, ku të përcaktohet njësia minimale e kultivimit, tej të cilës nuk duhet të këtëndarje të parcelave, dhe përdorimit bujqësor pa ndryshuar kategorinë e përdorimit për qëllime të tjera.



Foto nr. Fragmentimi i tokës bujqësore

Kooperimi i fermerëve sikurse është shembulli i Xares në Sarandë, e kthyer në një ekonomi moderne e prodhimit të madh, aplikimi i politikave favorizuese për fermerët që konsolidojnë tokën, nderimet e parcelave midis fermerëve të tokave më vlera të njëjta ose më kompensim kur vlerat nuk janë të njëjta, për të grupuar pronën në një vend të vetëm, janë nga mundësitë e konsolidimit të tokës. Rajonizimi i prodhimit është një domosdoshmëri në kushtet e vendit tonë më ndryshime të theksuara klimatike e tokësore. Eksperienca Amerikane, tregon se si një shtet i vogël, shteti Wisconsin më popullsi rreth 9 milionë banorë, në saj të politikave shkencorë të rajonizimit të prodhimit bujqësor, siguron 23 % të prodhimeve blegtorale të Amerikës dhe emri i dytë i shtetit është “Amerika e bulmetit”.



1.2.6 KONCEPTI MBROJTJES SË BURIMEVE TOKËSORE BAZUAR NË TERRITORIN E PELLGUT UJËMBLEDHËS.

Problemi ka të bëjë më mënyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së burimeve tokësore. Mbrojtja dhe menaxhimi i tokës dhe burimeve vazhdon të bëhet i copëtuar dhe pa efektivitet në pikëpamjen e territorit, në një kohë që modeli më i mirë është (i) planifikimi i përdorimit të burimeve tokësore, (ii) zbatimi i masave mbrojtëse dhe (iii) përdorimi ekonomik i burimeve në konceptin dhe nivelin e çdo pellgu ujëmbledhës. Pra menaxhimi i territorit, zbatimi i masave komplekse mbrojtëse inxhinierike, ekologjike, pyllëzimet dhe përmirësimet pyjore, mbrojtja nga rrëshqitjet, erozioni dhe ujërat e larta, duke filluar nga lart - poshtë në të gjithë territorin dhe jo më objekte të veçanta. Kjo nevojitet pasi ekosistemet veprojnë

të ndërthurura dhe të lidhura më pellgjet ujëmbledhëse si në konceptin ekonomik dhe mjedisor. Toka bujqësore p.sh. aktualisht në zonën rurale dhe urbane vuan nga shkatërrimi i pyjeve përreth tokave bujqësore, duke nxitur degradimin nëpërmjet erozionit, humbjes së lëndëve ushqyese dhe urbanizimit të pa kontrolluar.

Efektet negative të prishjes së sistemeve natyrore ndikojnë më drejtpërsëdrejti mbi popullsinë rurale, pasi jetesa e popullsisë rurale bazohet kryesisht në pasuritë natyrore dhe produkteve dhe të ardhurave që sigurohen prej tyre. P.sh në të gjithë pellgun ujëmbledhës të Vjosës do të ishte efektiv menaxhimi bazuar në këtë koncept, mbrojtjen dhe kontrollin e territorit nga degradimi, duke rritur efektivitetin e investimeve 25-30 % dhe uljen e rreziqeve nga përmytjet.

Problemet e humbjes dhe degradimit të tokës në Shqipëri, nga zhvillimet e pakontrolluara ekonomike dhe sociale, diktojnë nevojën e një planifikimi të integruar kombëtar e rajonal për vendosjen e një drejtimi të dëshiruar për të ardhmen e strukturave hapësinore, përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve tokësore, identifikimin dhe rehabilitimin e dëmtimeve, përgjegjësitë e strukturave menaxhuese. Bazuar në ndryshimet e përdorimit të tokës, nevojitet gjithashtu të kryhet inventarizimi i burimeve tokësore, pasi burimet natyrore sot shifrohen në nivelet që kanë qënë në vitin 1990 edhe pse kanë ndodhur ndryshime drastike.

1.3. FAKTORËT DHE PËRMASAT E DEGRADIMIT TË TOKËS

Shqipëria është një vend kodrinor malor në $\frac{3}{4}$ e territorit. Degradimi i tokës, shfaqet si një fenomen i humbjes të kapacitetit prodhues në 30 % të sipërfaqes. Sipas studimeve të kryera në vendin tonë, një pjesë e rëndësishme e territorit

gjendet nën “stresin mjedisor” si pasojë e ndërhyrjeve më veprimtaritë ekonomike, të shkaktuara nga prerja e pyjeve, përmbytjet, erozioni, mbi kullotja, kripëzimi, acidifikimi, temperaturat ekstreme, humbja e pjellorisë tokës etj në formë të degradimit fizik, kimik dhe biologjik, si dhe në disa forma specifike të tij.

- Niveli i erozionit është 2-3 herë më i lartë sa në vendet e Mesdheut si (i) erozion ujor, lumor e detar, (ii) Gërryerjet dhe rrëshqitjet, gjatë së cilës ndodh një lëvizje masive e tokës. Nëpërmjet erozionit në vendin tonë lëvizin rreth 70 milionë ton sedimente, që përmbajnë rreth 200 mijë ton elementë ushqyes, kripëra e metale të rënda. Vetëm 30 % e sedimenteve qëndrojnë në tokë, ndërsa 70 % transportohet nëpërmjet lumenjve, duke shkaktuar ndotjen e ujërave dhe eutrofikimin. Aktualisht, rreth 60 % e tokave të Shqipërisë konsiderohen më rrezikshme të lartë ndaj erozionit si pasojë e shkaqeve natyrore dhe njerëzore. Në zonën bregdetare, erozioni është në rritje, pasi është kufizuar shkarkimi i inerteve në grykëderdhje si pasojë e shfrytëzimit pa kritere të lumenjve.
- Rrëshqitjet e tokës, dëmtojnë zonat e banuara dhe rrezikojnë jetën e njerëzve nëpërmjet rrëshqitjes së banesave sikurse ka ndodhur në Librazhd, Kavajë, Skrapar dhe zona të tjera, dëmtohet infrastruktura urbane dhe rurale, gjë që është më pasojë ekonomike, mjedisore dhe sociale për popullsinë. Në territorin e vendit tonë rrëshqitjet vijnë nga faktorët natyrorë dhe ndërhyrja njerëzore nga (i) ndërtime pa studime gjeologjike dhe rrugë të papërshtatshme; (ii) punimet në objekte industriale; (iii) shpyllëzime; (iv) mungesa e

menaxhimi i ujërave të larta dhe të rezervuarëve, (v) gjatë ndërtimi rrugëve, (vi) praktikat bujqësore që nxitin erozionin. Vlerësohet së në vendin tonë, në më shumë së 4 mijë ha kanë ndodhur shkarje të tokës dhe rreth 150 mijë ha klasifikohen më predispozicion të lartë për shkarje dhe shembje. Për të kufizuar këtë fenomen, nevojiten studime gjeologjike, pyllëzimi, mbrojtja e rrugëve, kufizimi i ndërhyrjeve në shtretërit e lumenjve, orientimi i sistemit të kullimit dhe lëvizjes së ujërave, përcaktimi i përgjegjësive institucioneve të parashikimit të rreziqeve të rrëshqitjeve, organizimi i sistemit të vlerësimit të ndjeshmërisë dhe rreziqeve të rrëshqitjes së tokës, duke zbatuar modelet e analizës dhe teknika të vëzhgimit në terren, llogaritjen dhe përgatitjen e hartave të zonimit dhe klasifikimit sipas shkallës së rrezikshmërisë si dhe ngritjen e qendrës së parashikimit dhe vlerësimit të rreziqeve.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi kushti numër një është sigurimi i mbulesës bimore. Është vërtetuar një nivel mesatar i humbjes së tokës nga erozioni në Shqipëri në masën rreth 30 Ton /ha në vit (viti 2011). Por kufijtë maksimalë të humbjes arrijnë deri në 180 ton/ha vit, në tokat e pjerrëta, pa mbulesë bimore dhe më reshje intensive. Nëpërmjet përdorimit të të dhënave të tokës e klimës dhe matjen e humbjes së tokës në një rrjet eksperimental (dhe ndarjen e territorit të vendit në tre zona), më aplikimin e Ekuacionit Universal të humbjes të Tokës (USLE), rezulton së humbja nga erozioni është përkatësisht: zona e parë 57, 2 ton/ha/ vit , zona e dytë 36.9 ton/ha/vit dhe zona e tretë 14.8 ton/ha/vit. Në tokat

bujqësorekodrinore në sipërfaqet pa mbulesë bimore dhe që punohen në drejtim të pjerrësire humbja e tokës nga erozioni arrin në 40-70 Ton/ha.

Mungesa e funksionimit të sistemit të kullimit, mbetet një nga shkaqet e produktivitetit të ulët në bujqësi dhe degradimit të tokës bujqësore. Kanalet kullues në gjithë vendin funksionojnë në 20-25 % të sipërfaqes të tokave bujqësore. Bordet e kullimit, të ngarkuara më pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit dhe mbrojtjen nga përmblytjet nevojitet të ristrukturohen në përputhje më reformën e re administrative dhe të mbështeten më mjete për mirëmbajtjen e sistemit të kullimit. Në kushtet e mungesës së kullimit dhe të përmblytjeve të gjata kapaciteti biologjik i tokave bujqësore shkatërrohet dhe kapaciteti prodhues pëson ulje deri në 35-50 %.

1.3.2. MASAT E MBROJTJES SË TOKËS NGA EROZIONI SIPËRFAQËSOR DHE RRËSHQITJET:


Në zonën urbane, erozioni vepron në formën e rrëshqitjes të rrugëve, në transportin e sedimenteve, në ndotjen e ujërave nëntokësore si dhe eutrofikimin e ujërave sipërfaqësore. Në zbatimin e masave, (i) përveç punimeve inxhinierike për mbrojtjen e tokës nga erozioni, pyllëzimeve, punime mbrojtëse më mjete rrethore, ndërtimi i pritave malore dhe ujërave të larta për mbrojtjen e qëndrave të banuara, (ii) sigurimi i mbulesës bimore të tokave bujqësorekodrinore nëpërmjet kultivimit të bimeve, pasi në kushtet e vendit tonë është provuar në rrugë eksperimentale së humbja e tokës nga erozioni në mungesë të mbulesës bimore është 3-4 herë më e lartë, në krahasim më tokat më mbulesë bimore.





PËRFUNDIME

- Në mungesë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe planifikimit hapësinor, presionit urban dhe ndërhyrjeve njerëzore, burimet tokësore bujqësore, pyjore, e urbane mbeten të rrezikuara në drejtim të humbjes sasiore, dhe degradimit. Për më tepër në kushtet e rritjes së popullsisë, pakësimit të tokës si dhe shtimit të hapësirave të paregjenerues, në të gjitha format e degradimit si “stres mjedisor” në 20-30 % të territorit të vendit, situata bëhet edhe më problematike.
- Zbatimi i politikave të përmirësimit të kushteve sociale dhe ekonomike në zonën rurale, nxitjes të tregut të tokës për rritjen e madhësisë të fermës dhe konsolidimin e tokës si dhe zbatimit të politikave favorizuese si përjashtimi i fermerëve nga taksat për fermerët që përfshihen në procesin e konsolidimit të tokës dhe zmadhimit të fermës bujqësore.
- Planifikimi hapësinor mbetet një instrument kryesor i kontrollit mbi territorin, për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe përdorimin më efikasitet i tyre dhe mbrojtja e interesave të për gjeneratat e ardhshme.
- Sugjerohen menaxhimi i mbrojtjes dhe përdorimit të territorit mbi bazën e pellgut ujëmbledhës: masat mbrojtëse inxhinierike në mbrojtjen e lumenjve, zonave të pjerrëta, zbatimi i praktikave të mira të kultivimit, mbrojtja nga përmbytjet, ruajtja e pjellorisë, planifikimi i përdorimit të tokës etj.
- Planifikimi i përdorimit të tokës në përputhje më parimet e përshtatshmërisë tokës, nëpërmjet klasifikimeve të tokave sipas klasave.



.....
Fig.2 Mbrojtje nga erozion, Sllovë- Dibër, 2011

Fig.3 Erozion i tokës Sllovë- Dibër, 2011

- Mbrojtja e tokave bujqësore produktive nëpërmjet planifikimit rajonal dhe kontrollit të territorit nga presioni i popullsisë në saj të urbanizimit kaotik.
- Rishikimi tërësor i strukturave të menaxhimit të tokës dhe përfshirja në ekonominë-ferme e rolit të specialistit të bujqësisë në menaxhimin e burimeve tokësore në përputhje më reformën e re territoriale .
- Monitorimi i degradimit të tokës si dhe i planeve dhe programeve të riaftësimit të tokës
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive, planeve të menaxhimit të tokës në nivel kombëtar, lokal dhe rajonal.
- Vlerësimi i tokës urbane dhe përdorimi i saj për prodhime bujqësore, veçanërisht në bujqësinë kopshte, në hapësirat private dhe publike për përdorime bujqësore.
- Hartimi dhe zbatimi i planit kombëtar të konsolidimit të tokës dhe nxitja e gjithë mekanizmave të tregut tokës, formave të kooperimit, nderimet e parcelave midis fermerëve etj, duke aplikuar konsolidimin vullnetar dhe të detyruar
- Krijimi i sistemit të Informacionit gjeografik, kadastrës shumeqëlimesh dhe inventarizimi i burimeve natyrore, për të identifikuar sipërfaqen reale të tokës bujqësore si një instrument që lehtëson kontrollin mbi territorin, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe planifikimin hapësinor.
- Diversifikimi i ekonomisë rurale nëpërmjet aktiviteteve jo bujqësore që sugjerojnë të ardhura dhe punësim.
- Rehabilitimi i sistemeve kulluese

Literatura:

1. Studime të kryera nga autori
2. Bigam M, 1992, Defining soil quality for a sustainable environment
3. Soil Science Society of America, 1983 Universal Soil loss Equation Past, present and future
4. John Randolph- Planifikimi dhe menaxhimi mjedisor i perdorimit të tokës
4. Manava V, et, 1994, Climate and Land Degradation
5. Wagenet J, 1994, The role of Soil Science in Interdisciplinary resuar
6. Marvin Beatty, Gary Petersen, Leslie Swindale (1979) Planning the Uses and Management of Land

③ ZHVILLIMI URBAN NË SHQIPËRI DHE EFEKTET MBI TOKËN BUJQËSORE

Dr. Dritan Shutina, Msc. Kejt Dhrami*

1. KONTEKSTI

Ndryshimet e rendit politik e social të viteve '90 në Shqipëri sollën një sërë fenomenesh, që sfiduan kulturën institucionale të vendit, si dhe mënyrën së si menaxhohej territori, më tërësinë e burimeve të tij. Këto fenomene kanë formëzuar karakterin e sotëm territorial dhe socio-ekonomik të vendit dhe janë adresuar më instrumente e korniza ligjore të larmishme. Nga fenomenet, ndoshta sfida më domethënëse në aspektin hapësinor, ka qenë shtrirja e madhe urbane, si pasojë e lëvizjes emigratore të popullsisë. Kjo lëvizje u shfaq në dy drejtime: lëvizja nga zona rurale në qendrat më të afërta urbane, si dhe lëvizje nga zona rurale e urbane periferike, drejt qendrave urbane më të zhvilluara në ultësirën perëndimore. Destinacioni i preferuar ishte Tirana, si qendër urbane më me shumë shërbime dhe mundësi punësimi dhe më hapësirë “të lirë” për ndërtim dhe “zgjdhje të problemit të strehimit” në zonat suburbane përreth saj. Kështu, në periudhën 1990-2001, Kamza e Paskuqani përjetuan rritjen më dinamike në numër popullsie, ndërsa në dekadën e fundit, komnat e Farkës, Dajtit dhe Kasharit trefishuar në popullsi.

Këto fenomene të rritjes urbane, të shfaqura si në densifikim, ashtu edhe në shtrirje hapësinore ndikuan thellësisht në balancën mes urbanes dhe rurales. Sipas raporteve të Kombeve të Bashkuara (2010), në vitin 2015 parashikohet që popullsia urbane të tejkalojë popullsinë rurale në raportin 5:4, dhe ky raport pritet të thellohet në 7:2 në vitin 2050. Kjo parashtrohet një sfidë për njësitë vendore, përsa i përket menaxhimit të tokës, burimeve dhe planifikimit të territorit.

Nëse do konsideronim përmasat e fenomenit në qytetin e Tiranës, do dalloheshin 3 faza të rritjes së saj: qyteti i konsoliduar (1,056 ha), i formuar para 1990-ës, qyteti i shpërhapur, më rritje në shtrirje 200% (+2,120 ha) në periudhën 1990-1999, dhe qyteti në densifikim e sipër dhe më proces shpërhapje më të ulët, por gjithësi domethënëse (+1,253 ha) në dekadën e fundit.

Në këtë kuadër, mbeten për të theksuar efektet e kësaj rritjeje shpërhapëse në territor, të cilat dallohen më së shumti në Tiranë dhe në rrethinat e saj. Së pari, dukuria e shpërhapjes urbane është shoqëruar veçanërisht më informalitet dhe ndërtim të paautorizuar/të paligjshëm në troje më pronësi publike e private. Kjo ka ndikuar në thellimin e problemit të rritjes në disa drejtime: 1) rritje e kostove për sigurimin e shërbimeve bazë; 2) ndarje sociale dhe mono funksionalitet; 3) mungesë e mundësive të punësimit; 4) pamundësi për të regjistruar në mënyrë të saktë dukuritë dhe titujt e pronësisë dhe krijim i konflikteve pronësore; etj. Në këtë larmi problemesh, më interes të veçantë mbetet zënia e tokës bujqësore dhe keqmenaxhimi i burimeve natyrore e bujqësore, pasi i gjithë procesi i shtrirjes së shpërhapur të urbanizimit ka ndodhur në territore bujqësore dhe në disa raste edhe më vlera natyrore. Në vazhdim do të shpjegohen dimensionet fizike, ligjore dhe institucionale të këtij fenomeni.

2. SEKTORI DHE TOKA BUJQËSORE

Sektori bujqësor është një ndër shtyllat kryesore të ekonomisë së Shqipërisë, më rreth 43% të popullsisë¹ të punësuar në bujqësi, peshkim apo gjueti, dhe më një kontribut prej 16,8% në PPB e vendit². Prodhimtaria bujqësore bazohet në rreth 696,000 ha³ tokë bujqësore⁴ potenciale, nga të cilat rreth 1/3 përdoret në mënyrë efçente⁵, ndërsa pjesa tjetër është tokë e pakultivuar, ose e zënë nga veprimtari të tjera jobujqësore.

Rëndësia e prodhimitarisë bujqësore nuk bazohet vetëm në faktorë makroekonomikë, por edhe në ekonomitë lokale të njësive vendore rurale. Sipas klasifikimit të tipologjive të komunave dhe bashkive në Shqipëri⁶, 242 njësi vendore kanë karakter bujqësor, më specifika fushore, malore apo të përziera. Kjo përbën rreth 64% të njësive vendore aktuale në Shqipëri. Në këtë kontekst, mbrojtja dhe menaxhimi i drejtë i tokës bujqësore në vend kërkon vëmendje të veçantë. Pra, përveçse një sektor më peshë shumë të lartë aktualisht në ekonomi, bujqësia është përfaqësuese e përdorimit kryesor

1. *Instat, 2014*

2. *Instat, "Shqipëria në shifra", 2013*

3. *Instat, 2012*

4. Me "tokë bujqësore" nënkuptohet sipërfaqja e tokës që si e tillë figuron në regjistrat kadastralë të shtetit, e zënë më bimët e arave, pemshitet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë, sipas Ligjit nr. 9244, Për mbrojtjen e tokës bujqësore

5. Të dhëna jo-zyrtare nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

6. *Instat, SDC, 2014 "Tipologjia e Komunave dhe Bashkive në Shqipëri"*

të territorit (veç atij natyror) thuajse në të gjithë hapësirën e klasifikuar si rurale. Kjo e fundit përbën mbi 70% të territorit shqiptar.

Megjithatë, sipërfaqja absolute e tokës bujqësore është e vogël (kundrejt sipërfaqes së përgjithshme të territorit) dhe për më tepër e fragmentuar si rezultat i reformave të pronësisë të ndërruara në fillim të viteve '90të të shekullit të njëzetë. Gjithashtu, urbanizimi i pakontrolluar dhe mungesa e mbrojtjes së tokës nga institucionet dhe politikat përkatëse ndikuan në rritjen e mëtejshme të fragmentimit dhe në humbje të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokës bujqësore (psh. vetëm rreth Tiranës u konvertuan në urbane mbi 30km² tokë bujqësore – shiko shifrat e raportuara më sipër). Për të kuptuar më mirë fenomenet urbanizuese të pranishme në tokat bujqësore, vlen të evidentohen disa tipare të përdorimit dhe vendndodhjes së tyre, që i bëjnë ato të ndryshme nga njëra tjetra. Kështu, dallojmë 4 tipologji tokash bujqësore, sipas fenomenit urbanizues:

- Tokë bujqësore e ruajtur – nuk vërehen fenomene urbanizuese;
- Tokë bujqësore e fragmentuar nga fenomene urbanizuese në zonë rurale;
- Tokë bujqësore e konvertuar në zonë urbane
- Tokë bujqësore e konvertuar në zonë suburbane
- Toka bujqësore e ruajtur përbën fondin tokësor pjellor, i cili nuk është i ndikuar nga zhvillimet e shtrirjes urbane.

Këto toka janë të fragmentuara sipas pronësisë dhe kulturave bujqësore të ndryshme, por produktiviteti i tyre është i mirë. Sfidat në lidhje me këto toka qëndron në rritjen e efikasitetit të prodhimit të tyre, që mund të arrihet

më rritjen e sipërfaqes mesatare të parcelës apo të fermës bujqësore. Aktualisht dhe sipas INSTAT (2014) dhe Ministrisë së bujqësisë, kjo sipërfaqë është rreth 2 ha. Në kuadër të rritjes së efijencës dhe menaxhimit efikas të këtyre tokave, MBZHRAU⁷ ka përgatitur hartën e rajonalizimit të kulturave bujqësore dhe është në proces hartimi të strategjisë për Konsolidimin e tokave bujqësore sipas kulturave dhe jo domosdoshmërisht pronësisë.

Toka bujqësore e fragmentuar nga fenomenet urbanizuese në zona ruraleshërben si bazë e prodhimit dhe aktivitetit ekonomik familjar apo dhe të zones.Përgjithësisht ka përdorim intensiv, për aq sa mund të lejojë struktura e pronësisë dhe niveli i fragmentimit. Ky i fundit ndodh nga ndërtime kryesisht për qëllime banimi.Megjithatë, në disa raste vërehen edhe ndërtime për qëllime ekonomike (industri përpunuese ushqimore, magazinim, etj.).Ky fragmentim tenton të ndodhë përgjatë akseve kryesore infrastrukturore dhe kryesisht në zonat bujqësore në afërsi të Tiranës (psh. Fushë-Kruja, etj.).Si rezultat, vihet re shtrirje e re urbane gjatësore dhe rritje urbane e fshatrave të vjetra.

Tokat bujqësore të konvertuara në zona urbane shtrihen përgjithësisht brenda kufijve “të vjetër” të zhvillimit të qytetit (ish-vijat e verdha ose kufijtë administrativë të zonave urbane – psh. Tirana, Shkodra, Fieri, etj.). Këto kanë qenë hapësira xhеп të pandërtuara, ku toka është bërë objekt i ndryshimit të destinacionit, për t’iu përgjigjur nevojës për strehim dhe densifikim urban.Fenomeni urbanizues ka ndodhur më etapa: në periudhën 1990-2000 një pjesë e mirë e këtyre tokave

7. *Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*

është ndërtuar më tepër informalisht (banesa individuale të tipit vilë) dhe pas kësaj periudhe ka nisur konvertimi formal. Por edhe ky i fundit ka ndodhur vetëm për zonat pa konflikte pronësie dhe në dy drejtime: 1) zonat e ndërtuara informalisht janë bërë subjekt i skemave negociuese për ndërtime të larta banimi (densifikim); 2) zonat nuk kanë pasur ndërtime informale dhe menjëherë janë ndërtuar nga zhvilluesit në negociatë më pronarët. Në të dyja rastet, ndërtimet kanë qenë të larta, shumëfamiljare dhe densifikuese dhe proceset e ndërtimit/konvertimit nuk janë paraprirë nga investimet infrastrukturore.

Tokat bujqësore të konvertuara në zona suburbane janë një rast mjaft tipik për Shqipërinë, që duhet adresuar më kujdes. Ato përfaqësojnë raste kur toka nuk parashikohej të ndryshonte destinacion (së paku jo për një periudhë 20-30 vjeçare dhe jo pa planifikim) për zhvillim urban. Mirëpo “de facto” këto toka jo vetëm u konvertuan, por janë ende nën vorbullën e këtij ndryshimi, si rezultat i presioneve të jashtme migruese dhe ekonomike, e informalitetit. Këto zona kanë fragmentim të tejkajshëm të tokës bujqësore, ndërkohë që densiteti urban lëviz nga i ulët në shumë i lartë dhe shfaqen dukshëm në rastin e Kamzës, Paskuqanit, Kasharit, Kënetës në Durrës, etj.

Duke iu referuar sërish rastit të shtrirjes hapësinore të Tiranës, më rreth 3,000 ha zgjerim në 20 vitet e fundit, do vërenim së 2,324 ha nga ky zgjerim ka prekur tokën bujqësore periferike ⁸ (pra zonën suburbane). Kjo do të thotë që 52% e territorit të Tiranës aktualisht zë tokë bujqësore, dikur mjaft

8. Përgatitur nga Co-Plan, (përpunim në GIS nëbashkëpunim nga GeoConsulting) dhe më mbështetjen e LGPA dhe OSI, 2010.

produktive. I njëjti fenomen dallohet edhe në qytete të tjera. Në Fier, psh., ku rritja e qytetit ka ndodhur kryesisht përmes densifikimit, dhe shtrirja në periferi ka qenë e pakët (+ 650 ha të shtuar në periudhën 1990-2010), 93% e kësaj shtrirjeje ka ndodhur në tokë bujqësore. Gjithashtu në Shkodër zhvillimi urban në shtrirje ka zënë një tokë prej 1,178 ha, ose rreth 98% të shtrirjes së qytetit në 2 dekadat e fundit, dhe respektivisht 71% të sipërfaqes së qytetit.

Mënyra si u shpërnda toka bujqësore pas proceseve demokratike të fillimit të viteve '90të të shekullit të njëzetë, shoqëruara nga problemet e regjistrimit dhe mbivendosjes së titujve të pronësisë ka ndikuar thellësisht edhe në fragmentimin e saj dhe në proceset konvertuese të shpjeguara më sipër. Që prej vitit 1995, toka bujqësore e ndarë sipas "reformës agrare"⁹ kaloi në pronësi të familjeve bujqësore, ose individëve, që e kishin atë në përdorim¹⁰, pa shpërblim. Ndërkaq, një pjesë toke bujqësore iu kthye ish-pronarëve dhe trashëgimtarëve të tyre, sipas Ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve¹¹. Ndërkaq, në ndryshimet e mëvonshme¹² (2004), kthimi dhe kompensimi i pronave bujqësore u bë deri në masën 60 ha, pra jo në të gjithë sipërfaqen e tyre. Kjo dëshmon për tendencat e vazhdueshme të copëzimit të pronës, dhe problemet më

9. Ligji nr.108, datë 29.8.1945 "Për reformën agrare".

10. Ligji Nr.8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore"

11. Ligji Nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve"

12. Ligji Nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës"

konsolidimin e prodhimit bujqësor.

Kjo situatë dëshmon për shfaqjen gjithnjë e më tepër të tipologjisë së urbanizimit përmes tokës bujqësore të konvertuar në suburbane, qësjele disa efekte negative. Së pari, ndryshimi i destinacionit të tokës ka shkaktuar humbje të tokës bujqësore dhe ka ulur prodhimin bujqësor. Së dyti, mospërdorimi i tokës për kultivim ka çuar në efekte të kripëzimit të saj dhe ndërtime të shkaktuara edhe ndotje të tjera, duke e transformuar këtë tokë nga cilësore për bujqësi në tokë që nuk mund të përdoret më për kultivim edhe sikur të kemi iniciativa të shpërnguljes së vendbanimeve të krijuara. Po ashtu, ka degraduar sistemin infrastrukturës ujëtare dhe të kullimit (mungesë e mirëmbajtjes dhe bllokime të sistemit). Kjo shkakton, nga një anë mundësi për përmbytje në zonat përkatëse, dhe nga ana tjetër dëmtim të një infrastrukture që ndoshta mund të përdoret si bazë për investime strategjike në infrastrukturën që i duhen zonës urbane të krijuar rishtazi. Gjithashtu, fragmentimi dhe ndarja e vazhdueshme e tokës bujqësore nga këto fenomene urbanizuese, ndikon edhe më shumë në pamundësinë e konsolidimit të kulturave dhe ineficiencë në kultivimin bujqësor. Së fundi, këto dukuri bien ndesh me parimet legjitime të mbrojtjes së tokës, mbrojtjes së mjedisit, si dhe prioriteteve strategjike të vendit¹³.

3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Transformimet e tokës bujqësore, fragmentimi i saj dhe konvertimet në urbane nuk kanë ndodhur në vakum ligjor dhe

13. Ligji 9244 Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore; “Strategjia e Zhvillimit të Bujqësisë”, Ministria e Bujqësisë

institucional. Në fakt, ekziston një tërësi ligjesh dhe institucionesh të dedikuara për çështje të administrimit dhe mbrojtjes së tokës bujqësore. Po ashtu, legjislacioni (i ndryshuar në vite) për tokën urbane dhe proceset e urbanizimit dhe planifikimit përbën një tjetër kornizë instrumentale që synon mes të tjerash të ruajë tokën bujqësore. E megjithatë, edhe pse sikurse do ta shohim në vijim, kornizat ligjore e institucionale nuk kanë qenë aspak “të holla”, në 25 vitet e fundit toka bujqësore në Shqipëri ka pësuar humbje, dëmtim dhe/ose degradim. Aspektet ligjore në lidhje me tokën bujqësore mund të trajtohen në 3 këndvështrime:

- Si ka funksionuar mbrojtja dhe administrimi i tokës bujqësore
- Cilat janë strukturat përkatëse?
- Si ndërlidhet legjislacioni i urbanistikës dhe më pas ai i planifikimit e zhvillimit të territorit më atë bujqësor?

3.1 MBROJTJA E TOKËS BUJQËSORE

Çështja e mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës bujqësore në këndvështrimin ligjor e institucional mund të trajtohet në dy aspekte: 1) deri në ç’masë është lejuar ndërtimi në këto toka; dhe 2) çfarë kundërpërgjigje ligjore ka patur kundër shkeljeve. Në vitin 1991¹⁴ përcaktohet së ndërtimet lejohen të kryhen vetëm brendavijës kufizuese urbane (“vija e verdhë”), dhe në toka bujqësore mund të ndërtohet vetëm nëpërmjet miratimit të organeve përkatëse. Ndërkaq, pronari i tokës bujqësore ka si detyrim ligjor ta mirëmbajë atë, të rrisë aftësinë e saj prodhuese dhe të kryejë sistemime e vepra arti për ta mbrojtur¹⁵.

14. Neni 13, Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”

15. Neni 11, Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”

Më pas, si kundërpërgjigje ndaj fenomeneve të rritjes urbane të shpejtë, legjislacioni urban (1998)¹⁶ dhe ai për mbrojtjen e tokës bujqësore (2004)¹⁷ përcaktuan së zgjerimi i vijës kufizuese të ndërtimit në zonë bujqësore mund të kryhej më anë të një studimi rajonal, ose të masterplaneve, në bazë të kritereve fikse (mungesa e tokës së lirë apo të ripërdorshme, mungesa e tokës së pafrytshme apo më bonitet të ulët, etj).Këshilli i qarkut mund gjithashtu të shpallte“zona të tokave në mbrojtje”ato zona ku kishte rrezik apo shfaqje të dëmtimit të tokës, rrjedhimisht duke ndaluar çdo lloj ndërhyrje në to¹⁸.

Me ndryshimet e mëvonshme të legjislacionit të planifikimit dhe të akteve për konvertimin e tokave nga bujqësore në përdorime të tjera dhe anasjelltas, në periudhën 2009-2013 ndërtimi në tokë bujqësore mund të kryhej nëpërmjet planeve të territorit¹⁹, duke ndërruar destinacionin nga përdorim bujqësor, në urban, ose përdorime të tjera të përputhshme. Ky konvertim, për kategoritë I-IV të bonitetit bëhej më Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), për shërbime infrastrukturore e publike të nivelit kombëtar të përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e tokës bujqësore. Ndërkaq, për kategori V-X të bonitetit, në varësi të sipërfaqes, konvertimi në tokë urbane mund të bëhej më VKM (sip. nën 30 ha) apo ligj të veçantë (sip. mbi 30 ha)²⁰. Së fundi,

16. Neni 6, Ligj nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”

17. Neni 14, Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”

18. Neni 24, Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”

19. Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”

20. Neni 11/1, Ligji nr. 10 257, datë 25.3.2010 Për disa ndry-

në vitin 2014, ndërtueshmëria në tokë bujqësore është kufizuar në “ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral”²¹. Në çdo rast, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim, për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet më VKM. Qartësisht, qasja ligjore ndaj ruajtjes së tokës bujqësore ka qenë gjithmonë mjaft rigjide e kufizuese dhe ka ndryshuar vazhdimisht për t’iu përgjigjur presionit të madh të zhvillimit. Mirëpo nuk ka rezultuar të jetë e suksesshme dhe aktualisht mbrojtja e tokës është kthyer në prioritet kombëtar.

Përsa i takon kundërvajtjeve, masat kundër dëmtimit të tokës bujqësore kanë ndryshuar në mënyrë të dukshme. Përveç detyrimit për mirëmbajtjen dhe sigurimin e strukturave për mbrojtjen e tokave nën pronësi (moskryerja e të cilave dënohet më gjobë 10,000 – 50,000 lekë, për kundërvajtje administrative)²² janë parashikuar disa sanksione kundër ndërtimit të paligjshëm në tokë bujqësore, si dhe zënies së tokës në mënyrë ilegale apo informale. Fillimisht, në 1991, ndërtimi pa leje në tokë bujqësore penalizohej më kthim në gjendjen

shime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”

21. *Ligji Nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar”*

22. *Neni 14, Ligji Nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”*

fillestare, dhe prishje të objekteve (ligji nr. 7501)²³. Në vazhdim (1993), këshilli komunal apo bashkiak kishte kompetencën për të vendosur për llojin e dënimit për këto raste, duke variuar nga lirim i tokës, në prishje dhe kthim në gjendjen fillestare, në gjobë më vlerë 5lekë/m², ose dëmshpërblim drejt personit që i është zënë toka.²⁴ Në 2010, disa ndryshime në ligjin nr.8752, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, parashtruan së dëmtimet dhe çdo ndryshim i paautorizuar i përdorimit të tokës, nëse nuk ishte vepër penale, do dënohej më gjobë 5,000 – 50,000 lekë, të përcaktuar nga DAMT²⁵, dhe mospërditësimi i kadastrës më këto ndryshime, më 1,000 – 10,000 lekë.²⁶ Pra, në aspektin e dënimeve për kundërvajtje, legjislacioni mbi tokën bujqësore merr masa më të zbutura. Ndërkaq, legjislacioni aktual i planifikimit dhe zhvillimit të territorit parashikon që çdo punim pa leje, qoftë në tokë urbane apo bujqësore, të dënohet më gjobë të barabartë më vlerën e punimeve (jo më pak së 500,000 lekë) dhe më prishje apo konfiskim të punimit të kryer.²⁷

23. Neni 21, Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar

24. Neni 8, Ligji Nr. 7715, datë 2.6.1993 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 «Për tokën»

25. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokave

26. Neni 16, Ligji Nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001” “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”

27. Neni 52, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

3.2 STRUKTURAT E ADMINISTRIMIT TË TOKËS

Administrimi i tokës bujqësore²⁸ në Shqipëri është përgjegjësi e 3 niveleve: niveli kombëtar, ai rajonal (qarku—niveli i dytë i qeverisjes vendore) dhe niveli vendor. Në nivel kombëtar, MBZHRAU²⁹ është përgjegjëse për drejtimin politik e teknik të strukturave të administrimit të tokës, përcaktimin e normave teknike të mbrojtjes së tokës, kontrollin e zbatueshmërisë ligjore, hartimin e planeve dhe strategjive kombëtare të bujqësisë dhe zhvillimit të zonave rurale³⁰ Krahas saj, Komiteti i Mbrojtjes së Tokës (KMT) funksionon si bashkërendues mes MBZHRAU dhe ministrive të tjera të lidhura, dhe mund të marrë vendime të detyrueshme për zbatim nga organet e tjera të varësisë³¹. Ndërkaq, Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës kontrollon zbatueshmërinë e masave ligjore në terren, dhe është i dekoncentruar në struktura në nivel qarku. Së fundi, Komiteti Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave, i cili mund të bëjë propozime për planin kombëtar të bujqësisë, si dhe të propozojë akte ligjore në zbatim të tij.

28. Sipas Ligjit Nr.8752, datë 26.3.2001, PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS

29. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, dikur Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

30. Neni 5, Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004, PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE / Neni 4, Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007, PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

31. Neni 6, Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004, PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE

Në nivel rajonal, përveç këshillit dhe kryetarit të qarkut, është krijuar një seksion specifik për çështje të mbrojtjes së tokës bujqësore, si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës. Kjo Drejtori merr masa për administrimin e tokës në nivelin e qarkut, përditëson informacionin gjeografik dhe kadastrën, bën vlerësimin e tokës, etj. Në këtë nivel funksionon edhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qark, që mbart kompetencat kontrolluese të Inspektoratit Shtetëror të Mbrojtjes.

Në nivel vendor, njësitë përgjegjëse për administrimin e tokës bujqësore janë kryetari dhe këshilli i bashkisë/komunës, si dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, të cilat marrin masa mbrojtëse fizike për ruajtjen e pjellorisë së tokës, përgatitin procedurat për shitjen, dhënien më koncesion, etj, dhe përgatitin bazën e të dhënave për njësinë përkatëse. Nga ana tjetër, bashkitë e komunat, në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kanë përgjegjësi të ruajnë dhe mirëadministrojnë çdo territor brenda kufijve administrativë përkatës, qoftë ky urban apo rural.

Si përfundim, është e qartë që përgjegjësitë kryesore në aspektin e administrimit i takojnë nivelit të qarkut, më kontroll nga niveli qendror. Deri tani, kjo strukturë nuk ka rezultuar efiçente në çështje të regjistrimit dhe përditësimit të informacionit mbi pronësinë dhe kulturat e kultivuara në tokën bujqësore. Masat e marra janë kryesisht të karakterit teknik, fizik, dhe jomenaxherial. Gjithashtu, në nivel qendror, përgjegjësitë e reja të MBZHRAU, në aspekte të planifikimit rural dhe administrimit të ujërave (që prej 2012) kanë

ngarkuar strukturën administrative të Ministrisë. Për më tepër, aspekti politikbërës është ende i dobët, pasi Strategjia Kombëtare për Bujqësinë është ende në proces hartimi.

Vlen të përmendet së si struktura administrimi të tokës, legjislacioni për bujqësinë dhe zhvillimin rural³² parashikon edhe krijimin e organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësorë, të cilat mbështeten financiarisht dhe miratohen më Vendim të Këshillit të Ministrave.

3.3 LEGJISLACIONI URBAN DHE I PLANIFIKIMIT E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Mënyra si trajtohet menaxhimi i tokës bujqësore në legjislacionin urban/të planifikimit ka ndryshuar ndjeshëm, në përputhje më kalimin gradual nga kultura e urbanistikës, në atë të planifikimit të territorit. Ligji “Për urbanistikën” (1998) trajtonte vetëm aspektet urbane të zhvillimit, pa marrë në konsideratë zonat rurale, bujqësore apo natyrore. Këto mund të trajtoheshin vetëm më instrumente të veçanta, si Studimet Urbanistike Rajonale e Mjedisore, apo Studimet e Zonave Suburbane. Pavarësisht kësaj, në përputhje më legjislacionin bujqësor të kohës, jashtë territoreve të urbanizuara lejoheshin ndërtime vetëm më miratim nga KRRTRSH³³ për kategoritë I-IV të bonitetit dhe në përputhje më studimet rajonale të miratuara³⁴. Instrumentet që ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e tokës bujqësore

32. Neni 28, Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007, PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

33. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë

34. Ligj nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”

ishin vija e verdhë (kufizuese e ndërtimit), si dhe vetë lejet e ndërtimit. Në raste të kundërvajtjeve administrative, ligji gjithashtu parashikonte prishjen e menjëhershme të objekteve pa leje, si dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të tokës. Qartësisht këto instrumente nuk ishin të mjaftueshme për të shmangur shpërhapjen urbane dhe shtrirjen e zhvillimit në toka bujqësore, në periudhën 1990-2009. Në konkluzion, si parim, kishte një ndarje të qartë mes legjislacionit dhe instrumenteve për tokën urbane dhe atyre për tokën bujqësore. Pra këndvështrimi ligjor e institucional mbi territorin nuk ishte i integruar, por sektorial.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për planifikimin e territorit” (2009), të shfuqizuar dhe zëvendësuar në 2014 nga Ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, objektiv i planifikimit hapësinor u bë edhe përdorimi racional i burimeve natyrore, përfshirë tokën bujqësore³⁵. Në këto ligje, zhvillimi i tokës bujqësore e natyrore orientohet nëpërmjet planeve të përgjithshme dhe instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, dhe territori ndahet në 3-5 sisteme kryesore: sistemi urban, natyror dhe bujqësor (plus infrastrukturor dhe i ujërave); si dhe në 14 kategori të përdorimeve bazë, një prej të cilave është kategoria e përdorimit bujqësor. Vendimet mbi tokën bujqësore duhet të merren duke i konsideruar ato çështje të rëndësishme kombëtare (përgjegjësi planifikimi nga niveli qendror), më ndikim dhe nën përgjegjësinë e nivelit vendor nga pikëpamja e kufijve administrativë të territorit³⁶. Për më

35. Neni 1, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

36. Neni 6, Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin

tepër, procesi i hartimit të planeve vendore sipas Ligjit për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit përmban elementin e analizës së thelluar të burimeve dhe territorit, përfshirë edhe tokën bujqësore³⁷. Duke qenë së ky legjislacion është gjithëpërfshirës dhe integron sektorët më territorin, vlejnë për t'u konsideruar tërësia e instrumenteve që propozohen për të rregulluar marrëdhënien mes zhvillimit urban e mbrojtjes së tokës. Pra veç planeve, disa instrumente të tjera janë: servituti publik, pezullimi i zhvillimit, transferimi i të drejtës së zhvillimit, rezervimi, etj. Servituti publik³⁸ ka implikime pozitive për pronarët e tokës bujqësore dhe për autoritetet publike, pasi lehtëson nga shpronësimit infrastrukturë publike, apo ndërhyrje të tjera fragmentuese. Pezullimi i zhvillimit³⁹ mund të jetë i përshtatshëm për zona urbane të ndodhura në kufi më toka bujqësore, për të mos lejuar për një kohë të caktuar ndërtimin në të, dhe ndikimin indirekt mbi tokën bujqësore. Rezervimi publik⁴⁰ parashikohej si instrument në ligjin për planifikimin e territorit, dhe mund të përdorej nga njësitë vendore për të realizuar një interes publik të deklaruar, në një tokë në pronësi private, brenda një periudhe 18 mujore, pa kundërshtim. Së fundi,

e territorit”

37. Neni 16, Rregullore e Planifikimit të Territorit

38. Neni 34, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

39. Neni 33, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

40. Neni 66, Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”

transferimi i të drejtës së zhvillimit⁴¹ është një instrument mjaft i përshtatshëm për mbrojtjen e tokave natyrore, bujqësore dhe monumenteve kulturore e zonave historike, duke zgjidhur çështjen e të drejtës së zhvillimit nëpronë, pa prekur të drejtën e pronësisë dhe duke vendosur barazi trajtimi mes pronarëve. Përveç konservimit të zonave dhënëse, ky program mundëson edhe densifikimin e zonave marrëse, gjë që sjell një model zhvillimi urban më të konsoliduar dhe eficient. Këto instrumente janë mjaft të rëndësishme në kuadër të menaxhimit të tokës, financimit të zhvillimeve dhe balancimit të presionit të zhvillimit, përkundrajt ruajtjes së burimeve.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Kuadri i analizuar më sipër mundëson evidentimin e disa problematikave kyçe, kryesisht të aspektit ligjor dhe atij institucional. Së pari, toka bujqësore, e shpërndarë sipas titujve të rinj të pronësisë, është fragmentuar ndjeshëm. Ky fragmentim përbën problem për prodhimtarinë bujqësore dhe për shtimin e vlerës nga ekonomia bujqësore, pasi ul eficientëcnë dhe nuk stimulon bashkëpunimin mes fermerëve dhe prodhimin e një kulture në mënyrë më intensive. Nga ana tjetër, regjistrimi dhe përditësimi i këtyre titujve të pronësisë, si dhe matja specifike e sipërfaqes dhe prodhimtarisë, është mjaft e vështirë dhe nuk është mbyllur ende (ndikuar edhe nga procesi problematik në vite i regjistrimit fillestar të pronave).

41. Neni 4, Rregullore e zhvillimit të territorit

Së dyti, në vite ka munguar koherenca/përputhja mes legjislacionit urban dhe atij bujqësor e të tokës bujqësore. Vetëm në 2009 qasjet bëhen më të bashkërenduara, pasi planifikimi urban merr nën studim edhe çështjen e tokës bujqësore. Mirëpo, ky hap erdhi pas rreth 20 vitesh eksperience dhe mentaliteti të ndarjes midis urbanes dhe rurales. Pra, nuk është e lehtë që praktika e krijuar të zëvendësohet nga një e re dhe më e qëndrueshme, sepse në këto vite janë krijuar edhe interesat e industrisë së ndërtimit dhe pritshmëritë e pronarëve të tokave nga proceset e zhvillimit të saj. Është e nevojshme të hidhet një hap më tej, në sinkronizimin e ideve të mbrojtjes më çdo kusht të tokës bujqësore, në raport më presionin e zhvillimit apo zhvillimin real që ka ndodhur. Kështu, vlejnjë për t'u adresuar kushtet e zhvillimit për tipologjitë hapësinore suburbane, siç është rasti i Kamzës, Paskuqanit, etj, të cilat janë të regjistruara si zona bujqësore, por i përgjigjen më tepër zhvillimeve urbane. Këto raste nuk janë të adresuara ligjërisht dhe aq më pak më instrumente planifikimi e zhvillimi.

Së treti, instrumentet që sigurojnë një zhvillim të harmonizuar të tokës urbane e asaj bujqësore janë prezantuar shumë vonë në legjislacion (2009 dhe 2014) dhe ende nuk kanë gjetur zbatim të mirëfilltë. Planet e bëra mbi bazën e ligjit të vitit 2009, vazhduan të jenë vetëm urbane, edhe pse ligjërisht duhej të trajtonin edhe territore bujqësore e natyrore. Ndërsa ligji i vitit 2014 ende nuk është vënë në zbatim pasi pritet të miratohen aktet nënligjore dhe të mbyllet reforma administrative-territoriale e cila po konsolidon territoret urbane më ato rurale.

Së katërti, çështja e fragmentimit të tokës bujqësore nuk adresohet në asnjë moment në legjislacion. Organizimet për krijimin e kooperativave bujqësore, për punimin e konsoliduar të tokës, janë mjaft burokratike dhe jo të detyrueshme. Nga ana tjetër nuk ka një shifër të dhënë për njësitë minimale bujqësore të lejueshme, ndërkohë që sot 45% e fermave bujqësore kanë përmasa nën 1 ha⁴². Një instrument i nevojshëm në këtë rast, do ishte grumbullimi/bashkimi i parcelave për arsye zhvillimi (bujqësor), i cili është prezantuar vetëm për zona urbane, në 2009. Gjithashtu, për zonat bujqësore të konvertuara “de facto” në urbane nuk ekzistojnë rregulla të zhvillimit apo konservimit të tokës, përfshirë standardet e planifikimit.

Së pesti, nëse rolet dhe përgjegjësitë e strukturave, vërejmë pasiguri të mëdha të rezultateve. Për shembull, caktimi i gjobave të larta për njësitë ekonomike rurale shoqërohet më mospagim të tyre dhe më tej më informalitet (siç ka ndodhur në rastet e studiuara), duke rezultuar si një praktikë e pasuksesshme. Pra më tepër së sa vlera e gjobës, ajo që merr rëndësi në këtë rast është mundësia reale për ta mbledhur atë dhe krijimi i një skeme që garanton të ardhura. Nga pikëpamja institucionale, pjesa më e madhe e përgjegjësisë kontrolluese dhe administruese u takon organeve të deleguara në nivel qarku, të cilat duhet të kryejnë regjistrimin dhe kontrollin e tokës bujqësore (DAMT dhe Inspektorati i Kontrollit të Tokës). Qartësisht kjo nuk ka ndodhur, për shkak të bashkëveprimit të dobët mes qarkut dhe njësisë vendore përbërëse të tij. Mungesa e informacionit gjeografik mbi tokën bujqësore dhe fenomenet në të është

42. *Instat*, 2012

një ndër problematikat kryesore që rrjedh nga kjo mungesë koordinimi.

Niveli qëndror, nga ana tjetër, është në proces gradual të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë, Strategjisë për Konsolidimin e Tokës, e nismave të tjera ndihmëse, si psh. rajonalizimi i kulturave bujqësore. Gjithsesi, në strukturën përbërëse, MBZHRAU ka përgjegjësi më të gjera administrimi, dhe qasja ndaj menaxhimit të tokës është më tepër e lidhur më produktet bujqësore më shumë së sa më vetë tokën.

Së fundmi, taksimi i tokës bujqësore në vite nuk ka rezultuar një iniciativë e suksesshme dhe ka ardhur duke u ulur. Autoritetet vendore nuk e kanë mbledhur atë rregullisht dhe mungesa e kostos oportune për pronarët e tokave bujqësore ka çuar në mungesë të incentivave për pronarët që ta vënë në përdorim, apo për ta shesin. Si rezultat, nga një anë janë shtuar fenomenet e spekulimit mbi çmimin e tokës bujqësore (kryesisht përgjatë akseve rrugore, ose në zona suburbane), dhe nga ana tjetër janë krijuar kontigjente tokash të “braktisura” (për nga përdorimi dhe jo pronësia) dhe të lëna djerrë.

Problematikat e mësipërme, veç iniciativave të autoriteteve qendrore e vendore për administrimin e tokës bujqësore, kërkojnë në mënyrë të domosdoshme edhe një qasje planifikimi gjithëpërfshirës që integron sektorët më territorin dhe përfshin hapa më poshtë:

- Për të siguruar menaxhimin e drejtë të tokës bujqësore në të ardhmen, duhet të mbyllet regjistrimi i saktë i fondit të tokës bujqësore (përfshirë pronësinë), i cilësisë dhe veprimtarive në të;

- Nevojitet një studim i detajuar i tipologjive të ndërtimit në tokë bujqësore, për t'i trajtuar në mënyrë reale në legjislacion;
- Duhet të plotësohen boshllëqet ligjore për të trajtuar të gjitha tipologjitë e tokës bujqësore apo rurale të ndërtuar dhe nën presion zhvillimi;
- Është e nevojshme të testohen instrumente të drejtimit të zhvillimit, që mbrojnë tokën bujqësore të fragmentuar si transferimi i të drejtës së zhvillimit, servituti dhe konsolidimi (Land readjustment);
- Duhet të përdoret fuqimisht potenciali i taksimit të tokës bujqësore si instrument nxitës për konsolidimin dhe përdorimin eficient të saj, duke shmangur spekulimin dhe lënien e tokave djerrë;
- Shqipëria duhet të investojë në krijimin e “niche” në bujqësi, kryesisht përmes produkteve organike dhe lokale, si një mënyrë për të konkuruar në rajon edhe në kushtet e mungesës së bujqësisë intensive apo konsolidimit;
- Në zonat periferike të qyteteve – tokë bujqësore e zhvilluar më ndërtime të ulëta – duhet të stimulohet bujqësia urbane, përmes instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe krijimit të kushteve nga legjislacioni bujqësor e i planifikimit;

Në kushtet e zgjerimit të mëtejshëm të qyteteve dhe balancimit të strukturës urbane/rurale, duhet të promovohet paradigma “making room” (krijo hapësirë) për zhvillimin e ardhshëm të qyteteve, përmes udhëheqjes së zhvillimit më infrastrukturë sipas planeve të përgjithshme territoriale.

Shtojca

- *Baza ligjore:*
- *Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004, PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE _ 2 herë i ndryshuar*
- *Ligji Nr.8752, datë 26.3.2001, PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS _ 3 herë i ndryshuar*
- *Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991, PËR TOKËN _ 5 herë i ndryshuar (jo në fuqi)*
- *Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007, PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL*

Legjislacioni mbështetës:

- *Ligji Nr. 9235, datë 29.7.2004, PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS _ 8 herë i ndryshuar*
- *Ligji Nr.7698, datë 15.4.1993 për KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONAREVE*
- *Ligji Nr. 8053, datë 21.12.1995, Për Transferimin e Tokave Bujqësore pa Kompensim*
- *Vendimi KM PËR PËRCAKTIMIN E TIPEVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE, PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE*
- *Ligji Nr. 10 263, datë 8.4.2010, PËR PËRDORIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA*
- *Ligji Nr.8318, datë 1.4.1998, PËR DHËNIEN më QERA TË TOKËS BUJQËSORE E PYJORE, TË LIVADHEVE DHE KULLOTAVE QË JANË PASURI SHTETËRORE*
- *Ligji Nr.8312 DATE 26.3.1998, PËR TOKAT BUJQËSORE TË PANDARA*
- *Ligji Nr.8053, datë 21.12.1995, PËR KALIMIN NË PRONËSI PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE*
- *Ligji Nr.8047, datë 14.12.1995, PËR ADMINISTRIMIN E TOKAVE BUJQËSORE TË REFUZUARA*
- *Ligj nr.8405, datë 17.9.1998, PËR URBANISTIKËN_ 10 herë i ndryshuar*
- *Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT _ 4 herë i ndryshuar*
- *Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT*

④ ZHVILLIMI QËNDRUESHËM I PEMËTARISË NË FOKUSIN E MBROJTJES TOKËS DHE PEJSAZHIT

Prof. Assoc. Dr. Bardhosh Ferraj [UBTiranë]

1. HYRJA

Vendi ynë, për pozitën gjeografike, kushtet tokësore dhe klimën e alternuar, vlerësohet si mjedis i përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e specieve të ndryshme drufutore. Në arealin tonë kombëtar, kopshte familjare apo sipërfaqë të gjera kultivohen dhe prodhojnë nga frutat e hershëm, (nespulla), e gjithë gama e drufutorëve faror dhe bërthamor, (molla, dardha, ftoi, kumbulla, pjeshka, nektarin, qershia, vishnja, kajsia), drufutor gujador (arra, gështenja, bajame, lajthi), agrumet (portokalli, mandarina, limoni, komkuati), ulliri, hardhia, aktinidia dhe të tjerë subtropikal, (fiku, hurma, mani, luleshtrydhja, manaferra), etj. Sipas të dhënave të siguruara nga studiues të ndryshëm hortikulturist konstatohet së në vendin tonë mbarë shtrohen rreth 35 specie kryesore frutore, ndërsa germoplazma e dobishme është mjaft e pasur. Ajo përfaqësohet më më shumë së 3250 specie të vendit dhe endemike. Ky është një aset mjaft pozitiv që krijon mundësi përzgjedhje e përhapje të një spektri variabël bimësh frutore në të gjitha terrenet dhe rajonet bujqësore shqiptare por edhe mundësi të mira kompozimi mjedisi, veshje më bimësi të qëndrueshme dhe krijimin e një agroekosistemi funksional në shërbim të njeriut dhe natyrës.

2. VLERA PËRDORIMI TË DRURFRUTORËVE

Drurfrutotët e kanë shoqëruar vazhdimisht njeriun në natyrë dhe në mënyrë koplementare kanë përshkruar një rrugë të përbashkët dhe të gjatë historike. Kjo simbiozë provohet lehtësisht më prezencën e një peme frutore në ambiente familjare, ambiente vile, bahce familjare, ambiente festash, dhe deri në blloqë frutor më destinacion komerciale. Për pasojë, pemët frutore kanë pëftuar në një evolucion të pandërprerë destinacione të shumta përdorimi ku si drejtim bazë konsiderohet konsum i freskët/shkon mbi 85% e prodhimit frutave. Jo më pak i rëndësishëm është përdorimi i frutave apo pjesëve të tjera të drufrutorëve në industria ushqimore/bukë, miell, pasticeri, industri vaji, farmaceutikë, industri regjise të lëkurëve, në ngjyrosje, karpenteri dhe transporte të vështira/hekurudha, industri druri/mobileri, punime artistike, ngrohje dhe furra pjekje më dru, për ambiente festive, familjare apo lidhje bese për luftë, mundësojnë të ardhura alternative në rajonet bujqësore kodrinoro - malore/në fshat jeton akoma deri 50% e popullsisë, okupojnë terrene të vështira dhe mbrojnë tokën nga gjërryerjet/ulin nivelin e erozionit më 10 – 20 tonë/vit, pasurojnë tokën më lëndë organike/ gështenja mundëson mbi 15 tonë gjethe në vit, kualifikojnë dhe punësojnë grupe njerëzish në industrinë e përpunimit, krijojnë ekuilibra natyror/ambiente peisazhi, nxisin ushqimin e mikroflorës në tokë, përmirësojnë strukturën e tokës, mundësojnë ushqim të jashtëzakonshëm për bletët, sigurojnë ushqim dimëror për kafshët e egra dhe ato shtëpiake, etj, etj.

2. TË DHËNA HISTORIKE PËR PENTARINË SHQIPTARE

Në vendin tonë, kultivimi i drufrutorëve njihet herët, ku lllirët dhe Keltët kanë përdorur forma të domestikuara të tyre. Eksplorator shqiptar apo të huaj, vlerësojnë së germoplazma drurfrutore e kultivuar shqiptare është mjaft e gjerë. Ajo përfaqësohet nga specie më identitet varietal të dallueshëm, vlera përshtatshmërie, larmi kultivarësh autoktonë dhe të introduktuar, cilësi tregtare të lakmueshme dhe mundësi për seleksionime kllonale e kryqëzime. Brenda evolucionit të pemëtarisë ekziston edhe përvoja e bujkut shqiptar i cili në praktikën e vet ka punuar për mbarështrimin e pemëve frutore. Kjo degë e ekonomisë është zgjeruar gradualisht në pajtueshmëri më epokat e zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit tonë.

Në bazë të informacionit të shkruar dhe gjetjeve të ndryshme arkeologjike të kohë paskohëshme deduktojmë se, evoluimi i pemëtarisë tonë ka kaluar katër etapa ose periudha kryesore zhvillimi të cilat në retrospektivë renditen si më poshtë:

- Etapa e parë ose periudha deri në vitin 1912. (krijohet shteti i parë shqiptar).
- Etapa e dytë, periudha 1913 - 1945. (shteti shqiptar konsolidohet dhe rritet juridikisht)
- Etapa e tretë, periudha 1946 – 1990.(ekonomia kombëtare në tërësi u centralizua)
- Etape e katërt ose periudha pas viteve 1990. (ekonomia hyn në hapësirën e tregut të lirë)

Të dhënat e para historike i sjellin studiues të huaj, të


cilët pohojnë së lllirët kanë përdorur (mundësuar) forma të kultivuara të drufrutorëve rreth 3000 vjet më parë, prej të cilave frutikultura e sotme është zhvilluar përpara pushtimit romak. Bergamini A., 1991.

Në këtë kontekst, studimet vendase verifikojnë traditën shqiptare në pemëtari, rezultate që tërhiqen përmes kërkimeve arkeologjike në vendbanimet e njohura të Maliqit, Voskopojës, Apollonisë, etj. Sipas klasifikimit dhe përcaktimit të tyre provohet së mbi 2500 vjet më parë në trojet ilire janë kultivuar e përdorur ulliri, pemët dhe hardhia. Ismaili H., 2010, Xhuveli L., 2012

Ky realitet pasqyrohet nga përdorimi i mullinjve të shtypjes së ullirit (Frantoio) më moshë 2300 – 2500 vjecare, përdorimi i mokrave të blojes së drithrave, vlerësimi i një bime ulliri emblemë më moshë 3000 vjecare, masive ullishtash më moshë 1600- 1700 vjecare në Tiranë, Krujë, Vlorë, etj, një bllok i vjetër gështenjashëme moshë mbi 1500 vjecare në Kokodë Pukë, një ekzemplar gështenje shumë e vjetër në dhe madhësive në Bujan Tropojë, etj. Kafazi & Muco, 1984, Korkuti M., 2003.

Studiues të huaj të shekullit VII-të - IV-të p.K./Skrymni & Straboni, më von, Budi e Bartleti që kanë vizituar lllirinë e kohës, të mahnitur më klimën dhe bukuritë e saj shkruajnë për “vreshta e ullishta të këtij vendi frytdhënës” apo “vajin e famshëm” të Liburnisë i cili tregëtohej në brigjet e Danubit.

Në fillimet e shekullit III – IV (e.s.) burime kishtarë tregojnë për zhvillime të pëmëtarisë dhe vreshtarisë vendase. Në mënyrë sinjifikante përmendim faktin që, qeveritë qendrore dhe lokale të kohës i tatonin fermerët prodhues më detyrime “mushti” (lëng rrushi), vaj ulliri, produktet hoshafi, mjaltë, etj.




.....
Foto .1Ulli 3000 vjeçare 2. qyp 2400 vjeçar 3. ullishta mbi 500 vjecar
në toka të pjerrta

Arshivat turke të shekullit XIV – IXX –të sjellin të dhëna shumta ku, për gjatë periudhës otomane, popullsia fshatare sipas ligjit perandorak ishte e detyruar ti paguante Portës së Lartë të dhjetat nga prodhimet e veta bujqësore, drufutorët dhe hardhise gjë që provon për një traditë të njohur dhe përvetsuar mirë nga bujku shqiptar. Provë e qartë e këtij realiteti janë ullishtat mbi 500 - 600 vjeçare, të kohës së Skënderbeut apo bimë mani mbi 300 vjeçar, të cilat tregojnë vitalitetin hortikulturor, përfaqësuar më një larmi specimesh frutore autoktonë dhe përmirësuar e shtuar kohë pas kohë prej ekspeditave të shumta të studjuesve të huaj apo të përbashkëta më ata vendas. Thomaj F., 2011, Voci F., 2012.

Vitet 1912 – 1945 mund të konsiderohen si fillime të organizuara të pemëtarisë shqiptare. Në thelb evidentohen politika, reforma dhe programe të cilat marrin përmasa krejtësisht të reja më gjithëse realiteti tregon një bujqësi që mbështetet tërësisht në punën e krahut dhe kafshët e punës, ndërsa fermerët punojnë për plotësimin e nevojave të domozdoshme familjare.

Evidencat e vitit 1938 provojnë se, në shkallë vendi kultivohen 2.6 milion pemë (në prodhim 1.5 milionë) më rendiment 10.9 kg/bimë dhe prodhim total 16 400 tonë. Po ashtu janë të mbjella në bahce familjare rreth 1.2 milionë rrënjë ullinj dhe rreth 2 mijë tonë vaj. MBU, 1946

Në vitet 1946 – 1990 pentaria ,vreshtaria, ulliri dhe agrumet morën realisht zhvillime të vullshme. Kemi rritje sasiore të sipërfaqeve të mbjella dhe përmirësim të strukturës së kultivarëve frutor. Në programet zyrtare ka një ndryshim total në politikës shtetërore ndaj bujqësisë dhe fshatit. Si rezultat i investimeve të realizuara, shfrytëzimit të faktorëve




Grafiku 1. Të dhëna për pentarinë - viti 1938

të përshtatshëm pedoklimatik dhe potencialeve gjenetike të specieve drufrutorë në fillimet e vitit 1970 arrihet trefishimi i prodhimi në frutikulturë. MBU, 1970

Edhe në aspektin e cilësisë së produktit, tregëtimit dhe ushqimit më fruta dhe perime vërehet një ndryshim i rëndësishëm. Në mënyrë koherente shtohet sasia produktit të konsumueshëm, ka përmiresim të asortimentit dhe një progres të natyrshëm në kulturën dhe tavolinën e ushqimit shqiptar. Në qytetet e mëdha organizohen tregjet e fruta - perimeve dhe dyqanet e tregëtimit, ndërsa industria e përpunimit në trajtën e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme industriale përfshin disa zona selektive dhe më të zhvilluara të vendit. Programet shtetërore mbi bujqësinë, panvarësisht kufizimeve të pronës private marrin vlera pozitive ku zhvillime të jashtëzakonshme mundëson ILBujqësor i Tiranës i cili mundësoi përgatitjen e specialistëve të bujqësisë të gatshëm për të kontribuar në zhvillimin tërësor të vendit.

Pas kolektivizimit të plotë të bujqësisë dhe centralizimit të saj në duart e shtetit, kryesisht pas viteve 1975, përmes politikave shtetërore u nxit ideja e hapjes së tokave të reja dhe zhvendosjen e mbjelljeve në kodra mbi ujë deri në toka



Grafiku 2. Të dhëna për pentarinë – viti 1990

livadhoro & kullimore inproduktive, të papërshtatshme në aspektin tekniko - ekonomik për pentarinë dhe vet natyrën.

Përveç rasteve pozitive dhe të studjuara/bregdeti shqiptar apo kodrina të cilat u okupua më agrume, vreshta dhe ullinj, në shumë raste u veprua në mënyrë të pamëshirshme duke kthyer në tokë bujqësore pyje komunar, kullota e livadhe të mrekullueshëm, ndërhyrje që çuan në zhvishjen e natyrës nga bimësia e lartë dhe stimulimin e erozionit masiv. Përgjatë gati 40 vitesh pemëtaria u shtua në mënyrë sasiore të pandërprerë, por që nuk arriti të konkurrojë cilësisht për mungesë teknologjish, informacioni, mekanizimi dhe veçanërisht shtrirje të saj në ambiente të papërshtatshme agronomike.

Në vjetarin statistikor të vitit 1990, në vendin tonë rezultojnë të mbjellë 47 750 ha pemë frutore/rreth 11 704 000 rrënjë dhe prodhim total rreth 84 000 tonë, 22 020 ha vreshta dhe 80 000 tonë prodhim, 2 500 ha agrume dhe 12 000 tonë prodhim dhe 45 213 ha ullinj/rreth 6 milion rrënjë dhe 5 – 8 000 tonë vaj. Frutikultura gjithsej okuponte rreth 117 483 ha tokë ose 20.1 % të sipërfaqes së tokës bujqësore dhe siguronte 15 - 22 % të ardhurave të prodhimit bujqësor bruto. MBU, 1991


Pas viteve 1991 u kalua nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut të lirë. Bujku filloi të vetëushqehet dhe fermat bujqësore gradualisht hynë në sistemin prodhimit komercial kryesisht në zonat prioritare, afër tregjeve dhe njësisive të grumbullimit e marketingut. Si rezultat u krijua dhe vazhdon të krijohet përvojë teknike dhe eksperiencia pozitive për shtim asortimenti dhe volum produkti për konsum të freskët, të përpunuar dhe pse jo edhe për eksport.

Përvec arritjeve pozitive të padiskutueshme, realiteti hortikulturor shqiptar përjetoi edhe problematika të cilat u reflektuan kryesisht në vitet e para të tranzicionit ku pranojme se:

- Sistemi dhe politikat shtetërore për bujqësinë dhe fshatin nuk ishin në sensin e duhur.
- U prish natyra mozaik e bahces tradicionale shqiptare më pasoja në ekonomi dhe natyrë
- Pati ngushtim të hapësirave për punë, nisma private dhe mirëqënie që buron prej tyre.
- Sipërfaqet pemëtore, vreshti e ullishta u vendosën në toka të varfëra pyjoro – kullosore.
- U përshtat dhe aplikua agroteknologji që mbështetej kryesisht mbi krah pune.
- Hapja e tokave të reja çoi në prishje ekuilibri natyror, shtim erozioni dhe pasoja në ekosistem.
- Prodhimi përgjithësisht u përshtat më trentën e zhvillimeve të kohës duke u mbështetur në përdorimin masiv të plehrave kimike dhe pesticideve, zvogëlimin ose eliminimi përdorimit të plehrave organike më pasoja rritje të shkallës së ndotjeve dhe problematika në agroekosistem.

E gjitha kjo u reflektua në ekonominë e dobët bujqësore të viteve 1990 ku sipas studimeve provohet shfrytëzim joefektiv i tokës, numër i vogël bimë/ ha, koeficient zyrtar zënje shumë i ulët dhe rendimente mesatare deri 12 kg/bimë ose afërsisht sa ato të viteve 1945.

Për pemtërinë, ullishtarinë, vreshtin dhe agrumet, akoma më i dhimbshëm ishte tranzicioni i bujqësisë shqiptare i cili u shoqërua më dëmtime masive pavarësisht kostove shumë të larta të realizuara në 40 vite në këto sektor. Përmendim abandonime masive, shkatërrim të veprave të ujitjes, kullimit,



Grafiku 3. Të dhëna për pemtarinë 2012

qëndrave të vrojtimit- sinjalizimit, laboratoreve, ndërprerje të investimesh publike, manipulime në tregun e fidanave, plehrave kimike, pesticideve, agroteknologji, etj. Si pasojë e këtyre faktorëve, vonesave në zbatimin e reformës dhe mungesës investimeve private, në vitet 1998 - 2000 kemi sipërfaqet më pemë frutore u ulën më 54%, numri i bimëve më 50% dhe prodhimi arriti në 45% të vitit 1990. Të njëjtin fat pësuan edhe sipërfaqet më vreshta të cilat u dëmtuan mbi 75%, agrumet mbi 90% dhe ulliri më mbi 10 mijë ha ose

mbi 1.2 milion rrënjë. Prodhimi në total ishte vetëm 47% e vitit 1990. Vjetar MBU-1998.

Situata pas viteve 2000 ndryshon pozitivisht. Në ambientin frutikulturor vërejmë ringritje graduale, ndryshim të mentaliteti pemrritës, më shumë investime private dhe mbështetje shtetërore më asistencë dhe projekte zhvillimore. Statistikat e vitit 2012 sjellin shifrën e 10.7 milion pemë frutore, prodhimi total 167 000 tonë dhe rendiment 21.4 kg/rrënjë. Po ashtu janë shtuar sipërfaqet më ullishta, vreshta dhe agrume duke tejkaluar ndjeshëm rendimentet dhe prodhimin total të viteve 1990. INSTAT -2012.

Në pemëtarinë e re shqiptare po tentohet të aplikohen forma intensive kultivimi dhe mënyra moderne menaxhimi toke të cilat shkojnë në trentën e zhvillimeve botërore. Kjo mundëson jo vetëm rendimente të larta e të qëndrueshme por edhe shfrytëzim të mirë të tokës, kombinacione optimale të ambientit agronomik më atë mjedisor dhe më shumë mundësi e kualitet në bashkëjetesën e njeriut më natyrën, një kërkesë kjo mjaft e dëshiruar në kohët moderne.

3. SHFRYTËZIMI TOKËS NË KUSHTET E BUJQËSISË E QËNDRUESHME

Në kushtet e ekonomisë së tregut, vlerësimi maksimal shkon në drejtim të përdorimit racional dhe shfrytëzimit më kriter të tokës në të gjitha zonat bujqësore. Për vendin tonë më sipërfaqë toke bujqësore të kufizuar dhe atë për frymë disa herë më të ulët së vendet përçark nesh konsiderohet domosdoshmërisht administrimi dhe shfrytëzimi i mirë i rezervave tokësore dhe të mirave që rrjedhin prej saj. Toka bujqësore në Shqipëri

zë 24% të totalit të territorit, 36% janë pyje, 15% livadhe e kullota dhe 25% toka jo produktive. Vetëm 50 – 55% e tokës bujqësore është fushore dhe ½ fushore, 20 - 25% kodrinore e shfrytëzueshme më mekanike dhe 30 – 20 % më mundësi të pakta mekanizimi dhe shërbimesh intensive.

Përgjatë viteve 1945 – 1990 në Shqipëri u aplikuan përgjithësisht sistemet e prodhimit tradicional dhe konvencional pas viteve 1970. Modeli i prodhimit konvencional përveçsë solli rezultate të admirueshme në prodhimin total u shoqërua më problematika në ambient, tokë, ujëra duke sjell çrregullime më ndikim direkt në agroekosistem. Në themel, sisteme të prodhimit konvencional konsiderohen ato praktika prodhimi bujqësor ku veprimtaria e zgjeruar e njeriut dhe interesat kapitale kanë thjeshtuar në mënyrë të dukshme strukturën diverse të mjedisit duke induktuar një numër të kufizuar bimësh krahasimisht më diversitetin natyror karakteristik të zonës. Rezultati në fakt bazohet në shtimin në mënyrë progresive të energjisë ndihmëse nga jashtë e cila ka zëvendësuar në forma të ndryshme energjinë diellore në prodhimin bimor.

Tiparet themelore të sistemit të prodhimit konvencional janë pasqyruar në trajtën e momenteve më kuptimplote që karakterizojnë dhe dominojnë bujqësinë e sotme në vendet e zhvilluara kapitaliste ku midis tyre përmendim:

- Mekanizim i proceseve të punës.
- Plehërim mineral në doza të mëdha në vend të plehut dhe mbeturinave organike
- Zëvendësim të qarkullimit bujqësor më trajtime kimike, mbjellje monokulturë
- Kontroll të ashpër kimik të sëmundjeve & dëmtuesve në vend të kontrollit mekaniko - biologjik

- Ujitje pa kriter në vend të përdorimit të sistemeve më pak konsumatorë të ujit
- Përdorim të varieteteve të seleksionuar më potenciale të mëdha energjitime që pranojnë shtim nga jashtë të imputeve shtesë, në vend të kultivareve dhe rracave të përshtatura lokale.

Sistemi i prodhimit konvencional i bujqësisë vazhdon të jetë një sistem i pakonsoliduar pasi mbi të janë bërë modifikime të vazhdueshme substanciale që e kanë larguar shumë nga mënyra e funksionimit të sistemit natyror. Në këtë model mungon aftësia e riciklimit të elementeve ushqimore dhe përgjithësisht proceset kthehen në aciklik. Kjo situatë krijon shumë vështirësi për të kontrolluar regjimin e popullatave dhe mikroflorës së dobishme në tokë. Funksionimi i këtij sistemi varet totalisht nga ndërhyrjet e njeriut, shkalla e ndërgjegjes së tij, lidhja me interesin material, përgjegjshmëria dhe sjellja e tij ndaj natyrës, tokës, trashëgimisë, etj.

Për të mbajtur nivele normale të prodhimit sistemet intensive konvencionale kërkojnë një kontroll më të madh të mjedisit duke u integruar përmes sistemeve tradicionale dhe eko-kompatibile. Kjo sepse futja e teknologjive të reja dhe shtimi i imputeve praktikisht e rrit në mënyrë të ndjeshme prodhimin për një periudhë të shkurtër kohore, por ka zvogëluar qëndrueshmërinë dhe produktivitetin e prodhimit vjetor afatgjatë. Në fillim të viteve 1990 – 2000 bujqësia në total u detyrua të përballet më shumë problem shqetësues mjedisorë, të ekuilibrave tokësorë, ndotjeve kimike, balancave ushqimore, sigurisë ushqimore, etj. Dhe për sa kohë që njeriu dhe shkenca d të jenë në gjendje të rrisin prurjet e jashtme në sistem pa shfrytëzuar burimet potenciale

natyrore, problematikat në bujqësinë intensive konvencional dotë jenë në plan shqetësues dhe vazhdimisht në kufij rreziku. Këte situatë në një farë mënyrë e stimulon vet organizimi dhe koncepti i këtij sistemi i cili parashikon që krahas shtimit të kapaciteteve biologjike përmes seleksionimit të kultivarëve, hibrideve apo linjave të reja në mënyrë progresive të shtohen kimikatet në trajtën e plehrave kimike, pesticideve në trajtën e kimikateve, volumet e ujit për ujitje, etj. Kjo nuk kaloi pa lënë gjurmë dhe pa sjellë probleme në ndotjen e tokës, ujërave nën dhe mbitokësore, ambientit, prishjes së ekuilibrave bimë – sëmundje e dëmtues dhe impreditor, prishjes së raporteve të mikroflorës, Ph të tokës, dëmtime të florës dhe faunës, etj.

Gjithsesi mund të deklarohet së sistemet e prodhimit konvencional mundësuan zgjidhjen e shumë problemeve ushqimore dhe sollën zhvillime të fuqishme shkencore, kualifikime stafesh njerëzor dhe zhvillime të industrisë përpunuese. Ndërsa, për të shmangur efektet negative në tokë dhe ambient, shkenca bujqësore po kërkon dhe amplifikon modifikime dhe nderthurje të sistemeve të prodhimit duke kufizuar përdorimin e kimikateve dhe pesticideve të fortë, stimuluar përdorimin e lëndëve organike, kultivimin dhe përdorimin e impreditorëve biologjik, përdorimin e masave të gjelbëra bimore livadhore apo tërfilet e imët, etj, etj. Peculi V., et.al., 2005

Alternativa ndaj këtyre ndryshimeve disa të dobishme dhe disa të tjera jo ishte adaptimi i sistemeve të prodhimit të qëndrueshëm dhe atij të integruar të prodhimit bujqësor. Përpunimi dhe aplikimi i këtyre sistemeve jo vetëm mundëson stabilitet prodhimi, por rekomandon përdorim të kufizuar të imputeve më natyrë kimike, shton fitimin në fermë dhe kufizon

fenomenet negative të ndotjes ekologjike në ambient.

Vendosja e raporteve të reja agroteknologjike – mjedisore – bimë të kultivuara – kufizim të kimikateve apo orjentimi drejt bujqësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm e organik nuk sollën probleme ushqimore por një përmirësim rrënjësor të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, mjedisit, zhvillimit intelektual, jetesës në fshat, etj.

Për zbutjen e problematikave që rezultuan nga sistemi i prodhimit konvencional më mbingarkesa në plehra dhe pesticide, në prodhimin bujqësor u fut koncepti i kufirit ekonomik të dëmtimit dhe mbrojtjes së integruar të patogjeneve (IPM) dhe prodhimit (ICM).

Kufiri ekonomik i dëmtimit lidhet më vlerësimin e pragut kritik të shfaqjes së sëmundjes dhe dëmtuesit dhe pastaj marrjen e masave për ndërhyrje më preparate kimike duke vënë më shumë në përdorim dhe efikasitet masat preventive dhe të agroteknikës bujqësore. Ky koncept i pranuar gjerësisht në botën e zhvilluar presupozon luftën e integruar ose IPM (integrated pest management) dhe prodhimin e integruar ose ICM (integrated crop management). IPM është një strategji e menaxhimit të parazitëve bujqësor që parashikon një afat të gjatë për parandalimin ose zhdukjen e tyre përmes kombinimit të teknikave bujqësore (ujitje, krasitje, menaxhim barërash), kontrollit biologjik të parazitëve, përdorimit të varieteteve rezistent dhe përdorimit të kujdeshëm të preparateve kimike vetëm në një kufi kritik që më tej dotë kopromentonte rëndë prodhimin e parashikuar. FAO, 1977, Benites, J. Et.al., 2005.

Strategjia e mbrojtjes së integruar parashikon disa aspekte bazë ku përmendim

- vlerësim të rrezikut që realizohet përmes sistemeve monitorues.
- monitorim praktik, i cili realizohet përmes inspektimeve permanente ditore e javore ku vëmendje i kushtohet kryesisht shfaqjeve të simptomave dhe dëmtimeve nga sëmundje virusale, viroideve, fitoplazmave dhe të ngjajshëm më to.

Mënyrat për monitorimin janë përshtatur për sëmundje dhe dëmtues. për sëmundjet behen vetëm verifikime vizuale që percaktojnë ndryshimin e bimës së infektuar në krahasim më ato normale, ndersa për insektet monitorimet janë më të vështira dhe sistemi duhet më i perkryer. për këtë arsye janë përshtaur metoda të ndryshme si, kurthe më lende ngjitese duke shfrytëzuar disa ngjyra të spektrit të drites të cilat terheqin insektet dhe kurthe më feromone të cilat janë të paisura më disa kapsula kimike që leshojnë erëne feromoneve femerore për të terhequr meshkujt për kopulim. Insektet e terhequra ngjiten në kuth që shoqeron feromonin. Përmes kontrolleve periodike që bëhen, percaktohet dinamika e popullates, dendësia e saj dhe koha e ndërhyrjes më kimikate. Pragu i ndërhyrjes lidhet më dendësinë e popullatës ku deomos duhet të ndërhyjmë kimikisht më spërkatje në të kundërt masa e dëmit e tejkalon shumë koston e këtij shërbimi. Në këtë lloj shërbimi parashikohen disa lloje ndërhyrjesh apo masa të cilat mund të jenë të karakterit parambrojtës, preventiv dhe kurativ. Në masat parambrojtëse përmendim mbjelljen e kultivarëve rezistentë, përdorimi i barrierave mekanike dhe pastrim djegie të mbeturinave të infektuara. Ndërsa

masat kurative plotësohen më ndërhyrjet fizike, mekanike, kimike dhe biologjike/armiq natyror të tregëtueshëm dhe bioteknika e grackave.

Metodat kimike të luftimit synojnë kurimin e semundjes apo dëmtuesit më kërkesën që pesticidi të jet sa më pak i rrezikshëm për shëndetin e njerëzeve, këshillohet të behen trajtime selektive, vetëm në bimet e infektuara dhe pesticidi të lërë sa më pak mbetje në tokë

Termi dhe praktika e menaxhimit të integruar të prodhimit nuk është më pak e rëndësishme së IPM. Praktika e lancuar mbështetet në intensitetin e operacioneve agronomike që luajnë një rol të rëndësishëm në kontrollin e dëmtimit të prodhimit dhe të vet bimës nga dëmtuesit dhe semundjet. Faktorët agronomik që mund të trajtojmë në menaxhimin e prodhimit të integruar janë :

- Respektimi i teknikavë të punimit bazë dhe në vegjetacion të tokës, ku përkujdesje tregohet
- për ndërhyrje të ndryshme në kohë dhe më cilesi sipas llojit të tokës, kategorisë, vendodhjes (fushe, kodër), bimës që do të kultivojmë, etj.
- Plehërime të balancuara kimiko – organike ku, mungesa ose teprimi i një elementi kimik apo i
- lëndës organike do të ndikonte në disekuilibra ushqimi dhe dobësim të gjendjes shendetësore të bimës, më pasoja dhe mundësi parazitimi të sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- Krasitje të përvitshme dimërore dhe të gjelbëra të cilat ndikojnë në fiziologjinë e ushqimit, të
- rritjes, diellzimin e kurorës, pakësimin e infeksioneve parazitare, prodhim cilësor të përvitshëm, etj.

- Menaxhimi i kujdeshëm i barërave të dëmshme/ të egëra si konkurent ushqimor dhe strehues të parazitëve të ndryshëm. Në fakt, bimët e egëra janë të dëshirueshme për ekosistemin, por bëhen të rrezikshme në atë moment që menaxhimi i tyre del jashtëvëmendjes dhe kontrollit të fermerit dhe pikërisht kjo vlerësohet si situata më delikate e punës në bujqësi.
- Mulcimi tradicional më mbetje bimore, mulcimi më barëra livadhore apo tërfile të ulët, përdorimi i mulcivesve organik , të polietilenit, etj , janë praktika të reja moderne që përdoren gjërësisht dhe që sigurojnë bashkëjetesë në ekosistem, ruajtje të pjellorisë tokës, ulje të nivelit të gërryejeve dhe mundësira të shfrytëzimit konstant të tokës pemëtore për shumë vjet.

Përdorimi i pesticideve duhet bërë më kujdes dhe ndjekur kufirin e barërave të këqja edhe pse si ndërhyrje konsiderohet efektive por, sikurse u argumentua, është gjithmonë më rrisht dhe shfaqet problematike për bimën, dëmtuesit biologjik, prodhimin dhe ujërat. Ferraj B., et.al., 2011

4. RAJONIZIMI DHE PËRHAPJA E PEMËTARISË SHQIPTARE

Për të orientuar zhvillimin e pemëtarisë shqiptare në kohë dhe hapësirë sipas kërkesave të ekonomisë së tregut dhe kushteve të integritit në BE, UBTiranë, Institucionet shkencorë dhe Drejtorite teknike të MBU-së në bashkëpunim më IAM-Bari Itali kanë përpunuar këtë skemë orjentuese:

- Zona fushore, dotë jetë baza e zhvillimit të pemëtarisë intensive, ullirit, agrmeve, pjeshkës, qershisë, nektarinës, kiëit, hardhi, dardhe. Këtu do të vendosen njësitë kryesore të konservimit dhe grumbullim – përpunimit të produkteve hortikulturore.
- Zona kodrinore, dotë jetë baza e perhapjes ullirit, mollës, kumbullës, qershisë, pjeshkës, bajames, hardhisë për verë, pa ndërhyrje të forta dhe aksidentim të terrenit.
- Zona paramalore, do të jetë bazë e zhvillimit të pemëve frutore (kumbull, qersh, lajthi, arrë dhe hardhisë) më vendosje dhe shpërndarje të tyre sipas natyrës specifike të çdo specie por edhe rajoni bujqësor verior, qëndër – lindore, qendër-juglindore dhe jugore.
- Zona malore, do të jetë bazë e përhapjes të pemëve jo intënsive si kumbulla, molla, arrë, hardhi pjergull, gështenjësë, arrë, lajthi, etj, për konsum vetjak e tregje komunar.
- Specie të veçanta si ullishte antike për rreth kalave të vjetra dhe gështenjave mund të trajtohet si pjesë e turizmi rural. Ferraj B., et.al, 2003.

KONKLUZIONE TË STUDIMIT

- Pemëtaria shqiptare ka qenë pjesë e ushqimit dhe zhvillimit të identitetit tonë kombëtar.
- Ka ndjekur trendë e zhvillimit shoqëror, është mbjellë në bahçe të vogla për konsum, pak për gjenerim ta ardhurash dhe treg
- Në vitet 1946 – 1990, pemëtaria mori zgjerim sasior, strukturë varietore të përmirësuar, rajonizim, zgjerim tregjesh, industri, etj, por edhe problematika.
- Ekonomia e tregut mundësoi realitet të ri për pemëtari intensive, bashkëkohore.
- Alternativa drufrutore është mundësi punësimi, mbrojtje toke, eksporti, organizime grupesh prodhues, menaxhues, përpunues, mundësi e mirë për dekorime dhe ambiente peisazhesh, etj.



.....
Foto 2.1. Pemëtarja dhe vreshtaria në vitet 1975 – 1990 u shtri përgjithësisht në toka të pjerrta deri 12- 14° më sistem terraca ose vetullore pjesore.

Literatura.

1. Benites, J, M.Pisante & F.Stagnari. 2005. The role and importance of integrated soil and water management for orchard development. In; Integrated soil and water management for orchard development. Role and importance. FAO Land and water bulletin. Pp., 21-28
2. Bergamini A, REDA - Itali., Frotticoltura speciale – Melo, -1991, pp. 71 - 78
3. FAO, 1977. IPN & ICM
4. Ferraj B. Susaj L., Teqja Z., Balliu A, Vata N., Faslia N., Gjetja Z., 2011. Finlandë. “Effects of different soil management practices on production and quality of olive groves in Southern Albania”. JFA & E. Vol 9(3-4). Pp., 132 -135.
5. Ferraj B., Cakkalli D., Roshanji N., Hyka H., Thomaj T., Vlorw, 2003. Seminar Kombëtar/Referat ‘Pentaria Shqiptare dhe e ardhmja e zhvillimit saj’ Buletin no.14, pp 8 15, IPVlorw 2003.
6. Ismaili H., 2010, UBTiranë. Ulliri, Monografi, pp, 16 - 20
7. Kafazi N & Muco Dh, 1983, “Olive Culture”, Tirana, pp, 10-11-13.
8. Korkuti M., 2010. Qytetërimi në Shqipëri., pp., 277-280
9. Peculi V, Kopali A., 2005, Tiranë. Pp 28, 35, 43, 55, 61.
10. Voci F, Korro K., Tiranë, 2012. Kultivimi i manit në Shqipëri., pp, 32- 35
11. Thomaj F., (2009). “Maintenance and multiplication of the olive tree”, MAF, pp, 49-50, 63-64.
12. Xhuveli L., 2012. Bimët dhe shqiptarët, pp 92 -94.
13. Sherif Lushaj, 2008 “Pershtatshmeria e Tokave të shqiperise për rajonizimin e pentarise”

5 RRITJA E MBULESËS PYJORE, FAKTOR PËR MBROJTJEN E TOKËS DHE PRODUKTIVITETIN E PYJEVE.

Msc. Janaq Male, Specialist pyjesh në Organizatën CNVP.

1. TË DHENA TË PËRGJITHËSHME

Shqipëria konsiderohet si një vend i pasur më burime pyjore e kullosore. Zona pyjore e Shqipërisë (pyjet, shkurret, dhe tokat më bimësi pyjore) zënë 1,498,957 ha sipas IKP (Inventari Kombëtar i Pyjeve, 2004). Në themel të kësaj pasurie dhe gjendjes së saj të zhvillimit qëndron pozicioni gjeografik, larmishmëria gjeologjike dhe tokësore. Mungesa e strategjive dhe politikave konsekuente në të kaluarën (e largët e të afert) si dhe traditat e administrimit e përdorimit, shpesh here kanë çuar në degradim të vegjetacionit pyjor duke rrezikuar larmishmerine dhe vazhdueshmërinë. Relievi shqiptar ka një karakter të theksuar kodrinor dhe malor. Ai shquhet për një larmishmeri formash morfologjike, tipësh gjenetike dhe pjerrësi shpatësh, çka reflektohet në vertikalishtin e përhapjes së vegjetacionit pyjor. Klima gjithashtu është mjaft e larmishme, edhe pse vendi ynë është i vogël dhe i shtrire brenda klimës mesdhetare. Kjo larmi klimash e mikroklimash kushtëzon ndjeshëm larminë vegjetacionale të vendit.

Rrjeti hidrografik, luginat e grykat e thella të drejtuara kryesisht nga lindja në perëndim krijojnë ndërthurje interesante të vegjetacionit pyjor mesdhetar më atë submesdhetar. Rreth 70% e territorit shtrihet në zonat kodrinore e malore më infrastrukturë të vështirë. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 708 m, ose sa dyfishi i mesatares Evropiane. Territori Shqiptar është i ndarë në tre zona të rëndësishme ekologjike: zona e ulët bregdetare, zona transitore kodrinore dhe zona malore. Sasia vjetore e reshjeve varion në mënyrë të konsiderueshme nga rreth 800 mm/vit në zonat kodrinore deri në mbi 2,000 mm/vit në zonat e ulëta bregdetare si dhe në rajonet malore.

Kalimi në vitet 90 në sistemin e ekonomisë së tregut, krijoi ndryshime të mëdha socialekonomike, në tregje, në strukturat e prodhimit, papunësi të lartë dhe emigracion të theksuar, duke ndikuar kështu në strukturat dhe dinamikën social-ekonomike të vetë familjes shqiptare.

Shqipëria ka 315 Komuna dhe mbi 2,900 fshatra. Secila komunë ka një mesatare popullsie prej 6,500 banorë dhe një mesatare prej 9 fshatra, ku një pjesë e tyre (ato të ndodhura në zona kodrinore e malore) kanë sipërfaqë pyjore.

2. GJENDJA E PYJEVE NË SHQIPERI.

Rreth 35% e sipërfaqes totale të vendit mbulohet nga pyjet. Zona pyjore e Shqipërisë (pyjet, shkurret, dhe tokat më bimësi pyjore) zënë 1,498,957 ha (Inventari Kombëtar i Pyjeve në Shqipëri 2004), të ndarë si më poshtë:

Pyje	1,498,957 ha
• Pyjet e larta	294,957 ha (19,68%)
Nga të cilat:	
• Koniferet	84,461 ha
• Gjethegjërat	210,496 ha
• Cungishte	405,016 ha (27,02%)
• Shkurret	241,724 ha (16,13 %)
• Tokat më bimësi pyjore	557,260 ha (37,17%)

Konsumi vjetor i druve të zjarrit për familjet në zonat rurale llogaritet të jetë rreth 4.3 m³ në vit. Bazuar në këtë fakt, niveli i dokumentuar i konsumit për familjet rurale është 1.6 milion m³ dru zjarri në vit. Gjatë 60 viteve të fundit (periudha e komunizmit dhe e tranzicionit) pylltaria shqiptare ka vuajtur nga ndryshime domethënëse. Është reduktuar sipërfaqja pyjore më shumë se 300.000 ha dhe shumica e pyjeve janë shkatërruar si rezultat i mbi prerjeve dhe mbikullotjes. Degradimi dhe erozioni në pyje janë problemet themelore në menaxhimin e burimeve natyrore. Degradimi i pyjeve në Shqipëri mund të përshkruhet si më poshtë:

1) Sipërfaqet e mëdha pyjore larg fshatrave që ndodhen nën presionin e shpyllëzimeve (prerjet ilegale).

2) Sipërfaqet pyjore si dhe tokat kullosore pranë fshatrave të mbi shfrytëzuara si para ashtu edhe pas vitit 1990.

Pamje nga tipet kryesore të pyjeve në vendin tonë jepen në fotot më poshte:



(Nga e majta në të djathte: Pyje Pische, Ahu, Cungishte, Shkurre)

3. IMPAKTET MJEDISORE DHE SHKAKTARET E TYRE.

Aplikimi i politikave dhe praktikave të paqëndrueshme në qeverisjen e pyjeve, turizmit dhe bujqësisë në tërësi ka patur efekte mjaft të forta negative në pakesimin dhe degradimin e fondit pyjor dhe kullësor:

- Hapja e tokave të reja, në kurriz të fondit pyjor (rreth 300 000 ha ose afro 30% të fondit të sotëm pyjor janë zhdukur) e sidomos atij të dushkajave dhe e atij kullësor vendosur në stacionet më produktive (aktualisht pjesa më e madhe e abandonuar) kanë influencuar negativisht në drejtim të zhvillimit të pyjeve e kullotave në Shqipëri.
- Praktikrat e mbishfrytëzimit të pyjeve e kullotave, në kushtet e mungesës së burimeve alternative për energji e bazë ushqimore kanë patur efekte serioze në degradimin e kësaj pasurie natyrore. Aplikimi i këtyre praktikave ka influencuar në uljen e prodhimitarisë së tyre. Një pjesë e konsiderueshme e fondit pyjor sot perbehet nga pyje tepër të rrallë dhe të degraduar rende duke mos qënë të aftë të plotesojne funksionet shumëfunktionale, prodhuese, ekologjike e social-kulturore. Aktualisht rreth $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes pyjore ka një kurorëndendesi më të vogël së 0,4. Një pjesë e kullotave alpine të hapura për toka bujqësoret janë krejtësisht të degraduara e vegjetuara nga bimë pa vlerë.
- Aplikimi i teknikave të prapambetura në shfrytëzimin e pyjeve në kushtet e një terreni specifik më investime

minimale kanë influencuar negativisht në zhvillimin e metejsheem të mjaft grumbujve pyjore.

- Mungesa e objektivave kombëtare për mbrojtjen dhe qeverisjen e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, në përgjithësi ka patur pasojat e veta negative në biodiversitet e në mënyrë të vecante në popullatat e gjitarëve të medhenj, për shkak të fenomeneve të degjenerimit gjenetik që lindin në popullatat e vogla e të izoluara.
- Investimet e kufizuara në drejtim të kryerjes së punimeve silvikulturore, të pyllëzimeve të reja, mbrojtjes nga zjarret etj, kanë ndikuar në humbjen e degradimin e mjaft habitateve pyjore e kullosore.
- Prerjet ilegale të viteve të fundit, kryesisht në zonat veriore të vendit kanë sjellë pasoja të konsiderueshme negative në degradimin dhe keqpërdorimin e zonave pyjore, ku do veçonim ekosistemet e virgjera apo pothuajse të virgjera.
- Kullotja pa kriter në pyje e sidomos atyre prane qendrave të banuara (dushkaja apo shkurre mesdhetare është një tjetër faktor i degradimit të pyjeve.
- Hapja e tokave të reja, në kurriz të fondit pyjor (rreth 300 000 ha ose afro 30% të fondit të sotëm pyjor janë zhdukur) e sidomos atij të dushkajave dhe e atij kullosor vendosur në stacionet më produktive (aktualisht pjesa më e madhe e abandonuar) kanë

influencuar negativisht në drejtim të zhvillimit të pyjeve e kullotave në Shqipëri.

- Praktikave të mbishfrytëzimit të pyjeve e kullotave, në kushtet e mungesës së burimeve alternative për energji e bazë ushqimore kanë patur efekte serioze në degradimin e kesaj pasurie natyrore. Aplikimi i këtyre praktikave ka influencuar në uljen e prodhimit të tyre. Një pjesë e konsiderueshme e fondit pyjor sot perbehet nga pyje teper të rralle dhe të degraduar rende duke mos qënë të aftë të plotësojnë funksionet shumëfunktionale, prodhuese, ekologjike e social-kulturore. Aktualisht rreth $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes pyjore ka një kuroredendesi më të vogël se 0,4. një pjesë e kullotave alpine të hapura për toka bujqësore janë krejtësisht të degraduara e vegjetuara nga bime pa vlere.
- Aplikimi i teknikave të prapambetura në shfrytëzimin e pyjeve në kushtet e një terreni specifik më investime minimale kanë influencuar negativisht në zhvillimin e metejshëm të mjaft grumbujve pyjorë.
- Mungesa e objektivave kombëtare për mbrojtjen dhe qeverisjen e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, në përgjithësi ka patur pasoja të veta negative në biodiversitetin e në mënyrë të vecantë në popullatat e gjitarëve të mëdhenj, për shkak të fenomeneve të

degjenerimit gjenetik që lindin në popullatat e vogla e të izoluara.

- Investimet e kufizuara në drejtim të kryerjes së punimeve silvikulturore, të pyllëzimeve të reja, mbrojtjes nga zjarret etj, kanë ndikuar në humbjen e degradimin e mjaft habitateve pyjore e kullosore.
- Prerjet ilegale të viteve të fundit, kryesisht në zonat veriore të vendit kanë sjellë pasojë të konsiderueshme negative në degradimin dhe keqperdorimin e zonave pyjore, ku do të veçonim ekosistemet e virgjëra apo pothuajse të virgjëra.
- Kullotja pa kriter në pyje e sidomos atyre prane qendrave të banuara (dushkaja apo shkurre mesdhetare është një tjetër faktor i degradimit të pyjeve.
- Hapja e tokave bujqësore në fondin e kullotave alpine dhe degradimi apo erodimi i ketyre të fundit ka rezultuar më impakte mjaft negative duke shkaktuar prishjen e ekuilibre natyrore të ketyre ekosistemeve më vlera të medha.
- Praktikë tradicionale të përdorura për djegjen e kullotave dimërore ka shkaktuar pasojë mjaft negative në degradimin e desertifikimin e terreneve të konsiderueshme në zonat e ulta të pyjeve e shkurretave mesdhetare.

Disa pamje nga pasojat e dëmtimit të pyjeve në vitet e fundit jepen në fotot më poshtë:



.....
Dëmtimi i pyjeve dhe zhvillimi i erozionit.

4. PYJET DHE ROLI I TYRE NË MBROJTJEN E TOKËS NGA EROZIONI

Edhe pse Shqipëria ka një mbulesë të mirë pyjore, pjesa më e madhe e pyjeve dhe kullotave ndodhen në kushte të vështira. Tokat fragjile të kombinuara më praktika menaxhimi të paqëndrueshme në bujqësi dhe pyje përfshirë dhe mbikullotjen, kanë shkaktuar sediment të theksuara në lumenj, liqene dhe përrenj të cilat derdhen në detin Adriatik. Erozioni redukton kapacitetin prodhues të pyjeve dhe kullotave, redukton pjellorinë e tokës bujqësore dhe bën mbushjen e rezervuarëve të ujitjes dhe të HEC-ve.

Në shkallë kombëtare çdo vit 20-90 ton/ha toke ose 2.5-3 mm e shtresës së tokës erodohet dhe depozitohet në det ose mbush rezervuarët. (Burimi: Banka Botërore). Erozioni i tokës konsiderohet si një nga kërcënimet më të mëdha për tokën në Evropë, veçanërisht në zonën e Mesdheut (Komunikim mbi Mbrojtjen e Tokës) – “Drejt një Strategjie Tematike për Mbrojtjen e Tokës”, CEC, 2002). më qëllim përgatitjen e strategjive lehtësuese dhe zbatimin e masave konservuese për t’ju përgjigjur erozionit të tokës, është thelbësore të identifkohen dhe përcaktohet sasia e zonave në rrezik. Erozioni përbën një fenomen fizik që rezulton në zhvendosjen e tokës dhe copëzave të shkëmbinjve nga uji, era, akulli dhe graviteti. Të shumtë janë proceset dhe aspektet që kontribuojnë për zhvillimin e erozionit nga të cilët më të drejtëpërdrejtë dhe të përgjithshëm të njohur deri më sot janë: ndryshimet në mbulesën/përdorimin e tokës. Shkalla e erozionit në radhë të parë përcaktohet nga faktorë fizikë, p.sh. karakteristikat e tokës, formacioni shkëmbor, topografia dhe klima. Sasia e materialit të pranishëm për transport (me potencial



për tu eroduar) varet nga aftësia e tokës për t'u eroduar, përbërja dhe karakteristikat e gurëve. Kapaciteti transportues, p.sh. sasia e energjisë së pranishme në formën e rrebesheve apo rrjedhave ujore (volumi dhe shpejtësia) përcaktohet nga faktorë klimatikë dhe tregojnë nëse do të ndodhë dhe në çfarë shkalle do të ndodhë erozioni (Morgan dhe Quinton, 2001, cituar në L. Geraedts, L. Recatala-Boix, C. Ano-Vidal, C.J. Ritsema, 2006).

Ndikimet shekullore pasqyrohen në mënyrë të theksuar mbi mbulesën e tokës, ku ndryshimet në përdorimin e tokës, intensitetin dhe praktikat e kultivimit – të tilla si punimi dhe zbatimi i strategjive të konservimit – përcaktojnë prithmërinë për erozion (Batjes, 1996; Drake dhe Vafeidis, 2004; Boardman, 2006; Lesschen et al, 2007 cituar në raportin RAMSOIL 2.1. - 2006).

Erozioni i ujit ndodh për shkak të energjisë së ujit apo rënies së tij drejt tokës e më tej rrjedhjes mbi sipërfaqe. Shumica e proceseve të ndodhura në zonat e pjerrëta ndihmohen nga prania e ujit, që ndikon në shfaqjen e reagimeve kimike, i bën masat e tokës të rrëshqitshme më lehtësisht, bart mbeturina përgjatë rrjedhjes si dhe mbështet rritjen e bimësisë dhe kafshëve. Si për gërryerjet dhe transportin, procesi mund të përcaktohet si kimik, fizik dhe biologjik (Gobin et al., 2001). Megjithëse një pjesë e vogël e materialit largohet nga toka, pjesa më e rëndësishme e erozionit ndodh në sipërfaqë të tokës.

Erozioni i tokës është një proces natyral, që ka ndodhur gjatë periudhave gjeologjike, ku shqetësimi kryesor ndaj erozionit është pikërisht përshkallëzimi i tij, pasi shkalla natyrale e erozionit është rritur në mënyrë të ndjeshme si pasojë e veprimeve të njerëzve.



5.KARAKTERISTIKAT E VEGJETACIONIT PYJOR

Sipërfaqja totale e pyjeve e ndarë sipas formës së qeverisjes është: trungishte (pyje të larte) 449.000 ha, cungishtë (pyje të ulet) rreth 624.000 ha edhe shkurret më rreth 429.400 ha (ku përfshihen dhe tokat më bimësi pyjore).

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënë specifike për format e ndryshme të tipit të pyllit që ekzistojnë në Shqipëri, e cila gjithashtu ka një ndikim të veçantë në mbrojtjen e tokës pasi ato luajnë në rol të pazëvendësueshëm në krijimin e shtresës së humusit dhe sasia e drurëve dhe kuroredendësia e tyre absorbojnë një sasi shumë të madhe të reshjeve që bien si dhe ulin në mënyrë të ndjeshme energjinë kinetike dhe potenciale të pikave të ujit, si përfundim minimizojnë kushtet për krijimin e erozionit, të përmytjeve dhe rrëshqitjeve të tokës.

Forma e qeverisjes	Klasa e moshes	Përqindje	Sipërfaqja në ha
Pyje të larte	0-20 vjet	9.84%	44 174
	21 - 40 vjet	22.00%	98 76
	41 - 60 vjet	16.06%	72 097
	61 - 80 vjet	16.79%	75 375
	81 - 100 vjet	13.46%	60 425
	101 - 120 vjet	12.88%	57 821
	121 - 140 vjet	4.92%	22 087
	141 - 160 vjet	2.75%	12 345
	>160 vjet	1.30%	5 836

(Te dhënat sipas ANFI, 2003)


Studime të ndryshme tregojnë së pyjet e përzier më shumëloje dhe shumë moshuare janë shumë më të qëndrueshëm ndaj fenomeneve negative të natyrës përfshirë dhe fenomenin e erozionit. Në tabelën e mëposhtëm jepen të dhëna të shpërndarjes së sipërfaqes pyjeve sipas tipeve të ndryshme të pyllit.

Një tregues tjetër që ndikon në frenimin e erozionit është shpërndarja e pyjeve sipas klasave të moshës. Të dhënat në tabelën e mëposhtme tregojnë një shpërndarje jouniforme të klasave të moshës, sidomos për trungishtet dhe cungishtet. Në rastin e trungishteve klasa e parë e moshës është pak e përfaqësuar, çka krijon disa probleme për mbarështimin afatgjatë, që synohet nga parimi i prodhimit të qëndrueshëm. Klasa e dyte e moshës është disi më e përfaqësuar. Bie në sy që klasa e gjashte e moshës (101-120 vjet) mbulon rreth 13 % të të gjithë rasteve.

Për cungishtat klasa e dytë e moshës (10-20 vjet) zë peshën kryesore më rreth 47% të rasteve, çka gjithashtu krijon probleme lidhur më qeverisjen afatgjate të pyjeve të ulët. Nga një studimet që ka bërë organizata CNVP në ujëmbledhësin e Ulzes në lidhje më rolin e mbulesës dhe përdorimit të tokës mbi fenomenin e erozionit ka rezultuar së sipërfaqet e mbuluara më pyje kanë erozion më të pakët së çdo forme tjetër e përdorimit të tokës, siç tregohet në grafikun më poshtë: (të dhënat janë specifike për ujëmbledhësin e Ulzës bazuar në matjen e kryera për dy vjet në një rrjet sipërfaqes prove):

F-sipërfaqë më pyje, **G**-sipërfaqë më bar (kullote), **Pm**-pyje të shfrytëzuar, **O**-Pyje të kullotur;

Py-Lival i kullotur, **A**-Toke bujqësore, **B**-Toke boshe, **I-B**-sipërfaqë e degraduar



Forma e qeverisjes	Klasa e moshes	Perqindje	Siperfaqja ne ha
Pyje te larte	0-20 vjet	9.84%	44 174
	21 - 40 vjet	22.00%	98 76
	41 - 60 vjet	16.06%	72 097
	61 - 80 vjet	16.79%	75 375
	81 - 100 vjet	13.46%	60 425
	101 - 120 vjet	12.88%	57 821
	121 - 140 vjet	4.92%	22 087
	141 - 160 vjet	2.75%	12 345
	>160 vjet	1.30%	5 836

Burimi: IKP



Tipe pyjesh të menaxhuar mire, ku efekti i erozionit është të zero.


Zjarret si një fenomen shkatërrues. Në 20 viteve e fundit, përveç prerjeve abuzive në pyje dhe mbikullotjes (sidomos në zonat afër qendrave të banuara), një fenomenet tjetër negativ në drejtim të dëmtimit të pyjeve dhe të tokës pyjore kanë qënë zjarret në pyje. Vitet 2002 dhe 2007 kanë qënë nga më katasrofike për zjarret në pyje ku rreth 100 mijë ha janë djegur plotësisht ose pjesërisht. Tabela më poshtë tregon të dhënat sipas inventarit kombëtar të pyjeve, 2003.

	Perqind	Siperfaqja, ha
Shenja te dukeshme zjarri	9.10%	136 697
Nuk ka shenja te dukeshme zjarri	90.90%	1 365 464
	100.00%	1 502 161
Demtme nga zjarri		

Burimi: IKP.



Pamje nga zjarret në pyje



.....
Harta e zjarreve parë nga sateliti (botim i FAOs)

6.KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE TË SIPËRFAQES SË PYJEVE

Sipërfaqja pyjore sipas nivelit të erozionit. Studime të ndryshme në pyjeve dhe vëzhgime në terren kanë vlerësuar praninë ose mungesën e shenjave të erozionit të tokës. Megjithatë këto vlerësime nuk janë shumë të sakta, ato lejojnë të jepin disa indikacione mbi gjendjen e erozionit të tokës. Mbështetur në rezultatet e inventarizimit u vendos që të bëhej një studim i veçantë për erozionin për krejt vendin, nga i cili u prodhua një hartë e riskut të erozionit (të dhënat kryesore jepen në tabelën e mëposhtme).

	Perqind	Sipërfaqja, ha
Ka shenja erozioni	23.17%	348 051
Nuk ka shenja erozioni	76.83%	1 154 110
	100.00%	1 502 161
Niveli i erozionit		


Burimi: IKP

Sipërfaqja pyjore sipas kategorive të pjerrësisë. Shqipëria është një vend mjaft malor dhe shumë sipërfaqë të rrafshëta apo më pjerrësi mesatare janë kthyer në toka bujqësore. Për këtë arsye mund të pritet që pyjet të gjenden kryesisht në zonat malore. Ky fakt verifikohet nga rezultatet e inventarizimit, më shumë se 62 % e sipërfaqeve prove kanë qënë në terrene më pjerrësi mbi 40 %, çka flet për problemet më të cilat duhet të përballohen aktivitetet e mbarështimit të pyjeve në Shqipëri.

Sipërfaqja pyjore sipas kundrejtimit. Kundrejtimi luan një rol kryesor në vlerësimin e stacioneve pyjore. Shpërndarja e sipërfaqeve prove sipas kundrejtimit nuk është uniforme,

kundrejtimi jug-lindje ka përqindjen më të ulët më 7.68 % të rasteve dhe kundrejtimi lindor zë 16.57 % të rasteve.

Sipërfaqja pyjore sipas lartësisë nga niveli i detit. Lartësia nga niveli i detit është një karakteristikë e rëndësishme. Sikurse duket nga tabela më poshtë, më pak së 14 % e sipërfaqes grupohet në dy klasat e para deri në 400m. më shumë së 40 % e sipërfaqeve prove kanë një lartësi mbi 1000 m nga niveli i detit. Sipas studimeve, sipërfaqë në lartësi më të mëdha mbi nivelin e detit, kanë potencial më të madh për zhvillimin e erozionit dhe humbjen e tokës.



Burimi: IKP

Kategorite e lartësisë nga niveli i detit	Përqind	Sipërfaqja, ha
0-200m	4.47%	67 147
201-400m	9.32%	140 001
401-600m	15.06%	226 224
601-800m	13.51%	202 942
801-1000m	15.83%	237 792
1001-1200m	15.22%	228 629
1201-1400m	13.29%	199 637
1401-1600m	8.94%	134 293
1601-1800m	3.81%	57 232
1801-2000m	0.55%	8 262
	100.00%	1 502 161

Burimi: përqindjet nga vëzhgimi në terren, (IKP)

7. DISA PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sfidat kryesore të hasura drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe riparimit të disa prej dëmtimeve që ka pësuar mjedisi gjatë 5-6 dekadave të fundit, kanë të bëjnë më të drejtat e pronësisë mbi tokën. Degradimi, varfërimi i tokës dhe mjedisit qenë më i theksuar kur të drejtat nuk janë përcaktuar qartë, dhe atëherë kur as shteti dhe as komuniteti lokal nuk kanë qenë në pozita për të mbështetur të drejtat, qoftë këto të bazuara në traditë apo bazuar mbi të drejta ligjore.

Pas vitit 1996, qeveria filloi procesin e transferimit të rreth 60% të pyjeve shtetërore tek pushteti lokal mbi bazën e të drejtës së përdorimit afatgjatë. Filozofia e transferimit të pyjeve dhe kullotave shtetërore në komuna është një njohje e të drejtave të komunitetit për përdorimin e produkteve pyjore, dhe kryerjen e shërbimeve në pyje. Procesi i transferimit të pyjeve synonte në:

Ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe të fillonte zhvillimin e pyjeve dhe kullotave nëpërmjet përfshirjes së komunave, bashkive dhe fshatrave në menaxhimin e tyre të qëndrueshëm dhe për pasojë në mbrojtjen e të gjithë mjedisit; dhe të rriste përfitimet e komunitetit dhe fermerëve nga përdorimi i këtyre burimeve natyrore.

Transferimi i pyjeve në filozofinë e projektit, nuk përbënte një kthim të thjeshtë të pyjeve, por banorëve ju kthehej përgjegjësia për menaxhimin e pyjeve. Procesi është i gjatë dhe nuk përbën një transferim të thjeshtë të pyjeve e kullotave “në përdorim” të Komunave/fshatrave, por është edhe proces i transferimit të kompetencave dhe përgjegjësive shtetërore (shërbimi pyjor) drejt pushtetit lokal (Komunave) dhe komunitetit (fshatarëve). Ky proces hodhi themelet për fillimin e menaxhimit të pyjeve përmes

përgatitjes dhe zbatimit të planeve të mbarështimit nga strukturat lokale. Krahas kësaj nevojiten ndërhyrje dhe masa që do të çojnë në rehabilitimin e mbulesës pyjore, rritjen e prodhimtarisë së pyjeve, mbrojtjen e tokës dhe të mjedisit në tërësi:

- Rehabilitimi i mbulesës pyjore dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj është faktori kryesor që do të çojë në rritjen e prodhimtarisë së pyjeve, luftimin e erozionit, zhvillimit të biodiversitetit dhe përmirësimit të peizazhit.
- Ndryshimi i koncepteve dhe praktikave në menaxhimin e pyjeve e kullotave si dhe përfshirja e komuniteteve, pushtetit lokal dhe aktorëve të tjerë në këtë proces.
- Vlerësimi i gjithanshëm i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe përfitimet e popullatave lokale duke përfshirë dhe shërbimet mjedisore të pyjeve (sek. i karbonit, red. I erozionit, cilësia e ajrit dhe ujit etj.)
- Pyllëzimi dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara, të djegura, të prera etj. Është një emergjence mjedisore
- Të vendosen ekuilibrat e interesave sociale të lidhura më pyllin, duke krijuar klime të favorshme për zhvillim ekonomik, për ruajtjen e vlerave ekologjike të pyjeve si dhe të funksioneve sociale
- Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore; përdorimi i biomasës si burim energjie të rinovueshme
- Rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve komunale nëpërmjet trajnimeve dhe aplikimeve konkurruese për investime në pyje.
- Përmirësimi i data bazës pyjore dhe sistemit të informacionit

- Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik, praktikave të mira, dhe inovacionit në pyje, duke krijuar modele pyjesh më shumëloje dhe shumëfunksione.
- Harmonizimi i kuadrit legjislativ të ardhshëm dhe institucional më kërkesat e BE.

Referencat:

1. CNVP-PROFOR, "Study and analysis of innovative financing for sustainable forest management in the southwest Balkans", 2014
2. DPPK, 2004; "Strategjia e Zhvillimit të sektorit të pyjeve", Tirane 2004;
3. Lako Th, Pelz, Scheuber: Iventari kombëtar i pyjeve të Shqipërisë, 2004;
4. Akte ligjore "Për pyjet, kullotat dhe zonat e mbrojtura", botim i MMPAU, 2008
5. Udhezuesi për hartimin e planit të menaxhimit të Pyjeve dhe kullotave komunale, botim i PZHBN, 2006.
6. Manual "Mbi rregullat dhe kërkesat teknike të trajtimit, përdorimit e të shfrytëzimit të pyllit komunal", botim i MMPAU, 2008.
7. Muharremaj, V. 2005. Strategjia kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave në Shqipëri, (anetar i grupit të punës), DPPK
8. Muharremaj, V; Lako, Th; Dragoti, N. 2004. Studim - Plani i përgjithshëm i pyjeve dhe kullotave të Shqipërisë (në kuadrin e inventarizimit kombëtar të Pyjeve të Shqipërisë, i mbeshtetur nga Banka Boterore dhe Qeveria Shqiptare),
9. Blinkov I, 2012; Një përfaqje për konvertimin e të dhënave të erozionit të prodhuara nga metoda EPM më matje të peshes. konferenca LANDCON Serbi.
10. Muharremaj, V. 2003. Pyjet dhe kullotat, tek Historia e Bujqesise dhe agroindustrise shqiptare. Tiranë
11. Muharremaj, V.2003. Problemet dhe masat e mundshme restauruese në pellgjet ujëmbledhës në Shqipëri (me bashkautor). Referat në Konferencën kombëtare për degradimin dhe mbrojtjen e tokës, IST.

6 EROZIONI DHE TOKAT MË PJELLORI TË KUFIZUAR

Petrit Harasani¹, Bardhyl Qilimi² dhe Eda Bezhani²

Erozioni është një fenomen natyror që bën gërryerjen, zhvendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Dinamika e erozionit është përshpejtuar veçanërisht nga veprimtaria dhe aktiviteti human. Është vlerësuar se në Evropë janë subjekt i erozionit mbi 25 milionë hektarë tokë, të madhësisë së humbjeve të rendit rreth dhjetëra tonë për hektar në vit (De dredhi et al., 1991). Në tokat bujqësore të vendit tonë, rreziku potencial i erozionit konsiderohet i lartë. Të dhënat e studimeve të kryera tregojnë se vetëm në rreth 25% të tokave bujqësore rreziku potencial është mesatar ndërsa në rreth 75% të tokave rreziku është i lartë.

1. *Universiteti Polis, Tirane*

2. *Green Hours Studio, Tiranë*

3. *Universiteti A. Moisiu, Durrës*

Për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër nevojitet një kohë shumë e gjatë. Midis formave të erozionit dhe efekteve të shkaktuara dallohen :

- Erozioni sipërfaqësor : zhvendosja e shtresës së sipërme të tokës nga reshjet dhe era; humbje dhe degradim i tokës bujqësore, i florës dhe faunës;
- Erozioni në formë rrëqesh : çarje deri në rrëqe që përshkojnë sipërfaqen e tokës kjo është formë më e përkeqësuar e erozionit sipërfaqësor;
- Gërryerja e tokës: formë e erozionit që karakterizohet nga gërryerja dhe zhvendosja e masës nga rrjedha e ujit në përrenj dhe lumenj. Efektet e kësaj forme të erozionit veprojnë mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokat e kultivuara dhe infrastrukturën;
- Lëvizjet dhe shkarjet e tokës: provokohet nga forca e gravitetit dhe faktorë natyrorë ose humane që

influencojnë degradimin e mjedisit dhe infrastrukturës;
 Analizën e shkallës së erozionit sipërfaqësore, dëmeve që
 shkakton dhe masave që duhen marrë po e bëjmë më :

Ekuacionin Universal të Humbjes së tokës (USLE)

EROZIVITETI E	RODIBILITETI		
Rreshjet	Karakteristikat		Menaxhimi i Territorit
Energjia P	Fizike (toka dhe morfologjia)	unimet dhe Sistemit	Kulturat dhe Perdorimi i tokes
R	K	LS P	C

A	sasia mesatare e tokës së gërryer t	ha ⁻¹
R	Eroziviteti i tokes (faktori i gërryerjes nga rreshjet) M	J ha ⁻¹ mm h ⁻¹
K	Erodibiliteti i tokes (faktori i tendencës së tokës për t'u gërryer, gërryeshmëria)	t ha ⁻¹ h a MJ ⁻¹ h mm ⁻¹
L, S	faktori i gjatësisë së shpatinës faktori i pjerrësisë së shpatinës	Pa permase
P	faktori i praktikave bujqësore për kontrollin e erozionit (sistemi bujqësor)	Pa permase
C	Faktori përdorimit te tokes faktori bimor	Pa permase

$$A = R \times K \times L \times S \times C \times P$$

Ku :

- **R** -faktor klimatik lidhur më intensitetin dhe kohëzgjatjen e reshjeve (varion midis 50-600). Në vendin tonë numri i ditëve më reshje është mbi 100 dite, intensiteti i reshjeve është i larte, sasia mesatare e reshjeve është 1300-1400 mm në vit, për pasojë dhe R ka vlera të larta.
- **K** -faktor pedologjik, shpreh gërryeshmërinë e tokës (varon midis 0,05-0,7) Faktorët tokësorë: lloji i shkëmbit, tekstura, thellësia e tokës, struktura,

permbajtja e lendes organike, aftesia ujembajtëse e tokës, pershkueshmeria dhe infiltrimi, përmbajtja e gurëve, etj që përcaktojnë erodibilitetin e tokës, ose aftësinë e saj për tu shkëputur, transportuar gjatë procesit të erozionit në vendin tonë bëjnë që K të këtëvlera të mesme deri të larta.


- **LS** -faktorët topografike: gjatësi dhe pjerrësi shpati (varion midis 1-40). Efektet e gjatësisë së shpatit dhe të pjerrësisë së tij paraqiten nëpërmjet faktorit L dhe S, megjithëse shpeshherë këto janë vlerësuar më një faktor të vetëm topografik (LS) ose fiziografik. Gjatësia dhe pjerrësia e shpatit ka një ndikim të madh mbi humbjet e tokës. Në një shpat të gjatë ndodh një gjërryerje e madhe sipërfaqësore si dhe një rrjedhje më e shpejtë dhe gjërryerje e thellë. Humbja e tokës është proporcionale më pjerrësinë e shpatinës. Vendi ynë është kryesisht malor më male të lartëmbi 2000 m mbi nivelin e detit, më shpate të thepisur dhe shpeshherë të zhveshura. Pjerrësia e theksuara më një mesatare prej afro 25 % dhe lartësia mesatare mbi 700 m mbi nivelin e detit (ose dy herë më e lartë se mesatarja e Evropës) i bëjnë tokat lehtësisht të gjërryeshëm, ose LS më vlera të larta.
- **P** -faktor në lidhje më adoptimin e teknikave të ruajtjes së tokës (varion 1 deri 0.5)

- **C** -faktor e mbulimit të vegjetacionit (varron midis, 003-1 në varësi të llojit dhe dendësisë së bimësisë). Faktorët P dhe C janë faktorët e menaxhimit të territorit, janë faktorët ku në mund të ndërhyjmë. Nëse njeri nga faktorët bëhet 0 gjithë ekuacioni bëhet 0 pra nuk ka erozion. Që këtej del dhe roli i rëndësishëm i faktorit human.

Objektivi kryesor i luftës kundër erozionit është ulja e shkallës së erozionit nga veprimi i njeriut, ujit, erës, etj, në një nivel të pranueshëm për kushtet e mjedisit konkret. Janë raste shumë të rralla kur shkaqet e erozionit ose lëvizja e lëndës mund të mënjanohen totalisht.

Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjeve:Gjatë viteve të fundit dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimi i objekteve mbrojtëse dhe dëmtimi i vegjetacionit për gjatë shtratit të tyre. Futja e mjeteve të rënda jo vetëm ka dëmtuar shtratin e lumit nga marrja e inerteve por edhe janë shkatërruar argjinaturat për të bërë rrugë kalimi për këto mjete. Nga shfrytëzimi i lumenjve për marrjen e inerteve kemi uljen e shtratit të tyre më disa metra duke dëmtuar seriozisht këmbët e urave, veprat e marrjes së ujërave të kanaleve ujitës që marrin ujë nga lumenjtë.

Marrje e inerteve nga shtrati i lumit :Të dhënat tregojnë së vlera mesatare e tokës së gërryer varion nga 0.6-0.9 ton në vit për çdo metër linear të shtratit të lumit të Shkumbinit. Në të dy krahët e tij, për të gjithë gjatësinë e shtratit të lumit prej më shumëse 1000 metër humbjet e tokës varrojnë nga 600-900 m³ në vit. Nga matjet e bëra në lumin Vjosës është



Marrje e inerteve nga shtrati I lumit

konstatuar i njëjti fenomen, rezultatet tregojnë së humbjet e tokës janë rreth 250 m³ tokë/ në vit për një gjatësi prej 300 ml.

Nga studimi i të dhënave mund të konkludohet që humbjet e tokës vijnë si rrjedhojë e devijimit të rrjedhës së ujit të lumenjve për shkak të shfrytëzimit të inerteve ose mbushjes së shtratit të tyre më mbetje urbane. Lumenjtë kanë pësuar ndryshime përsa i përket shtrirjes së basenit dhe drejtimit të rrjedhës së ujit. Devijimi i rrjedhave ujore është i ndikuar shumë herë nga praktikrat e shfrytëzimit dhe të marrjes pa kriter të materialeve inerte nga trafiku i mjeteve të rënda në shtretërit e lumenjve si dhe nga dëmtimet masive të mbulesës bimore brenda shtratit të lumit dhe në brigjet e tij. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë dhe serioz.



.....
Demtim I urave në lumin Fan

Prandaj duhet të ndërhyhet për një kontroll të rreptë dhe strikt të shfrytëzimit pa kriter të materialeve inerte në brigjet e lumenjve, si dhe ndalimi i plotë i përdorimit të inerteve në rrjedhën e poshtëm të lumenjve. Pyllëzimi sa më i shpejtë dhe ngritja e veprave të natyrave të ndryshme hidroteknike më qëllim disiplinimin e rrjedhës së ujit në shtratin e lumit. Eliminimin e ndërhyrjeve mekanike në afërsi të shtratit të lumenjve për qëllime të ndryshme. Mbajtja dhe sigurimi i një regjimi normal dhe uniform të prurjeve ujore dhe të ngurta si dhe ruajtja e një balancë normale për komandimin e grykëderdhjes së lumenjve.

Një formë specifike e degradimit të tokave është zënia e tyre më materiale të ngurta si pasojë e mbulimit më zhavorr të shkaktuar nga vërshimi i përrenjve dhe lumenjve të cilët në momente të reshjeve të rrëmbyeshme shfaqin efekte negative.

Fenomeni i zhavorrimi më i dukshëm është në zonat e rrjedhës ujore të përrenjve në Përmet, Gjirokastrë, Skrapar, Vlorë, Elbasan, Librazhd, Lezhë, Kurbin dhe Shkodër. Megjithëse, ky fenomen i lokalizuar kryesisht në grykëderdhjen e përrenjve të thatë (pjesa më e madhe e kohës janë pa prurje uji), përbën një rrezik serioz për tokat bujqësore, prishjen dhe dëmtimin e infrastrukturës dhe qendrave të banuara. Sipërfaqet e zëna më depozitime të ngurta hasen edhe në brigjet e lumenjve më kryesorë të vendit tonë, ku më më probleme janë lumi Gjadër, lumi Mat, lumi Shkumbin, Lumi Devoll, Lumi Osum dhe Lumi Vjosë.

Natyra e depozitimeve të materialeve inerte, është karakteristike e përrenjve që në periudhën e verës nuk kanë prurje të vazhdueshme uji. Të dhënat e grumbulluara tregojnë



.....
Përmbytje në zonen e Shkodrës

së depozitimet e ngurta janë evidente pas rënies së shirave të rrëmbyeshme në stinën e pranverës dhe vjeshtës. Mbështetur në të dhënat e studimeve mund të konkludohet së sipërfaqet e okupuara më materiale inerte në nivel nacional është rreth 8 ha/vit.

Ndërhyrjet në shtratin e rrjedhës së ujërave (përrenj, lumenj etj.) mund të kenë efekte mbi peizazhin. Kur uji që rrjedh është më pak i ngarkuar më mbetje të ngurta mbas marrjes së masave të posaçme, potenciali eroziv rritet. Ndërkohë që pastrimi i shtratit të lumenjve zvogëlon forcën e fërkimit ose goditjes së ujit e për pasojë zvogëlohet sasia e lëndës së zhvendosur nga uji. Megjithatë, efektet duhet të studiohen rast pas rasti.

Ndërhyrjet në lumenj kanë sjelle permybtje të zonave të banuara nga demtimi i penelave mbrojtës, demtimi i argjaturave për hapje rrugësh, demtim të parcelave bujqësore dhe sidomos të bagëtive dhe bazës së tyre ushqimore.

Lëvizjet dhe shkarjet e tokës. Dukuria e shkarjeve dhe shembjeve të tokës konstatohet:

- në zonat më terren të thyer dhe më vegjetacion të dëmtuar
- në tokat e zonave ku është larguar popullsia.
- në tokat e zonave të thella malore që janë larg qendrave të banuara.
- në toka të pjerrëta dhe shumë të pjerrëta, ku menaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mungon plotësisht.
- në tokat e zonave ku kanë filluar ndërtimet kryesisht në tokat e pjerrëtë në afërsi të qyteteve kryesore ku



.....
Përmbytje në zonen e Lezhës

kryhen punime, gërmime dhe ç'vendosje të dherave të pakontrolluara.

Shkarje masive toke gerryerje dhe shkarje toke. Tokat e rajoneve të Beratit, Pogradecit, Skraparit, Gramshit, Mirditës, Elbasanit, Korçës, Përmetit dhe Kolonjës jenë të rrezikuara potencialisht nga rreziqet shkarjeve dhe shembjeve. Gjithashtu dukuria e shkarjeve dhe shembjeve të tokës ka filluar të shfaqet dhe të veprojë në zonat e pjerrëta në afërsi të zonave urbane të qyteteve Tiranë, Durrës, Lezhë, Sarandë. Sipërfaqet e tokës që rrezikohen nga këto shkarje dhe shembje vlerësohet të janë rreth 140- 150 mijë ha në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Shkarjet dhe shembjet e tokës janë shprehje e erozionit gjeologjik, dhe karakterizohen nga lëvizje të tokës si rezultat i rrëshqitjeve apo gravitetit. Relievi i thyer, reshjet, dëmtimi i vegjetacionit natyror, braktisja e tokave bujqësore etj, ngelen faktorë që stimulojnë proceset e shkarjeve dhe shembjeve. Format dhe mënyrat e lëvizjes janë të shumta. Ato varen nga faktorët klimatik dhe tokësorë nga mënyra e disiplinimit të rrjedhave ujore sipërfaqësore dhe nga format që aplikohen për parandalimin dhe minimizimin e tyre.

KONKLUZIONE:

- Erozioni, si një nga format e degradimit të tokës, është mjaft i dukshëm në Shqipëri.
- Kushtet gjeoklimaterike kanë influence të madhe në këtëdrejtim.
- Sasia e lartëe reshjeve, si dhe ndërhyrjet që janë bërë në natyrën shqiptare gjatë 20-30 vitet e fundit si; tarracimet shpesh pa kriter, ujitjet më rrjedhje të tokave bujqësore,

duke bërë që bashke me ujin të çojnë në det pjesën më pjellore të saj dhe, në mënyrë të veçante, shpyllëzimi i afro 300 000 ha toke, përbejnë shkakun më shqetësues të erozionit në vendin tonë .

- Studimet tregojnë së çdo vit në Shqipëri gërryhet rreth 1,6-2 mm toke, e barabarte më 20-25 tonë për ha/vit.
- Çdo vit hidhen në det, nëpërmjet rrjetit ujqor, mbi 60 milion tonë materiale të ngurta, rreth 100 mije tonë azot, 60 mije tonë fosfor dhe 16 mije tonë potas, pa përmendur sasinë e madhe të mikroelementeve.
- Vetëm nga rrjeti kullues e ujitës në zonën fushore depozitohen çdo vit rreth 4-5 milionë tonë aluvione.
- Mbushja e afro 600 rezervuarëve ekzistues shkon deri në 3 % të vëllimit të tyre në vit.
- Veprat anti-erozive mungojnë ose kanë degraduar.
- Mbas viteve 1990 janë bërë investime sporadike vetëm në afërsi të zonave të banuara ose në funksion të akseve rrugore.
- Menaxhimi i pyjeve nga fermerët, ulja e nivelit të prerjeve për dru zjarri ka ndikuar në përmirësimin e situatës së pyjeve të ulta (dushqeve) duke ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e burimeve tokësore.
- Mbulesa bimore e ul në mënyrë të ndjeshme gërryëshmërinë e tokës në masën 30-35%. Bimët më efektivitet më të lartëpër ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni ujqor sipërfaqësore janë bimët livadhore. Humbjet e tokës në parcelat e mbjella më keto bime të krahasuar më bimët prashitëse janë rreth 50 % më të ulëta.
- Shkarjet e tokës janë evidente dhe të favorizuara nga

reshjet dhe kushtet gjeologjike. Ato janë të ndikuara gjithashtu nga mungesa e masave antierozive, pritave, pendëve etj.

- Lumenjtë kanë pësuar ndryshime përsa i përket shtrirjes së basenit dhe drejtimit të rrjedhës së ujit. Devijimi i rrjedhave ujore është i ndikuar shumëhere nga praktikatat e shfrytëzimit dhe të marrjes pa kriter të materialeve inerte, nga trafiku i mjeteve të rënda në shtretërit e lumenjve si dhe nga dëmtimet masive të mbulesës bimore brenda shtratit të lumit dhe në brigjet e tij.
- Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë dhe situata është serioze në rastet e shirave intensive
- Rekomandohet një kontroll të rreptë dhe strikt i shfrytëzimit të materialeve inerte në brigjet e lumenjve, si dhe ndalimi i plote i përdorimit të inerteve.
- Pyllëzim sa më i shpejtë dhe ngritja e veprave të natyrave të ndryshme hidroteknike më qëllim disiplinimin e rrjedhës së ujit në shtratin e lumit.
- Ndërmarrja e një sërë masash më karakter inxhinierik, hidroteknik dhe i natyrave të tjera më qëllim menaxhimin dhe mirëmbajtjen e baseneve ujore si dhe të shtretërve të këtyre lumenjve.
- Programet dhe masat e luftës kundër erozionit, të zbatuara në shkallë të gjerë duhet të integrojnë nevojat social-ekonomike dhe social-kulturore të popullsisë lokale.
- Erozioni është një dukuri që duhet të trajtohet si pjesë e procesit të administrimit të territorit dhe menaxhimit të hapësirës, planifikimit rajonal; programit për zhvillimin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit.

- Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtpërdrejtë cilësinë e jetesës.

Masat më të rëndësishme për parandalimin e erozionit sipas karakterit mbrojtës janë :

- Masat mbrojtëse inxhinierike dhe hidroteknike
- Masat mbrojtëse biologjike
- Masat mbrojtëse agronomike

Duke filluar nga :

- Mënyrat e punimit të tokës të mos favorizojnë erozionin ose rrjedhën e ujit (punimi në drejtimin tërthor, punim minimal); orientimi drejt kulturave frutore duke kontribuar në mbrojtjen më të mirë të tokës nga erozioni.
- Pyllëzimet, krijimi i mbulesave bimore, specie të veçanta dhe metoda të veçanta kultivimi për vende specifike.
- Konsolidimi i sipërfaqeve të kërcënuara nga erozioni
- Ndërhyrje topografike (ndërtimi i tarracave dhe mureve mbajtës);
- Masa për veshjen e përrenjve dhe shtratit të rrjedhës, modifikimi i profilit të tyre modifikimi i prurjeve të rrjedhës: ndërtime për të bërë shpërndarje të rrjedhës në drejtime të ndryshme duke ulur forcën e saj;
- Ndërtimi i veprave mbrojtëse diga, prita, kanale, argjinatura etj.
- Vepra mbrojtëse të tilla si prita malore, pragje për shuarjen e energjisë, pendët mbrojtëse për parandalimin e përmblyetjeve, pendët tërthore për pengimin e gjërryerjeve, veprat e artit etj.
- Masat e luftës kundër erozionit janë të domosdoshme për konservimin për një kohë afatgjatë të pjellorisë së tokës

si bazë për prodhimin bujqësor. Kufizimet e vendosura për përdorimin e tokës dhe burimeve natyrore (kullotave, pyjeve, lumenjve etj.), konsiderohen si efekte negative mbi popullatën. Në një këndvështrim tjetër, këto masa janë të nevojshme për ruajtjen e mjedisit dhe objekteve të infrastrukturës.

Tokat më pjellori të kufizuar

- Pjelloria është aftësia e tokës për të mbajtur e ushqyer bimët, është një tërësi treguesish ku më kryesoret janë: thellësia e tokës, përmbajtja e lendes organike, përmbajtja e N₂, P, K, mikroelementeve etj.
- Një pjesë e rëndësishme e fondit të tokës ka faktorë kufizues: që kryesisht janë : Aciditeti i larte, kripëzimi, kripëzimi magnezial, përmbajtje e lartëe gurëve etj., që ulin në mënyrë drastike pjellorinë.
- Rritja dhe zhvillimi i kulturave bujqësore nuk kontrollohet (varet) nga burimet totale, por nga burimi që është më i rrallë ose nga faktori kufizues.
- Tokat acide janë rreth 75,000 ha. Shtrihen kryesisht në zonën verilindore, lindore dhe juglindore. Për këto toka faktor kufizues është aciditeti i larte
- Këto toka kanë pH < 5 si dhe përmbajtje të Al dhe Fe-toksike për bimët
- Aciditeti vjen nga largimi i joneve të Ca dhe Mg për shkak të shpëlarjes, largimit nga bimët, dekompozimit të lendes organike dhe përdorimit të plehrave kimike.
- Këto toka perdoren duke futur bime më tolerante ndaj aciditetit
- Përmirësimi i këtyre tokave bëhet përmes gëlqerimit të

tyre e cila neutralizon aciditetin, largon Al dhe Fe duke ulur efektin toksik të tyre.

- Tokat magneziale janë rreth 15,000 ha. Shtrihen kryesisht në zonën verilindore, lindore dhe juglindore .
- Faktor kufizues është përmbajtja e lartëe Mg e cila kalon përmbajtjen e Ca, pra raporti Ca/Mg është në favor të Mg. Koncentrimi i lartëi Mg shkakton toksicitet tek bimët .
- Këto toka perdoren duke futur bime më tolerante ndaj përmbajtjes së lartëtë Mg.
- Përmirësimi i këtyre tokave bëhet përmes gëlqerimit të tyre përmes të cilit bëhet zëvendësimi MG nga Ca dhe përmirësimi i raportit Ca/Mg.
- Tokat e kripura janë toka që kanë teprice të kripërave të tretshme mbi 0.4%. Janë rreth 20,000 ha. Shtrihen kryesisht në zonën perëndimore të vendit duke filluar nga Velipoja, Lezha, Kurbini (Adriatik), Durrës (Spitalle), Lushnja (Rremes), Fieri (Hoxhare), Vlora (Akernij) dhe e Sarande (Vrine).
- Faktor kufizues është përmbajtja e lartëe kripërave që shkon nga 0.4 - >1%.
- Përpara 1990 kanë funksionuar 4 ndërmarrje vetëm për shkripëzimin.
- Vitet e fundit ka një rritje të sipërfaqes së tokave të kripura kryesisht përmes kripëzimit për shkak të mungesës së kullimit të tokave Masat që duhen marre:
- Përdorimi i bimëve tolerante ndaj kripëzimit
- Ruajtja dhe sigurimi i një kullimi të mire
- Shpëlarjet më sasi të mëdha ujerash
- Shkrifërimet nëntokësorë
- Rritje e lendes organike

- Përdorimi i sasive të gipsit për zëvendësimin e Na në kompleksin thithës

Tokat gurishtore janë sipërfaqë më të kufizuara

Shtrihen kryesisht në zonën e mbi Shkodrës, ndërsa tokat ranore shtrihen përgjatë ultësirës bregdetare. Përmbajtja e lartëe gurëve ul sasinë e tokës e për pasojë edhe pjellorinë e saj . Vitet e fundit tokat gurishtore po kultivohen më sukses me bime etero-vajore. Rugët e përmirësimit janë:

- Shtimi i lendeve organike
- Pastrimi i gurëve
- Thyerja dhe bluarja e gurëve

Në përfundim

Tokat më pjellori të kufizuar përbejnë sipërfaqë të konsiderueshme për vendin tonë . Përmirësimi i tyre, përmes eliminimit të faktorit kufizues,

- rrit pjellorinë e tyre
- shton sipërfaqen e tokave të kultivuëshmë,
- shton fondin e tokës dhe
- rrit sipërfaqen për fryme të popullsisë

Literatura:

1. CNVP-PROFOR, "Study and analysis of innovative financing for sustainable forest management in the southwest Balkans", 2014
2. DPPK, 2004; "Strategjia e Zvillimit të sektorit të pyjeve", Tiranë 2004;
3. Lako Th, Pelz, Scheuber: Iventari kombëtar i pyjeve të Shqipërisë, 2004;
4. Akte ligjore "Për pyjet, kullotat dhe zonat e mbrojtura", botim i MMPAU, 2008
5. Udhëzuesi për hartimin e planit të menaxhimit të Pyjeve dhe kullotave komunale, botim i PZHBN, 2006.
6. Manual "Mbi rregullat dhe kërkesat teknike të trajtimit, përdorimit e të shfrytëzimit të pyllit komunal", botim i MMPAU, 2008.
7. Muharremaj, V. 2005. Strategjia kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave në Shqipëri, (anetar i grupit të punës), DPPK
8. Muharremaj, V; Lako, Th; Dragoti, N. 2004. Studim - Plani i përgjithshëm i pyjeve dhe kullotave të Shqipërisë (në kuadrin e inventarizimit kombëtar të Pyjeve të Shqipërisë, i mbeshtetur nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare),
9. Blinkov I, 2012; Një përfaqje për konvertimin e të dhënave të erozionit të prodhuara nga metoda EPM më matje të peshes. konferenca LANDCON Serbi.
10. Muharremaj, V. 2003. Pyjet dhe kullotat, tek Historia e Bujqësisë dhe agroindustrisë shqiptare. Tirane
11. Muharremaj, V.2003. Problemet dhe masat e mundshme restauruese në pellgjet ujembledhes në Shqipëri (me bashkautor). Referat në Konferencën kombëtare për degradimin dhe mbrojtjen e tokës, IST.



REKOMANDIME NGA KONFERENCA –
PROBLEMATIKA DHE MASA PËR MBROJTJEN
E TOKËS

*(Drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama dhe
Institucioneve qendrore, datë 17.12.2014)*

Asamble e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ka shpallur datën 5 Dhjetor “Ditën Ndërkombëtare të Tokës (dheut) dhe vitin 2015 “ Viti Nder kombëtar i Tokës”. Qëllimi është që të nxiten nivelet politike, vendimmarrëse, shoqëria civile, komuniteti shkencor, pronaret dhe përdoruesit e tokës, të punojnë së bashku për një toke të shëndetshme për sigurinë ushqimore, uljen e varfërisë, menaxhimin e qëndrueshëm, shtimin e investimeve dhe mbrojtjen nga urbanizimi in formal.

Universiteti POLIS zhvilloi seminarin kombëtar “Mbrojtja dhe përdorimi i tokës problem ekonomik, social dhe mjedisor” në kuadrin e “Viti Ndërkombëtar i Tokës”2015, shpallur nga Asamble e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Në prezantimet e eksperteve

të fushës dhe nga përvoja e Universitetit në çështjet e zhvillimit të territorit dhe mjedisit, u evidentuan një grup probleme shqetësuese për mbrojtjen e tokës produktive bujqësore, e cila është e kufizuar dhe vazhdon të shpërdorohet. Bazuar në analizën e problemeve do të sugjeronim:

1. Zhvillimi urban në 20 vitet e fundit, është shoqëruar më fenomenin e konvertimit dhe zhvillimit informal në tokat bujqësore, veçanërisht në zonat peri-urbane. Kështu p.sh. në Tirane, në periudhën 2000-2010, rreth 60 % e zhvillimit urban, është kryer mbi tokën bujqësore produktive surburbane. në Fier pas vitit '90, rreth 90 % e zhvillimit urban ka prekur zonat bujqësore. Por edhe në zonat e tjera është e njëjta situatë. Nga viti 1991 deri më sot është zënë më ndërtime në shkallë vendi rreth 70 mijë ha toke bujqësore, kryesisht në zonën peri-urbane me kapacitet prodhues 2.4 here më të lartësë mesatarja e vendi.

Në së normat aktuale të urbanizimit dhe të degradimit të tokës do të mbeten të pandryshuara më ato të 20 viteve të fundit: në vitin 2050, toka bujqësore do të ulet edhe 20-25 % të sipërfaqes nga gjendja e sotme. Në këto kushte kërkohet një vizion i ri mbi planifikimin hapësinor nga Institucionet qendrore e vendore. Ligji 9244, date 17.06.2004

“Për mbrojtjen e Tokës Bujqësore” nuk ka gjetur ende zbatimin e duhur. Duhet të vendosen balanca të reja e të qëndrueshme të përdorimit të tokës, të mbrohen tokat produktive bujqësore, pyjore, urbane. Tregu po tejngopet më ndërtime, të cilat nuk shiten më. Në zonat peri-urbane më gjithë transformimin e shpejtte urban, përsëri ka sipërfaqe, të cilat mund të përdoren për bujqësi urbane dhe kopshte të gjelbra si një rezerve e rëndësishmesh për shtimin e produkteve ushqimore dhe gjelbërimit.

Për të ndaluar zënies e mëtejshme të tokave produktive bujqësore nga ndërtimet, zbatimi i politikave dhe instrumenteve të planifikimit kombëtar hapësinor bëhet esencial dhe i pazëvendësueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit për të balancuar zhvillimin urban më mbrojtjen e burimeve natyrore, tokësorë e bujqësore. Veçanërisht në zonën bregdetare, ku ndodhet rreth 40 % të sipërfaqes së tokës bujqësore, gjenden tokat më produktive bujqësore dhe më mundësi të larta prodhimi, por territori gjendet në presion të vazhdueshme të zënies nga ndërtimet. Në këto kushte, planifikimi hapësinor duhet të mbulojë urgjent këtë territor prioritar brenda vitit 2015, dhe të ndalohej ndërtimi dhe lejet në tokat bujqësore deri në përcaktimet e planit hapësinor.

Një vëmendje e veçantë në nivel kombëtar duhet ti kushtohet edhe çështjes së harruar të planifikimit kombëtar peizazhistik, që është një vlerë e shtuar jo vetëm estetike , por edhe ekonomike , sidomos në kuadër të rritjes së industrisë së turizmit , por edhe të edukimit mjedisor dhe të kultivimit të estetikës publike që stimulon në kthim vendosjen e shtetit ligjor në territor.

2. Inventarizimi i tokës bujqësore dhe pyjeve mbetet një çështje urgjente , pasi statistikatat e vendit dhe kadastra vazhdojnë të punojnë më shifrat e vitit 1991, edhe pse gjatë 24 viteve të tranzicionit kanë ndodhur ndryshime drastike në përdorimin e tokës bujqësore në kategori të tjera, apo dëmtimi i 400 mijë ha pyje , etj.

3. Fragmentimi i tokës mesatarisht në 4 pjesë për çdo pronë, mbetet një problem që vazhdon të shkaktojë mospërdorim të tokës bujqësore, braktisjen e sipërfaqeve të vogla, uljen e kapacitetit prodhues në nivelet 60-65 % , uljen e prodhimit deri në 30-35 % , rritjen e kostos së prodhimit deri 40 % , pengimin e zbatimit të teknologjive dhe efektivitetit të in puteve bujqësore etj. Theksojmë së vetëm për shkak të kufijve të rinj të vendosur midis pronareve

dhe shtimit të imponuar të infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes për çdo pronë, bëjnë që të humbasin nga përdorimi 7000-10000 ha toke bujqësore vetëm në zonën fushore të vendit.

Tregu i tokës, si një instrument i konsolidimit të tokës dhe zmadhimit të fermës është hapur qysh në vitin 1991. Por prej atëherë deri më sot, në vend që të përmirësonte konsolidimin ka çuar në copëtimin e mëtejshme të tokës, pasi nuk është caktuar njësi minimale e kultivimit. Gjithashtu tokat bujqësore që janë futur në shit-blerje, janë përdorur kryesisht për ndërtime. Prandaj duhet të miratohet një akt ligjor, ku të përcaktohet njësi minimale e kultivimit, tej të cilës nuk duhet të ketë nën-ndarje të mëtejshme të parcelave dhe të imponohen instrumente të renda fiskale për token e konvertuar informalisht për qëllime urbane , apo të lëna djerre. Universiteti POLIS është i gatshëm të marrë përsipër studimin dhe përcaktimin ligjor të madhësisë të njësisë minimale të kultivimit të parcelës , në bashkëpunim me Institucionet e qeverise.

Konsolidimin i tokës, inkurajohet duke përdorur grandet në bujqësi kryesisht në ferma më kufij maksimale të sipërfaqes. Aktualisht mbështetja më grande bazohet në sipërfaqet 1 ha, më synim për ti shpërndare në sa më shumëpërfitues, por më efektivitet të ulet. Për të realizuar konsolidimin e

tokës dhe zmadhimin e fermave kufiri i përfitimit të grandoeve nevojitet të rritet në jo më pak së 5 ha të kultivuar në të njëjtin vend.

Në mënyrë që fermerët të konsolidojnë tokën mund të aplikohen politika favorizuese si p.sh përjashtimi për 5 vjet nga taksa e tokës për gjithë fermerët që konsolidojnë token dhe rritin madhësinë e fermës, ose ata që shkojnë drejt kooperimit, sikurse zbatohet në komunën Xare, Sarandë.

4. Në lidhje me taksën e tokës të vendosur qysh në vitin 2002, megjithëse në vendim është përcaktuar që 40 % e të ardhurave të vjela nga taksa do të përdoret nga pushteti vendor në investime për mbrojtjen e tokës, vendimi nuk ka gjetur zbatim deri më sot. Ka vend të studiohet varianti që kjo takse, ose së paku 40 % e saj të shkoje në nivel qendror, më qëllim që të garantohet riinvestimi i saj në përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes dhe sistemimit të tokës, apo të mbrojtjes nga erozioni dhe humbjen e tokës nga lumenjtë në rreth 20-25 ha në vit. Ndërkohë që theksojmë së vazhdon shfrytëzimi barbar i shtretërve të lumenjve për inerte, praktikë që duhet ndaluar kategorikisht. Guroret duhet të jenënë vende të fshehura e në distancë nga qendrat e banuara dhe akset kryesore kombëtare të transportit. Pas përdorimit duhet të rehabilitohen më detyrim ,

ose në të kundërt vlera e mosrehabilitimit duhet të konsiderohet si detyrim fiskal për subjektet që i kanë përdorur.

5. Ekzistojnë mbi 100 mijë ha tokë bujqësore, të refuzuara nga fermerët gjatë zbatimit të reformës së tokës, të cilat më ligj përcaktohet të perdoren për familjet e paplotësuara më normën për frymë dhe për kategori të veçanta sociale. Këto toka vazhdojnë të degradohen dhe janë në mëshire të fatit, ose perdoren informalisht. Për këtë qëllim kërkohet një qëndrim, më qëllim që të futen në treg dhe të ndalet degradimi i tyre, duke u bërë pjesë normale e zhvillimit bujqësor. Gjithashtu investimi për tokat më pjellori të kufizuar (tokat acide e magneziale) do t'i fusë edhe këto kategori në ciklin e përdorimit bujqësor, më synim rritjen e produktivitetit dhe efektivitetit ekonomik. Një nga mundësitë është ndryshimi i ligjit duke i rishpërndare tokat për familjet brenda çdo njësie vendore, duke rritur normën për frymë ose për kompensim. Universiteti POLIS dhe Instituti CO-PLAN, mund të kontribuojnë në studimin dhe hartimin e akteve ligjore.

Përmirësimi gradual i menaxhimit, mbrojtjes dhe përdorimi i burimeve natyrore në bazë të pellgut ujëmbledhës është modeli më i suksesshëm në aspektin ekonomik, social e mjedisor. Ai ndihmon në frenimin e migrimit të mëtejshëm të popullsisë rurale dhe mbrojtjen e burimeve tokësore nga abandonimi. Për këtë, në kushtet e Reformës Administrative-Territoriale lipset të riorganizohen të gjitha strukturat e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në të gjitha nivelet.

Si përfundim, bazuar në gjetjet e mësipërme dhe në faktin së burime tokësore të vendit janë 2-10 herë më e ulët së shumica e vendeve dhe tregu po tejnqopet më ndërtime që nuk shiten , në këndvështrimin e Vitit Nderkombëtar të Tokës 2015 dhe të zbatimit të Reformës së re Territoriale, apo hartimit të Planit kombëtar Hapësinor, sugjerojmë që në vitin 2015 të shpallet “Programi kombëtar për Mbrojtjen e Tokës” në të gjithë nivelet qendrore, rajonale dhe vendore, për një analizë reale dhe planifikimin e masave konkrete për përmirësimin e situatës. Ka nevojë, të shpallet programi kombëtar për mbrojtjen e tokës, për një analize reale të situatës dhe planifikimin e masave të ndryshimit të situatës.

Kontakt:

Rr. "Bylis " Nr. 12,
Autostrada Tirane - Durres,
Km.5, Kashar.
Kodi Postar 1051, KP 2995,
Tirana Albania
Tel: +355.(0)4.24074 - 20/21,
Fax: +355.(0)4.2407422,
Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881,
E-mail: forum_ap@universitetipolis.edu.al
Web: www.universitetipolis.edu.al

 **MetroPolis**
Associated, Architecture & Planning Sh.p.k.

 **Co-PLAN**
Instituti për Kërkim dhe Zhvillim të
Proiektit dhe Planimit të Nivellit


POLIS
UNIVERSITY

Instituti për Kërkim dhe Zhvillim, IKZH_POUS
Qendra Burimore e Informacionit dhe Botimeve, POUS_Press

ISSN: 2306-8779

POLIS_Press